

Profesor Zejnullah Rrahmani është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Nga viti 1999 jeton mes Prishtinës dhe Kanadasë. Ka shkruar romane, novela, tregime. Ka botuar rreth 20 libra. Për krijimtarinë letrare është nderuar me çmimet: “Çmimin Hivzi Sulejmani”, “Çmimin Naim Frashëri”, “Çmimin e NGB Rilindja” për roman. Çmimin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, etj.

Në fushën e teorisë letrare dhe studimeve, ka botuar rreth 15 libra teorikë dhe studimorë.

ZEJNULLAH RRAHMANI:

Magjia e shndërrimit të dokumentit në art ka prekur shumë pjesë të historisë sonë në romanet e mia

Bisedoi Mimoza Hasani Pllana

(fq. 2)



Foto © Artan Korenica

Shkrimtarët sugjerojnë:
Cilët libra të dhurojmë
për festa?

MIRA MEKSI • BESNIK
MUSTAFAJ • BASHKIM HOXHA •
VIRION GRAÇI

(fq. 9)



Pikturë nga Pashk Pervathi

RILEXIMI I FISHTËS NË LIRI

Nga Frano Kulli

(fq. 7)

Gjergj Fishta, qe i exkomunikuar për një gjysmë shekulli. Leximi i veprës së tij lirisht qe i pamundur, madje rreptësisht i ndaluar. Një rast unikal ky, krejt i veçantë që i ndodh një autori. E çfarë autori! Poetit tonë Kombëtar. Leximi i mbramë i lejuar e i papenguar “Post mortum”, ka vijuar edhe jo më shumë se pesë vjet, nga 1940 deri në 1945-ën...

LIBRAT DHE TIRANA MONUMENTALE

Librat e falun janë të gjithë njësoj dhe
nuk lexohen... Ma mirë po shof një pikturë
monumentale... [Daniel (David) Gjeçaj -Vatikan]

Nga Xhevair Lleshi

(fq. 11)

“Arbëreshët midis realitetit dhe mitit” i
autorit Fatmir Toçi

Libër i shkruar nga një njohës i
mirë i botës arbëreshe

Nga Rami Memushaj

(fq. 10)

NJË KAFE ME HELENA K.

Nga Arben Velaj

(fq. 8)


Helena Kadare buzëqesh edhe kur flet. Madje edhe kur tregon se këtë natë e ngatërroi dhe humbi rrugën për në Fier. Iu desh të përshkonte rrugica të errëta, pa ndriçim në periferi të tij, derisa të arrinte ta gjente zemberekun e qytetit, që i dukej (sikur edhe më tha) të kishin 300 vjet që kishin humbur njëri tjetrin.

Ligjërata e Çmimit Nobel 2021

Abdulrazak Gurnah

TË SHKRUARIT

(fq. 16)



(fq. 22)

BIBLIOTEKË

Mira Meksi

(fq. 12)

Drakula në labirintin e tij

Graham Greene

(fq. 15)

Një aksident shokues

Rudina Çupi

(fq. 14)

Porta me dantellë

Abdulla Arapi

(fq. 17)

Këngët e kumrisë

VALS ME VRASËSIN E PUSHKINIT

(fq. 20)

Aleksander Levkovskij

Në 40-vjetorin e botimit
të parë të tregimeve të J.L.
Borges në shqip

Nga Enver S. Morina

(fq. 18)

ZEJNULLAH RRAHMANI:

MAGJIA E E SHNDËRRIMIT
TË DOKUMENTIT NË ART
KA PREKUR SHUMË PJESË
TË HISTORISË SONË NË
ROMANET E MIA

Bisedoi MIMOZA HASANI PLLANA

Mimoza: Krejt në fillim të bisedës e pas më shumë se pesëdhjetë dekada krijimtarie letrare e mësimdhënie, si e vlerësoni sot, cila i jep shpirt letërsisë: historia apo poesis?

Zena: Në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare e kisha përfunduar romanin “Zanoret e humbura” me të cilin kisha konkuruar në konkursin e Rilindjes me shifër, se dorëshkrimi nuk duhej të mbante emrin e autorit. Nuk di tash kujt t’i jap përparësi, leximit a jetës. E qartë është se jeta ishte e imja dhe leximet ishin gjithashtu të miat, jo vetëm ato të historisë, por edhe të sociologjisë dhe të filozofisë. Nuk e përjashtoj që aty dhe në disa vepra të tjera të miat ka një përvojë popullore, antropologjike, folklorike dhe mitike. Tek e fundit në “Sheshi i unazës” në princip të një kronologjie historike është përzgjedhur pozicioni i narratorit (tregimtarëve) të romanit: i pari është një tregimtar mitik, një urtak dhe pasuesi është narrator që shkruan përvojën e narratorit që nuk di shkrimin (tek e fundit periudha e antikës nuk ka lënë gjurmë shkrimi në gjuhën tonë!). Vetëm në periudhën e fundit të ngjarjeve të romanit historia tregohet nga narrator bashkëkohës dhe kjo në njëfarë mënyre është histori e përjetuar, dokument i shkruar autorial, poesis le ta quajmë. Në shumë prej veprave të mia ky raport bëhet shumë më kompleks dhe sa herë që duket se romani përmban histori, teksti i tij përdorë gjuhën dhe stilin për ta lexuar e pranuar atë si poesis, letërsi. Tek e fundit, romani është një pasardhës i largët i epit dhe dihet që gjithë historia nuk ka thenë gjë më shumë për luftën greko – trojane se që ka kënduar Iliada dhe Odisea! Magjia e tillë e shndërrimit të dokumentit në art ka prekur shumë pjesë të historisë sonë në romanet e mia. Madje, në disa raste edhe këtë gjë e kanë ndierë në romanet si “Romanin për Kosovën”, këtë e kanë ‘përjetuar’ shkresat e ndryshme ushtarake, raportet policore, kronikat e ndryshme, tekstet biblike, letrat e misionarëve të ndryshëm etj. Me një fjalë, shkrimi artistik ka asimiluar dhe i ka ngritur në nivel arti edhe gjithë spektrin e shkrimeve të shumë disiplinave të tjera... Në shumë prej veprave të mia, gjithmonë ka ekzistuar një shtresë teksti, mund ta quaj edhe një linjë shkrimi që ka qenë puro poesis dhe që (edhe si frymëzim) gjuhën poetike e ka përdorë ashtu si e përdorë edhe poezia, përfshi figurën dhe ritmin, natyrisht që nuk i ka përdorë vetëm disa nga stolitë e vargut. Çfarë të rezymoj? Romani rrëfen dhe ajo që rrëfëhet është e përfunduar, të paktën një kohë para se të

Zejnullah (Sadri) Rrahmani është i lindur më 1952 në Ballofc të Podujevës, Kosovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Podujevë. Ka studiuar dhe është diplomuar në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Studimet pasuniversitare dhe magistraturën i kreu në Degën e Letërsisë Shqipe, 1984. Më 1985 doktoroi në shkencat filologjike në Prishtinë. Ka punuar në revistën “Fjala” si gazetar dhe redaktor, më pas, profesor në Fakultetin Filozofik (tash Fakulteti i Filologjisë) prej vitit 1977 deri në pension.

Profesor Rrahmani, ka qenë kryetar i Studimeve pasuniversitare të Degës së Letër-sisë, i ka reformuar e udhëhequr ato nga viti 1992–1998. Nga viti 1992 deri më 1996 ka qenë dekan i Fakultetit të Filologjisë. Më 1995, ai e ka ringjallur (pasi që ishte ndërprerë dhunshëm dhe nuk ishte mbajtur disa vite), Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare dhe të njëjtin vit, si bashkëdrejtor me Akademik Bahri Becin, e ka organizuar në Tiranë për dy vite me radhë. Po ashtu, ka themeluar revistën shkencore “Filologjia” të Fakultetit të Filologjisë dhe ka qenë kryeredaktor i tre numrave të parë të saj.

Nga viti 1992 ka qenë anëtar i Këshillit Nacional për programet e letërsisë si dhe anëtar i Këshillit për unifikim të teksteve e të pro-grameve nacionale të Kosovës e të Shqipërisë 1992-1998. Nga viti 1996-1999 në cilësinë e Këshilltarit për arsim i Dr. Ibrahim Rugovës, Kryetar i Kosovës, e ka udhëhequr arsimin shqip (paralel) të Kosovës. Në periudhën 2007-2009 ka qenë anëtar i Këshillit Nacional të Shkencës të Kosovës.

Aktualisht është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Nga viti 1999 jeton në mes Prishtinës dhe Kanadasë.

Në fushën e krijimtarisë letrare shkruan zhanret; e prozë, roman, novelë, tregim. Në këtë fushë ka botuar rreth 20 libra. Për krijimtarinë letrare është nderuar me çmimet:

Çmimin Hivzi Sulejmani.

Çmimin Naim Frashëri.

Çmimin e NGB Rilindja për roman.

Çmimin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, etj.

Në fushën e teorisë letrare dhe studimeve, profesor Zejnullah Rrahmani ka botuar rreth 15 libra teorikë dhe studimorë.

zë formën në një shkrim. Pra, është e kaluar dhe në këtë kuptim është një histori goftë e treguar në mënyrë kronologjike si në romanin tradicional, goftë e përthyer dhe me kronologji të zhvendosur para ose prapa, si në romanin modern. Ndërsa struktura e një romani, veprimi, karakteret gjuha e stili i tij dhe efekti i tyre përtej, të cilin autri e arrinë me shkrimin e vet, kjo është ajo që e quajmë art dhe i cili reflekton në kënaqësinë e leximit...

Mimoza: Si filluat të shkruani letërsi?

Zena: Bashkë me shkrimin. Thjesht kam filluar të shkruaj. Mbay mend që gërmat i shkruaja me vështirësi dhe shpesh më dilnin si përbindsha të vegjël, por fjalët fluturojshin dhe shpesh kishin tendencë të lidheshin e të tingëllojshin së bashku. Më duket që ka qenë influencë fillimisht e atyre pëshpëritjeve ritmike të sime amë. Mandej, e thash që i fillova leximet. Unë nuk kam filluar leximin

me tekste të zgjedhura për fëmijë dhe as me librat e fëmijëve. Nuk kisha të tilla libra. Nuk kishim në shtëpi libra për fëmijë. Ishte vetëm ndonjë libër i klasëve të larta i vëllazërve të mij dhe ishin librat e Nazmiut (Nazmi Rrahmani, shkrimtar). Sa shkojshin ditët e librat e tij shtoheshin e shtoheshin. Të gjitha ishin libra të jashtëzakonshëm dhe shikuar nga ky moment që po flasim, mund të them që ishin pothuajse të gjitha kryevepra të letërsisë botërore: *Fausti* i Gëtes, *Don Kishoti* i Servantesit, Dekameroni i Bokaçios e *Komedia Hyjnore* e Dantes, Hamleti e Jul Qesari i Shekspir dhe mbi të gjitha Iliada e Odisea të Homerit. Letërsia shqipe atëbotë ishte e paktë, vetëm disa autorë kosovarë të cilëve edhe ua kam harruar moti librat, por në dollap të shtëpisë ishte Lulet e verësës e shkruar me makinë shkrimi dhe kopie, sepse nëpër gishta gjithmonë më mbetej ngjyra letrave ‘indigo’ sado që mundohesha mos me i përlye fletat! Naimi më vonë qe zgjeruar

shpejt edhe me Bagëtie bujqësi dhe Istorja e Skënderbeut. Por këto ishin libra të vështirë se ishin të shkrueme në një gjuhë më ndryshe, e jo në gjuhën që unë e njihja nga familja ime dhe rrethi atyre që njihja atëherë. Ndërsa vargjet si ‘Molla t’këputuna nji deget / Dy qershija lidhë n’nji rrfanë / Ku fillojnë kufijt e Geget/ Rrijnë dy çika me nji nanë./, i pata lexuar lehtësisht dhe aso kohe ne kishim një shtëpi ndërmjet prej tonës me nji grua të moshës së mesme, që kish dy çika, të cilat i rriste e vetme, mbasi që i shoqi i kish vdekur dhe djalë nuk kishte. Çikat jetime qenë rritur dhe ato përgatisnin pajën, siç ishte zakoni, kështu që shumicën e ditës e kalonin me gjergjef në dorë, duke qëndisur nën hije të mollave në kopsht. E ëma, u bashkohej kur kish kohë, ditëve me vapë të verës dhe pamja e tyre ishte me të vërtetë idilike, sado që njëfarë lloj pikëllimi shtrihej përtej shamijave e patiskut të bardhë, që priste qëndisimat e dorës së tyre...Për mua çështja ishte te ajo fjala Geget, të cilin unë asokohe nuk e kisha idenë ku e tek shtrihet dhe deri ku shkojnë ata kufinj dhe as çka ka përtej atyre largësive...Vjershat mund t’i lexoja dalëngadalë dhe më pëlqenin me lehtë e më shumë, se ato përmbanin atë që unë vetëvetiu e kërkoja: fjalët disi të lidhura e të kushtëzuara, tingëlluese e bukurtingëlluese, përsëritjet e shpejta e të përhershme, theksimin e veçantë dhe përfundime që përputheshin...Këto të gjitha unë i bluejsha në mendje dhe e mbaj mend që përpjekjet e lodhshme me shkruar ndoj varg të tillë, që me i përngjarë këngëve, ose edhe atyre pëshpëritjeve që i thojke ime amë, i kam bërë rreth një vjet pa shkue në shkollë dhe sidomos verën në vijim, duke pritur vjeshtën për t’u hapur shkolla. Se më kish kërcënuar im at që ka me më dërgue në shkollë dhe atje kanë për të më disiplinuar e sjellë në vete përfundimish! Unë, aso kohe, me kokën në letra gjithë ditën, nuk vlejsa për asgjë në atë shtëpi, ndërsa kishim plot punë! Duhet t’i kem pasur pesë vjet, se në të gjashtin më dërguen në shkollë.

Mimoza: Cili është motivi më i çuditshëm që e keni përdorur për të shkruar një tregim?

Zena: Ne fakt nuk kam insistuar kurrë të zgjedh motive të çuditshme. Në përgjithësi nuk jam autor senzacionesh dhe në fund të fundit as nuk e kërkoj lexuesin me çdo kusht. Natyrisht që e dua lexuesin se dua që shkrimi im të jetojë. Në vend të motivit ‘të çuditshëm’ synoj t’i ofroj lexuesit një topikë të organizuar në formë të bukur dhe të papritur nga ana e tij! Në fund të leximit më pëlqen të ndëgjoj një “uh, si është e mundur të paraqitet kështu një topicë e këtillë! Si mund të shkruhet kështu!?” E bukura e papritur, e befasishme për shijet dhe konceptet letrare të lexuesit, e provokon dhe e zgjeron imagjinatën e lexuesit, e bënë të pëlqyeshme dhe impresionuese kënaqësinë estetike...Se njeriu, për nga natyra e tij, njësohet me të zakonshmen dhe me standardet konvencionale. Edhe në art ndodh kështu dhe në këtë kuptim shpesh flitet për ‘shijen letrare’ të individit, ose të kohës, prapa të cilës fshihen një serë konvencash të standardizuara. Vetë veprat letrare dhe autorët e tyre gjithashtu i nënshtrohen një ‘standardizimi’ të tillë që i bënë të njëjta sipas disa kriterëve! Në këtë pike përthyhen pikëpamjet dhenjë mënyrë shkrimi kërkon ndryshim! Ndoshta këtu duhet kërkuar ajo ‘e çuditshmja’ në letërsi: në rrjedhën e veprave të një formacioni stilistiko-letra shfaqet vepra që pshishë standardet dhe në fillim quhet e çuditshme! Në këtë aspekt Zanoret e humbura, romani im, duket një vepër e çuditshme! E këtillë mund të trajtohet Udhëtimi arbëdhetar dhe më vonë 99 Rruzaret prej smaragdi e Lypësi dhe Sophia dhe mbi të gjitha Pesë vaktet. Pas kësaj të fundit, e pranoj që kam menduar ta braktis shkrimin përgjithmonë! Një mendje më ka folur që ndoshta edhe njëfarë kohe duhet të vazhdoj me leximet... Mirëpo, koha më ka bërë të kuptoj që leximet duhet t’i lë për më vonë dhe të shkruaj deri në fund edhe më tutje Librin tim: një kapitull i këtij libri është libri “Djemtë e Ballofcit” të cilin e botoi para pak javësh botuesi Faik

Konica i Prishtinës dhe libri "Deti i Zi" që pres të shfaqet në botim të Onufrit, shpresoj së shpejti.

Mimoza: *Sa janë të vërtetë personazhet tuaja, sa prej tyre i keni takuar në jetën reale?*

Zena: Egziston një dilemë e pazgjidhur kurrë nga kritika letrare ose nga historitë e letërsisë në përgjithësi a janë personazhet e një vepre letrare të vërtetë, real, apo janë fiktiv. Mund të përgjigjem në disa mënyra edhe ër personazhet e romaneve të mia. Ë 99 Rruzaret...shfaqen 99 karaktere të zënë në esencën e tyre njerëzore, por jo vetëm, ata përmbajnë në të njëjtën kohë dhe mënyrë dhe funksionet e atributet profesionale e fizike dhe përtej kësaj, secili prej tyre përmban edhe atributet e idesë, metafizikn e vet dhe atributin hyjnor. Në "Sheshin e Unazës" ka personazhe mitike, personazhe historike, personazhe folklorike dhe të kujtesës popullore, pork a edhe peronazhe fictive. Në romanin për kosovën ka një tabor personazhesh historic, pra të vërtetë në kuptim të fjalës në fjalor, por kjo nuk do të thotë aspak që në veprën time ata janë identik me ata të histories, pra me të 'vërtetët'! Në disa nga veprat e mia, sidomos në tregimet Mjeshtri i vetmisë perspektiva e rrëfimit dhe distanca e vogël, e identifikon pothuajse tregimin me autorin e tij, dhe ndonjëherë aty përdoret edhe mashttrimmi mbas emrit personal të autorit që në realitet është Zen, kështu që lexuesi edhe mund të besojë vërtetë që ka 'kapur' personazhet e vërteta! Këtë mënyrë iluzionit me të vërtetën e kam përdorë edhe në disa vepra të tjera , sidomos në "Lypësi dhe Sophia", në 99 Rruzaret...por edhe në "Pesë vakte". Lexuesi mund të mendojë besojë që komunikun me autorin, ose të paktën që ka 'zbuluar' disa aspekte e karakteristika të veçanta të autorit të veprës! Ajme!

Mimoza: *Si i emëroni personazhet, a është e vështirë të zhgjedhësh një emër për personazhin e dashur?*

Zena: Nganjëherë është vështirë, sidomos për personazhet e dyta e tutje. Se, personazhet kryesore, ato që shkëlqejnë në vepër, e gjejnë emrin vetë. Shumicën e herave e kanë të zgjedhur emrin e tyre qysh pa filluar shkrimi. Por ato që vijnë pasë tyre kërkojnë shumë gjeturi dhe përshtatje. E para, sië dithet prej moti, personazhet kryesore nuk durojnë shoqërim, protagonistin dhe antagonistin nuk e durojnë ngjashmërinë, se le më afërsinë në emra. Shqiptimi i përafërt i emrave krijon një lloj bezdijeje në lexim. Natyrisht që ka raste kur në letërsi janë përdorë emra të ngjashëm, madje që dallojnë vetëm për një fonemë, ta zëmë Anton Pashku në letërsinë shqipe ka ndërtuar vlerë loje e vlerë estetike me emra të tillë. Në disa romane modern e të absurdit ngjashmëria e emrave deri tek njajhtësia e tyre janë përdorur për të ndërtuar dallime karakteresh ose efekte absurditeti. Por, thjeshtë në, përdorimi i emrave të njajtë ose të ngjashëm në shkrim mund të krijojnë konfuzitete të ndryshme, megjithëse në jetën reale mund të ndodhin shpesh. Tek e fundit, Maria ka qenë e ëma e Krishtit dhe Maria (Magdalena) ka qenë nxënëse e tij. Por në teknikën e shkrimit kur ndodhë kjo, atëherë narratori detyrohet për çdo rat ta përcjellë me plotësime ose me attribute të caktuara, për cilën prej tyre bëhet fjalë...gjë që e prish atë që në një vepër poetike e quajmë iluzion i realitetit . Më tutje do të thosha që emrat e personazheve duhet të jenë të pranueshëm për lexuesin. Pra të mos jenë tepër të ngatërruar dhe shumë të gjatë. Jo të teprohet në aspektin semnatik të tyre, megjithëse dihet që shkrimtarë të ndryshëm kaa në përdorur emra të caktuar edhe në këtë kuptim: Bruti =brutus, - elementar, i ashpër; Horac= horatius- koha, por edhe lidhet me ratio- arsyja dhe orator-folës. Pra është pikërisht ai miku, që duhet t'i tregojë kohës amanetin e fundit, historinë e Hamaletit... se Historia duhet të jetoj edhe pas shuarjes fizike të Hamletit Mbret dhe Hamletit princ...Vetë emir i Hamletit derivon nga fjala islandishte amlooi (I marrë) një veprim ëtë



cilin princi Hamlet e luan për të zbuluar të vërtetën dhe për të mashtruar vrasësin e të atit, Mbretit Hamlet. Por edhe në variantin kuptimor të anglishtes Hamlet nënkupton të voglin, shtëpinë e vogël, dhe ky ishte i vogli i Mbretit të vrar Hamlet. Dua të them që emrat e personazheve, sidomos atyre kryesor të një vepre letrare shpesh mund të përmbajnë kuptime të ndryshme dhe janë një udhërrëfyes për lexim. Nuk them që diçka të ngjashme ka përjashtuar, përkundrazi, ta zëmë, në romanin "Sheshi i Unazës" antagonistin është një Prift. Ndoshta në thelb është dashur të ishte Popi, por kjo ishte e pamundur në Jugosllavi. Por romani që përmban element të dukshëm

të toposit të shenjtë, ku zhvillohet në luftë e shenjtë si për pushtuesin ashtu edhe për ne të pushtuarit (kosova), luftën kryesore e zhvillon në fakt Prifti. Fatkeqësisht e njëjat gjë po ndodhë në dy dekadat e fundit në Kosovë: ushtria pushtuese këtu është kleri i kishës serbe që shtrihet gjithandej nëpër Kosovë. Ndoshta edhe më qartë kjo luftë si në romanin tim sot po ndodhë në Malin e Zi midis malazezëve dhe kishës serbe atje...





Mimoza: *A ju kujtohet sa ishte koha më e shkurtër dhe më e gjatë që ju është dashur për të mbaruar së shkruari një libër?*

Zena: Natyrisht që më kujtohet koha e

shkrimit të secilës vepër. Edhe ajo e mendimit të saj. Në këtë aspekt ta zëmë Udhëtimi arbdhetar është roman që kam filluar ta mendoj më 28 Nëntor 1981, duke u kthyer në shtëpi nga sheshi kryesor i Prishtinës ku qe zhvilluar një demonstratë e përgjakshme kundër sundimit jugosllav. Aso kohe në kokë kasha disa mendime interesante për artin, për dashurinë dhe jetën në përgjithësi. Jepja mësim në Fakultetin e Filologjisë dhe isha i involvuar në jetën kulturore të Kosovës, me jetën dhe me veprat e mia të deriatëhershme. Përveç kësaj Shqipërinë e kasha vizituar herën e parë dhe të vetme në qershor të vitit 1973 dhe nga ajo anë kisha pësuar ato ditë të visitës një 'katarsis', pra isha çliruar nga iluzionet për të! Pra, lavdinë dhe pësimin e një demonstratë e kasha para syve për gjatë gjithë sheshit, (tash në gjuhë popullore të Prishtinës :Sheshi). Deri në vitin 1991 kam pare dhe marrë pjesë në to me dhjeta e dhjeta siuate të tilla të hovit e të rënies, të akte trimërie e pësime të pambarim të njerëzve në sheshet e rrugët e rrigicat e Kosovës. Hovi trimëror i të rijve thyhej e copëtohej në pancirët e policies, vritej me plumba dhe helme...Dukej diçka macabre dhe e pamundur, në të njëjtën kohë shpresëdhënëse dhe e pamundur, ngritej e thyhej dhe rrëzohej përdhe ai vrull...!Ishsin pothuajse dhjetë vjet leksioni si kish pësuar Kosova përgjatë dy shekujve të fundit: duke prodhuar trimëri të pafund por dije politike si mund të fitohej liria nuk kishte aspak! Kështu pra, në kohën që u formua subjekti i pare politik i shqiptarëve të Kosovës (LDK) nga një grup shkrimtarësh e gazetarësh, në Shesh të Prishtinës u ndie ndryshimi esecnial... Diku nëpër faqet e Udhëimit arbdhetar edhe kam shkruar që një lumë gjaku nuk ka dhënë rezultat dhe shkon hupës (term i Kanunit) pa një kokërr mendjeje...Romanin e shkrova për dy muaj, (kisha për ta shkruar për 20 orë, ose shumë shumë pëe 24 orë sa duhej të zgjaste koha veprimit e një tragjedie në artin e klasicizmit) se pothuajse është një recital të cilin unë deklamoja në shkrim...Por romanet tjera i kam shkruar me nnga një pjesë të jetës: Të parin roman , siç dihet, gjithë jetën deri në ditën e botimit. Të tjerët pothuajse me nga nji decade. Në Sheshin e Unazës kam punuar që nga 1969 deri më 1978, kur është botuar. Nuk flas këtu me hipërbola për ta shtuar gjoja peshën e veprës! E kisha dorëzuar në konkurs bashkë me "Zanoret e humbura" dhe u botua shumë vjet më vonë dhe gjatë asaj kohe kam punuar shumë variante të atij romani. Me një fjalë, ky ka qenë fati i librave të mi, i vështirë dhe një insistim i im i pafund për të krijuar tekstin më të mire të secilit...

Mimoza: *Cila është koha juaj e shkrimit; mëngjesi, pasdita apo nata vonë?*

Zena: Oh! Një pyetje e papritur! Të mos fshihemi pas asaj frazës që Homeri e ka shkruar Iliadën kur ka qenë i ri dhe Odiseun kur është plakur. Ka është distanca e dallimeve në stil e në emocion, distanca midis veprimit e meditimit! I shkrova heret në mëngjes? Mendja e freskët, gjaku që vlon nga rinia? Dora qpë derdhë freskinë e mendjes mbi letërën që pret mbi tavolinë të mbushet me rendeat e ushtarëve që nisin të rreshtohen në betejnë e pritur të ngjarjeve të subjektit të një romani!? Mesdita, një pjekuri e mendjes dhe logjika e shtrimit, njësitëe rreshtuara në grupe motivesh, sulmi i befasishëm në qendër, kapja e krahve të pambrojtur, rezervat e futura me freskinë e tyre, për të fituar betejën e një intrige romansore!? Apo jo, nata vonë, kur njeriu mundet t'i rreshtojë repartet e fugurave, t' i ndërtojë qetësisht ndërkamcat e pritrat e betejës, të lejojë njësitë armike të futen si fitimtare thellë në prita dhe atje të asgjahohen pamëshirshëm?! Nëse dal në jetë reale, për vete them që dita ka qenë kohë për punët tjera (gazetar në fillim, professor letërsie e teorie më vonë) dhe vetë mbrëmja ka qenë koha e librave, koha e leximit dhe e shkrimit, deri në vitet e vona kjo kohë ka zgjatë prej territ të pare deri tek ferku i mëngjesit. Le të më lejohet të them që një pjesë të madhe të ditës (profesionet e mia kanë qenë disi të lidhura



dhe e kanë bërë këtë lehtësisht të mundur, e kam kaluar dhe e kaloj edhe sot nëpër kafenetë e Prishtinës. Me kafënë para vetës, vetëm ose në shoqëri, kam kaluar çastet e shkëlqyera të jetës e të meditimt... Restorantet ku shtrohet ushqim nuk më pëlqejnë.

Mimoza: *Me çfarë forme të shkrimit është krijuar letërsia juaj, duke shkruar me laps dhe fletë, makinë shkrimi apo kompjuter?*

Zena: U bënë shumë vjet dhe i kam përdorë të gjitha ato mjete. Vërtetë që e kam filuar shkrimin me laps dhe me fleta që Nazmiu m'i lente mbi tavolinë kur shkonte në Prishtinë. Ishin fleta të shkëputura prej ndonjë fletoreje. Të them të drejtën unë kam bërë me qinda shkrime të tilla ushtrimesh dhe shpesh kama medituar me shkrim mbi tema të caktuara, si punë hartimesh që ai duhej t' i korrigjonte kur të kthehej, se pothuajse e kisha deformuar shkrimin deri në nivel të një variant të palexueshëm nga të tjerët. Pra duhej të kthehesha tek shkrimi i lexueshëm për të tjerët. Më vonë e kam kuptuara që mund të shkruash shkrime me gërma të lexueshme shkrimi dhe përsëri ai të jetë vështirë i kuptueshëm për të tjerët! I interpretueshëm po, i lexuar po, por ka shumë mënyra që atë natyrë 'terri' ta shpërndash nëpër shkrim dhe kështu një tekst ta bësh polivalent në kuptime...Por, makina e shkrimit ka qenë në fakt ai përbindshi që më ka tmerruar për një kohë të gjatë, sa e kam përdorë! Le që dorëshkrimi, siç e thotë fjala, është një proces i gjatë dhe i lodhshëm vetvetiu, por pas kësaj ishte daktilografimi dhe aty e tutje vazhdonte puna e korrigjimeve të ndryshme, prej njësive më të mëdha të strukturës e deri te elementet e stilit dhe përzgjedhjet e mundshme gjuhësore. Të përmendim përciptazi që unë gjithmonë kam punuar me fjalorët e ndryshëm të gjuhës shqipe por në raste të veçanta edhe me fjalët që i kam herrë nëpër tekstet e ndryshme, sidomos ata të autorëve të vjetër kur më është dshur tipizim ose ngjyrim stilistik historik...Kopja e parë e daktilografuar gjithmonë është pasuar me daktilografimin e dytë, të tretë ...e shpesh edhe të pestë, para se të ndhodhte daktilografimi përfundimtar i dorëshkrimit. Edhe ky proces ka qenë gjithashtu jashtëzakonisht i vështirë dhe mua të paktën më ka marrë gjithmonë tre deri më gjashtë muaj, se Rilindja e kërkonte dorëshkrimin në tri kopje (për redaktorin dhe për dy recenzentë dhe unë si autor dyshues gjithmonë dhe i kujdesshëm, duhej ta kisha një kopje në shtëpi, kështu që duhej daktilografuar me indigo. Standardi i dytë i kërkuar nga Rilindja asokohe ka qenë të jetë faqja pa gabime, kështu që po të ndodhte të gaboja disa shkronja në shtyp, duhej grisur ato kopje dhe të ridaktilografohej faqja nga fillimi...Të gjitha këto bënin që përfundimi i një dorëshkrimi, finalja të ishte moment që duhej festuar! Prandaj këto vështirësi më kanë shtyrë që të pranojë menjëherë kompjuterin porsa ai u përhap në botë. Në fakt unë kam qenë ndoshta autori i aprë në Kosovë që menjëherë e kam blerë dhe vendosë kompjuterin në tavolinën time të punës! Edhe tash shkruaj me dorë shumicën e teksteve të mija, por fazat tjera të përpunimit i bëjë në kompjuter dhe kjo shpikje është njëra ndër mrekullitë njerëzore që ia ka lehtësuar paksufi punën shkrimtarit....

Mimoza: *Kur lexoj veprën tuaj kujtohem sa trim duhet të jetë një shkrimtar për të shkruar për lavdinë historike kombëtare në kohën kur pushtuesi serbo-jugosllav ushtronte dhunë të tmerrshme në të gjitha format ndaj çdo shqiptari të Kosovës që promovonte idetë për liri dhe përpikje të ndërgjegjësonte e përgatiste qytetarët për veprime konkrete drejt arritjes së pavarësisë së Kosovës. Si guxuati, si qëndruati pa u trembur?*

Zena: Ah! Trimëria e shkrimtarëve është proverbiale! Ajo është provuar e sprovuar prej Mesjetës e këndej dhe siç dihet autori ka triumfuar gjithmonë, pavarësisht rrezikut e pavarësisht pësimeve. Nuk them që secili autor i rrezikuar ia ka dalë të jetë triumfues



fizikisht, si njeri, por them që procesi i krijimit, krijimtaria letrare gjithmonë ka triumfuar mbi ato rreziqe. E dini, kërcënimi dhe kërkesa e sundimtarëve për të nënshtruar autorët dhe letërsinë në përgjithësi është e vjetër dhe në qarkun evropëndimor ka filluar që në fillim të letërsisë klasike greke. Diskutimeve të gjata e të rënda nëpër polisitet (shtetet) greke kanë qenë të shumta dhe këtyre zërave ka dashur t'u japë përfundime të caktuara Platoni në veprën e tij më të famshme, Republika. Ai ka përfaqësuar linjën e mbrojtjes së shtetit e të religjionit shtetëror nga artistët që mund të jenë të dëmshëm me krijimet e tyre shpesh nebuloze e të gënjeshtërt. Aqë larg ka shkruar ai në qëndrimet e tij sa cenzura e tij ka prekur edhe veprën e madhe të Homerit, Iliada dhe Odisea. Mbështetja e një censure të tillë për platonin ka qenë teoria e tij e krijimit që në klerarkinë e vlerave të imitimit është imitim i objektit, ndërsa vetë objekti partikular fizik është imitim i idesë që është shkalla më e lartë e të vërtetës. Kështu që krijuesi artist në veprën e artit është në shkallën e tretë të imitimit që i bie të mos jetë shumë i besueshëm dhe disa forma të atij imitimi Platoni i klasifikon si gënjeshtër. Te vepra e Homerit imitime të tilla ka parë relativisht shumë dhe prandaj ajo, sidomos me botën e saj emocionale, Akili që zhgrryhet e në baltë e vajton mikun e tij etj., duhet hequr nga vepra kur ajo t'u jipet qytetarëve të ri të Athinës...Gjithashtu për të njejtin princip, ai e ka konsideruar poezinë tragjike si të dëmshme dhe të gënjeshtërt, dhe gënjeshtër është gjithashtu e dëmshme për qytetarët e rinjë... Mesjeta i ka sankcionuar dënimet e tmerrshme si të autorëve, ashtu edhe të librave që kanë guxuar të cenojnë perandorinë imagjinare të Hyut: i ka djegur në turrë të druve që të dy. Madje ajo ka bërë edhe një hap më tutje duke shpallur si të mirë dhe të dobishme vetëm Librin e shenjtë dhe shkrimet e shenjtëve, ndërsa letërsinë artistike si të pavlerë dhe kur dëmi prej ideve të saj të shfaqet si i rreszikshëm për kishën, dënimi që është aplikuar ka qenë drakonik. Në një shoqëri të tillë ngadalë është zhdukur autori dhe është minimalizuar funksioni i tij. Tash, sistemi shoqëror që u shfaq pas revolucionit të Tetorit dhe Luftës së Dytë Botërore proklamoi jo të gjithë letërsinë si të dënueshme, por të dënueshme atë pjesë që shkonte ndesh me principet e deklaruara shoqërore të shoqërisë socialiste. Në ato vende, përfshi shqipërinë, do të shfaqet një tip i artit që do të quhet arti i realizmit socialist. Shmangia prej këtij lloji të artit do të jetë e dënueshme, mirëpo në Jugosllavi ky lloj 'realizmi' nuk ka funksionuar! Për analogji, as në Kosovë nuk ka funksionuar në gjithë dimensionet e vetta, si në shoqëritë diktatoriale komuniste. Ithtarët e këtij lloji të "realizmit" qenë mundur definitivisht

në Kongrsin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë të mbajtur në Zagreb më 1952. Një konflikt kulturor dhe ideologjik mbi këtë çështje që zhvilluar kryesisht në relacionin Zagreb – Beograd, dhe që kish filluar shumë më heret (1928), si shkëputje nga idetë e realizmit socialist rezultoi mbas fjalimit të M. Kerlezhes. Në hapësirat e vendit, ai konflikt ideologjik krijoi një liri të shkrimit letrar përtej realizmit socialist dhe ndikimeve ideologjike marksiste e sovjetike. Nuk mund të cenohej vetëm "vëllazërim-bashkimi" dhe na kosovarët nuk mund të kërkonim shtetin tone! Pa këtë fitore të M. Kerlezhes e të çerthullit të Zagrebit në filozofi e kritikë, letërsia në Kosovë do t'ishte një letërsi e atij binomi "vëllazërim-bashkim" dhe komuniste! Pra, ja që unë kisha lindë (1952) në vitin që ai drejtim mori goditjen fatale dhe për të flitej gjithmonë siç flitet tash në qarqet letrare për realizmin socialist në Shqipëri dhe për letërsinë e atij drejtimi!

Për dhunën serbo-jugosllave: ajo shfaqej e pamëshirë vetëm ndaj shqiptarëve! Madje specifikisht njëherë duhej të të kalonin në ndonjë grup marksist – leninist që në Kosovë formoheshin nën ndikimin shpesh fokloriko-ideologjik të Radio Tiranës dhe saherë që kontakti i kosovarëve prekte në Sigurimin komunist! Zakonisht ishte ndonjë broshurë e diktatorit Enver Hoxha që arrinte rrugëve të fshehta nga ambasada në Beograd ose prej ndoj vizite në Turqi ku kosovarët mund të kontaktonin me njerëz të ambasadës shqiptare etj. Më së shpesht këtë lloj literature e shpërndante siguri i jugosllav. Nëse një autor të ri kosovar UDB-ja ia dilte ta inkuadronte në grupe të tilla, atëherë dënimi e priste në mënyrë të sigurt dhe autori të shumtën e asgjasohej si krijues letrar, se më nuk mund të botonte.

Tash, për veten time, unë nuk kam qenë kurrë në këtë kuptim revolucionar dhe aq më pak komunist i sojit të marksist-leninistëve shqiptar e të Kosovës! Jo. Isha dhe kam mbetë me vokacion letrari mbi të gjitha, madje edhe përtej profesionit të profesionit të letërsisë që e kam ushtruar gjithë kohën e punës. Dhe, nuk kam shkruar kurrë një roman të tillë që mund të motivonte ose të përgatiste njerëzit në mënyrë konkrete për të luftuar për liri! Po të ishte ashtu, romani do të shndërrohej në mjet propagande dhe doracaku praktik mbi luftën! Realiteti i shkrimeve të mija është një realitet artistik dhe ideja e luftës për liri është një ide universale e njerëzimit që nga kohët e lashta e deri më sot. Romani im aty qëndron, mbrenda hapësirës dhe botës së artit, prandaj është i lexueshëm edhe tash dhe besoj do të jetë i lexueshëm edhe në të ardhmen, veçanërisht në situata kur liria cenohet nga cilido agresor, nga cilido pushtues i lirisë!

Mimoza: *Profesor, në kohët e vështira për Kosovën ju keni zgjedhur shkrimin si një nga rrugët më të vështira të rezistencës ndaj pushtuesit serbo-jugosllav. Kundërshtatë e këtij sistemi ndëshkoheshin në format më të rënda. Nuk kisha dashur të bisedojmë për këtë temë, por është pjesë e historisë suaj intelektuale, prandaj të lutem a mund të kujtosh e të na thuash momentet më të vështira me të cilat jeni ballafaquar me pushtetin vetëm pse keni ndjekur rrugën paqësore për rezistencë e liri?*

Zena: Tani, kjo është e vërteta. Kam zgjedhur atë anë dhe kam shkruar disa nga veprat e mia duke filluar nga "Zanoret e humbura", "Sheshin e Unazës", "Udhëtimi arbdhetar" dhe "Romanin për Kosovën", pra katër romane që janë të tilla dhe në të njëjtën kohë janë romane moderne në të cilat thyhen shumë nga konvencat artistike të romanit shqiptar në përgjithësi. Një temë e madhe mbi lirinë nacionale dhe lirinë njerëzore në përgjithësi i bashkon të gjitha këto. Shaqja e tyre, sidomos në fillim, qe pritur në një anë pothuajse me entuziazëm nga lexuesit dhe kritika letrare e Prishtinës, dhe në anën tjetër me rezerva të mëdha nga pjesa e ngarkuar me ideologji jugosllave midis kosovarëve. Por, një gjë duhet ta them, pas rënies nga pushteti i A.Rankoviqit, kosovarët që punonin për te dhe censorët e ndryshëm në botën kulturore të Kosovës nuk e kishin më as tehun fortë të mprehur dhe kishin nxierrë mësim nga historia: bashkëpunorët e sigurimit jugosllav ishin denigruar moralisht e shpirtërisht dhe familjet e gjera të tyre ishin damkosur gjithashtu, prandaj tash nuk ishin më të zellshëm si dikur, sidomos në fushën e arteve ku vlerësimi i e gjykimi mund të rrëzohet lehtë nga argumentet policore! E vërtetë ishte që romani im i parë qe goditur nga disa fraza të një gardiani të tillë dhe nuk qe botuar për disa vite, por kur u botua nuk ak pasur shkrime dhe as vërejtje të asaj natyre, përkundrazi, të gjithë e pranoni në heshtje që romani e ka zgjeruar dukshëm lirinë krijuese në letërsinë e Kosovës dhe jo vetëm për faktin që aty me ngulm kërkohet e identifikohet thelbi i natyrës nacionale shqiptare me të cilin kryeheroi identifikohet, por edhe ndodhë çlirimi nga ideologji-zmat e ndryshme, sidomos atyre jugosllave e komuniste përmes të cilave synohe denigrimi dhe zhbërja e nacionales te kosovarët.

Tani të them edhe se si intelektual kam marrë pejsë në zhvillime shumë të rëndësishme tëpër historinë Kosovës, bashkë me brezin dhe me të gjithë tjerët, ani që për shkak të natyrës së punëve me të cilat jam marrë ka qenë pak më specifike. Praktikisht kam marrë pjesë si student në themelimin e Universitetit të Prishtinës dhe mandej kam punuar në forcimin e tij, sidomos të Fakultetit Filozofik dhe më vonë të Fakultetit të Filologjisë, të cilin e kam udhëheqë në vitet e vështira 1992-1996. Në mbarim të mandatit më ka rënë barra mbi supe ta udhëheq gjithë sistemin e arsimit paralel të Kosovës në kushtet më të vështira të mundshme, sistemin e njohur në përmasa botërore si të tillë, në vitet 1966-1999, pra deri në mbrëmjen e fillimeve të bombardimeve të NATO. Vetëm një orë para atyre bombardimeve kam emituar përmes Televizionit Shqiptar kërkesën që nxënësit e mësuesit duhej të qëndronin në shtëpi dhe të përpiqeshin të mbijetonin nga terrori serb, që do të niste që atë mbrëmje kur ranë bombat e para nga avionët e NATO-s.

Mimoza: *Krijimtaria juaj nuk është mbyllur dhe kam dëshirë të kuptoj kur mund të lexojmë romanin e radhës (nëse veç pranoni të flisni për te)?*

Zena: Tash është e vërtetë që nuk është ende krijimtari e përfunduar. Po vazhdoj të shkruaj përkundër faktit që ka pasë disa raste kur kam dashur të pushoj së shkruari përgjithmonë. Por nuk është se pushova. Tash e lidh këtë me një ndienjë që pas punës së gjatë dhe shpesh të vështirë, megjithëse kurrë nuk mund të përjashtoj nga kjo kënaqësinë time të jashtëzakonshme për secilën fjalë e fjali që

e shkruaj, për secilën vepër qe e përfundoj, ndiej një boshllëk në shpirt dhe nganjiherë më duket që kam humbur përgjithmonë diçka të çmueshme të shpietit, diçka që më ka zhveshë e më ka sjellë para shikimit të njerëzve, në këtë rast lexuesve! Disi ndihem lakuriq ndërsa bota përreth meje është konservatore dhe më shikon me habi...Por kjo ndienjë deri më tash gjithmonë është shkrirë me kalimin e kohës dhe unë kam filluar të mendoj në heshtje mbi mundësinë e shkrimit të ri që disi turbull- turbll shfaqet në vetëdijën time dhe për një kohë të gjatë lëvizë atje pa ia dalë të kristalizohet më shumë...Por e ndiej që stina e shkrimit të ri ka për të ardhur dhe e kuptoi që procesi im krijimit është pak a shumë si i natyrës: mbas dimrit të rëndë që ka ngri çdo gjë në palcë, më së pari diku thellë nisë të lëvizë një lëng i jetës dhe mandej bashk me ngrohtësinë, natyra i pikturon ngjyrat e veta e mbushë botën e vdekur me jetë të re e të papritur! Pikërisht kjo më kaa ndodhur mua deri më tash, tash e një gjysëm shekulli! E ndiej krijimin e ri dhe e kuptoi që nuk mund ta mabjë përbrenda kur vie koha...Një provokim i tillë i jashtëzakonshëm ishte Deti i Zi, një krijim ku tema e dashurisë përthyhet si përvojëpersonale dhe universale...dhe është në pikëpamje strukture e stili krejtësisht e paparë në letërsinë shqipe...


Mimoza: *Si e vlerësoni procesin e përkthimit, e dëmton apo e pasuron letërsinë?*

Zena: Jo që kam përvojë të pasur personale me këtë , por ka gjithë konsideratën për ndërmjetësuesit e këtij profili. Që nga koha e shfaqjes së letërsive nacionale në Evrop roli i tyre është i jashtëzakonshëm për përhapjen dhe leximine letërsisë në tërësi. Gjuha e perandorive që përfaqësonin civilizime qe thërmuar dhe popujt shfaqen veçoritë e tyre gjuhësore dhe me këtë qe shfaqur izolimi në gjuhë edhe i letërive të veçanta.Pa dilemë ë me këtë do të ndryshojë edhe kuptimi i letërsisë në aspektin e ideve por edhe në atë tematik. Qarku i tyre do të kufizohet në nacion dhe shtet. Tash roli i ndërmjetësit bëhet i domosdoshëm, megjithëse përkthyesi është i njohur edhe prej kohëve të lashta. Ndodhë shpesh në kohën tonë që një krijues njuh mirë vetëm letërsinë e vet, por një përkthyes e ka të domosdoshme të njoh dy e më shumë letërsi dhe në këtë aspekt përkthyesi është një njohës gjuhësh, një intelektual që ia bënë të mundur komunitetit të tij gjuhësor të njoh një letërsi tjetër...

Prishtina

Mimoza: *A ke mall për Prishtinën? Si e keni lënë Prishtinën herën e fundit?*

Zena: Nuk e kam lënë as nuk e kam braktisur kurrë Prishtinën. Në njëfarë mënyre unë e kam kërkuar Prishtinën me intuitë, që kur isha i vogël. Ndoshta mundesha ta huqja Veriun, ose Jugun, por Prishtinën jo! Ishte qyteti ku im at i bënte pazaret, shiste e blinte. E mbaj mend që njëherë në fëmijëri, pata dalë në stacion të trenit në Podujevë dhe hipa në tren për Prishtinë. Nuk kisha qenë më parë kurrë dhe nuk i kisha më shumë se shtat vjetë. Pa biletë hipa, se të holla nuk kisha dhe askush nuk e dinte që kisha vendosur ta bëja udhëtimin e tillë. Saherë që shfaqej konduktori unë fshihesha dhe udhdëtimin e bëra mrekulisht dhe pa asnjë problem. E kam pasë shijue çdo sekond të atij udhëtimi: natyra që ndërrohej, fusha e mrekullueshme e grunaje, misri i gjelbërt që ka pasë nisë me tufue, lopët që kullosnin të qeta në livadhe skaj hekurudhës, fëmijët që luaninin...Mandej pata zbrit në Prishtinë, në fakt pak para se të ndalej treni, por unë nuk pata më shumë durim që të shkëlja në këtë qytet të dashur...mandej në peron të stacionit kishte polic dhe shumë punëtorë hekurudhe, kështu që nuk desha të dukesha andej. Mbaj mend që pak çaste më vonë unë u shkriva në rrjedhën e njerëzve që shkonin drejtë qendrës së Prishtinës dhe më dukej atëherë, dita kish shkuar sa çelë e mbyllë



sytë! Unë isha një fëmijë i vogël, e uritur, që e shihte vetën nëpër vitrinat e mëdha të dyçaneve. Duhej të kthehesha në stacion të trenit dhe kur të arrija në Podujevë, më priste edhe rruga e gjatë natën për në Ballofc dhe vetëm kur zbrita vërtetë në stacionin e trenit , fillova t'i përfytyroj përmasat e ndërmarrjes sime të asaj dite dhe menjëherë e kuptova që ishte e frikshme! Kënaqësia e ditës ra në gropën e të frikshmes, që shtrihej në terr përpara meje, dhe të dramatikës që më priste në shtëpi... Më duket që prej atëherë kurrgjë nuk ka ndryshuar në çasjen time ndaj Prishtinës: kureshtar jam sa herë që kthehem, në largësi e imagjinoj secilën shtëpi të njohur, secilën rrugë, madje edhe gropat që nganjëherë edhe i gjej kur kthehem ashtu si i kam lënë kur jam larguar...

Natyrisht që braktisjet e mija tash nga Prishtina bëhen me mjete të tjera dhe malli im është tjetër. Midis asaj Prishtinës që kam njohur si fëmijë dhe kësaj të cilën e gjej secilën herë kur kthehem nga larg ka shumë dallime, por ajo ndienja që ka ardhur në shtëpi nuk më braktisë kurrë dhe, gjithmonë e ndiej atë ngrohtësi, atë dashuri.

Mimoza: *Të flasim për largimi nga Prishtina dhe arritjen në Otava, Kanada. Nuk e kuptoj se si një profesor letërise dhe një nga shkrimtarët më të njohur dhe më të vlerësuar le vendlindjen e tij pasi që mbaron lufta dhe Kosova fiton lirinë. A është koha për të folur për këtë shkëputje të pjesëshme fizike me Kosovën?*

Zena: Gjithmonë është koha për të folur për këtë. Mbrëmjen që ranë bombat e para në Prishtinë na të gjithë u çmendëm nga euforia e ndryshimit dhe ndenjëm nëpër dritare e balkone të apartamenteve. Në mëngjes filluan të rreshtohen lajmet e zeza mbi rrëmbimet dhe vrasjet e njerëzve e të familjeve...prandaj, shpejt e shpejt e mora familjen dhe për tri ditët në vijim u fshehëm te një mik i yni, në Ulpianë. Por kërcënimi arritit edhe aty dhe ne u larguam, tash familja ime gjashtanëtarshë u shpërnda nëpër farefisn tonë, në disa lagje të

Prishtinës. Unë u ktheva në apartamentin tim, në Breg të Diellit, dhe qëndrova aty edhe dy netë, i kyçur nga brenda, pa ndezur drita. Në ndërtesën ku jetoj dhe në dy të tjerat që janë të lidhura me një shesh të vogël, u vendosën forca të shumta policie, me rroba e shenja të ndryshme, forca zyrtare serbe dhe aso të formacioneve paramilitare, siç i quanim. Dola nga apartamenti im i veshur si zakonishht, pa marrë asgjë me vete, vetëm kuletën në të cilën kisha rreth 1700 marka gjermane, kursimin tim. Në ditët në vijim arrita ta mbledh sërish familjen, tani në lagjen Emshiri, ku jetonin vëllazërit e mij. Ditën qëndroja aty dhe natën flija nëpër shtëpitë e lagjes, të cilat qenë braktisur krejt. Ata pak që kishin mbetur të shpërndarë nëpër shtëpia dhe të frikësuar për jeten, kishin vendosur të niseshin për në Maqedoni, në drejtim të Tetovës, ku thuhej se mund të kalohej. Në mëngjesi i renditën veturat dhe në kolonë u nisëm andej. Tash, ai udhëtim drejtë Tetovës zgjati shumë orë, se na mbanin në disa punkte, mirëpo pa asnjë ndërhyrje, vetëm na mbanin deri në një urdhër tjetër, mandej vazhduam. Kështu arritëm thell në brezin pyjor që e ndanë Kosovën nga Tetova dhe ku kishin arritur para nesh një kolonë e pambarim veturash, traktorësh, kamionësh e auatobusësh. Në një kolonë të tillë, bashkë me familjen tme, gruan gheh katër fëmijët, kemi kaluartri netë. Në atë kohë arrita t'i largojë përmes kufirit dy fëmijët e mëdhenjë: vajzën (19vj.) që asokohe ka pasë punuar për OSBE si anglishtfolëve që ishte dhe djalin (17vj) që gjithashtu fliste anglisht. Dy fëmijët tjerë (13 e 7 vj.) i mbajta me ne dhe aty qëndruam gjithë javën: një kamp pa fund, kokën tek kufiri dhe bishtin ndoshta te Ferizai, me bukën qe e shpërndanin disa organizata bamirëse nga ana e kufirit të Maqedonisë. Ditën e tetë që ndodheshim aty ushtria serbe e kufirit urdhëroi kthimin prapa të të gjithë neve që ndodheshim aty dhe përfërsisht një gjysëm dite më ra të prisja derisa më erdhi radha të rreshtohem në kthim. Të gjithë e kishi frigën se ka për të ardhur nata dhe do

të na zë në rrugë, por e vërteta është se aty në mbrëmje unë ia dola sërish të kthehem në Prishtinë dhe kësaj prapë në Breg të Diellit por jo më në banesën time. U vendosa në shtëpinë e tim vëllai, Nazmi Rrahmanit. Aty, kam jetuar afërsisht një muaj... Në ndërkohë I. Rugovën e dërguan në Beograd në një takim të dhunshëm me Millosheviqin. Duke e parë atë takim në tv zyrtar të Beogeadit, vendosa të largohem prapë me çdo kusht. Fatbardhësisht të nesërmen u dëgjua për mundësinë e udhëtimit me tren Prishtinë Elez-han dhe bashkë me familjen hipëm në atë tren në Fushë Kosovë.Të njajtën ditë arritëm në Tetovë, në një familje tetovare që kish strehuar më parë fëmijët e mi dhe që na pritën me shumë dashamirësi. Por dua të them që Tetova e atyre ditëve ishte e stërngarkuar me forca të ndryshme ushtarake, me ekipe të panumërta sigurimesh të fshehta, me militarë dhe paramilitarë. Për një kohë të shkurtër sa qëndrova aty, u kërcënova disa herë dhe familja ime përjetoi dy alarme të rrejshme për vrasjen time. Të gjitha këto më detyruan të marrë vendimin më të vështirë të jetës sime: të hipi bashkë me gruan e dy fëmijët e vegjël në avionin që Mbretëresha Elizabeta e Anglisë kish siguruar për t'i transportuar refugjatët kosovar nga Stenkoveci në Kanada. Në ndërkohë, djali i madh qe strehuar në Gjermani dhe vajza e madhe ka vazhduar të punojë për kanadezët që po merreshin me refugjatët kosovar në Shkup. Vetëm pas gjashtë muajsh ia kemi dalë të mblidhemi që të gjashtë në Kanada, kësaj here në Otava, një qytet tash me mbi një milion banorë, që është edhe kryeqyteti i vendit.

Sa i përket pjesës së dytë të pyetjes mund të them fundi i viteve të '90, sidomos 97-99, kanë qenë vite shumë më të komplikua se që një i ri mund ta imagjinojë dhe shumë më të komplikua se që i shohin njerëzit nga jashta Kosovës, përfshi Shqipërinë, përveç disa të paktëve që kanë qenë të involvuar në zhvillimet në Kosovë. Së pari, në Kosovë kanë ekzistuar dy ushtri, njëra prej të cilave lojale ndaj presidentit Rugova, tjetra kundër, dhe madje nuk kanë munguar në drejtim të tij kërcënimet dhe përpjekjet për ta likuiduar. Pak a shumë nëpër të njëjtën golgotë kemi kaluar të gjithë që në ato vite kritike për Kosovën kemi qenë pranë tij. Unë vetë, kur kam qenë i rrëmbyer prej tre pesonave të armatosur dhe dhe jam trajtuar në mënyrë brutale në rrethinën e Prishtinës. Disa nga miqtë e mi, në rrethin më të ngushtë të Presidentit tashma të ndjerë, janë likuiduar në prag të shtëpisë së tyre, praktikisht në sytë e fëmijve të tyre dhe ndonjëri prej tyre ka shpëtuar pas plagëve të marra nga plumbat e atentatorëve. Mos të harrojmë që edhe pas luftës, ndaj I. Rugovës që ishte i zgjedhur president, i është organizuar atentat me lëndë eksploduese në qendër të Prishtinës, por për fat automobili i tij i blinduar e ka shpëtuar.

Fakti që ndisa prej tyre kanë qenë shkrimtar dhe madje të çmuar, nuk i ka mbrojtur nga sulmi i tyre. Sa për lexuesin shqiptar, të përkujtoj që shkrimtarë të njohur të elitës intelektuale të asaj kohe patën ikur jashta vendit nga plumbat e pastizanëve: Frashëri, Koliqi etj...dhe më vonë Camaj, Kadare...mos të numrojmë të pushkatuarit e dënuarit me shumë vjetë robërie nga ata që vetes i thoshin çlirimtarë! Një grup i tillë marksist-leninist, vërtetë që e kapi pushtetin edhe në Kosovë, por fati i këtij vendi ishte që u futën trupat e NATO-s dhe pjesa civile e personelit të OKB e OSBE dhe dhuna e krimi i mëtejshëm u bë minimal,hakmarrja ndaj LDK-s ngadalë u minimalizua, megjithëse mekanizma të tilla shërbimi të fshehtë kanë funksionuar edhe zyrtarisht deri në pavarësinë e Kosovës.

Dhe së fundi, vetëm sa për ta korrigjuar konstantimin në pyetje, tregova që u largova nga Kosova ashtu si e thash më lartë. Në Kosovë u ktheva dhe pas luftës dhe vazhdova punën e pedagogut të rregullt në Universite dhe prej gati 10 vitesh në ASHAK. Prania ime nuk ka bërë hije vetëm në jetën publike ku kam qenë në vitet '90-ta, por mbas luftës

njerë që i zënë karrikat e pushtetit ka shumë dhe përllajnë bakllavanë ka sa të duash! Tek e fundit Kosova është plaçkitur në këto njëzet e sa vite më shumë se që është plaçkitur njëqind vjet në robëri.

Mimoza: *Tashmë, për më shumë se dy dekada jetoni në Otava, pse nuk e braktisni totalisht Prishtinën?*

Zena: Nuk di sa qëndrojnë këto konstatime. Tash, është e vërtetë që përveç tri viteve të para pas luftës kur kërcnimi për jetën ishte latent, i përhershëm, pjesën tjetër jam kthyer në Prishtinë dhe kam bërë jetën time, në profesionin tim dhe ka shkruar disa nga librat e mi të rëndësishëm. Natyrisht, kam qëndruar edhe në Kanada për një pjesë të vitit, kur i kam pasur pushimet, se atje e kam familjen. Tash, nuk shoh diçka të jashtëzakonshme në këtë, madje unë i jam mirënjohës fatit tim që m'u krijuan rrethanat që një pjesë të mirë të kohës ta kalojë në një vend të tillë. Ai kontakt e komunikim me njerëzit atje, me rrethin kulturor të atij vendi, me mundësitë e mëdha që i ofrohen një intelektual që e ka primar në jetë librin, më ka ndihmuar të shoh një botë tjetër të cilën nuk do ta shihja kurrë duke qëndruar në Kosovë, në Prishtinë. Tani e kam të qartë që të gjithë shkrimtarët shqiptar, duke filluar me Naimin, Çajupin, pastaj Konicën, Nolin, Camajn etj. Madje edhe Ismail Kadare, kanë pasur një moment kur janë larguar nga vendi, sepse vendi i tyre ua ka zënë frymën, lirinë ua ka shpenzuar...të gjithë ata në një moment tjetër kanë mundur të kthehen por nuk e kanë bërë këtë. Jo pse nuk e kanë dashur vendin e tyre, por pse bota e madhe ku kanë shkuar ka qenë kompatible me gjerësinë e shpirtit të tyre dhe ata janë ndier aty më krijues, më njerëzor...

Tash, në veprën time të këtyre dekadave që jam edhe jashtë, kjo mund të shihet lehtësisht, por unë kam më shumë lidhje me Prishtinën, qoftë edhe me këtë Prishtinën që është bërë këto njëzet vite...

Politika

Mimoza: *Për shumë vite keni qenë këshilltar i presidentit hisotrik, Ibrahim Rugova. Bazuar në një bashkëpunim kaq të afërt dhe të gjatëkam dëshirë të lexoj variantin e Zenës se kush ishte Ibrahim Rugova?*

Zena: Ibrahim Rugova ishte i njohur në Prishtinë se drejtonte Botën e Re kur e njoha. Kjo ka ndodhur në fund të vitit tim të parë të studimeve, ndërsa ai mund të ketë qenë nga viti i fundit i studimeve ndoshta. Kishim shkuar në një ekskursion studentësh dhe disa ditë më parë romani im qe shallur si më i miri në konkrsin e Rilindjes. Erdhi të njiheshim. Prej atij viti të largët (1970) e deri në shfaqjen e sëmundjes së tij të rëndë, në një mënyrë kemi qenë në kontakt miqësor. Kemi këmbyer mendime për librat dhe shpesh i kemi lexuar të njëjtit.Në të njëjtën tavolinë me një filxhan kafeje përpara kemi kaluar shpesh kohë. Mandej ai bëri atë hapin e madh dhe duke qenë kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, hyri në jetën politike si kryetari i parë i LDK-s, partisë së parë politike të shqiptarëve të Kosovës, që mori mbi supe fatin politik të Kosovës në ditët kur dhuna e egër serbe nëpërkëmbi çdo gjë kosovare, kur viktimat binin për çdo ditë, kur protestat e shumta përfundonin me gjakderdhje dhe ktheheshin prapë ditëve në vijim. Ishte një tollovi e pashembulltë dhe për Kosovën nuk kish kush të thoshte një fjalë derisa doli ai në krye! Nuk fliste fjalë të mëdha dhe as nuk nxirrte parulla bombastike, por bota kosovare u mblodh rrotull tij çuditëisht dhe filloi t' i besojë atij për gjërat që i thoshte. Me kujdesin e jashtëzakonshëm të një filozofi e njeriu largpamës, formuloi disa parime të thjeshta, me të cilat ia doli të shenjonte kohën dhe të ardhmën e Kosovës. Ishte ai që e ndryshoi mendimin politik kosovar dhe prej idesë për bashkim me Shqipërinë e vendosi parimin e pavarësisë së Kosovës. Kur kjo gjë u arrit, të gjithë shqiptarët e pranuan që



ishte fitorja më e madhe e shqiptarët që nga koha e Skënderbeut. Pavarësia e Shqipërisë nënkuptohej, por e Kosovës ishte përtej andërrave.

Ibrahim Rugova e pati gjithashtu egzilin e tij dhe rrugën e Golgotës poashtu. Ajo rrugë e tij gjithashtu filloi atë mbrëmje kur nisën bombardimet dhe kaloi nëpër strofullën e kriminelit Millosheviq, pastaj në ekzil: Gjermani, Itali dhe kthimi në Kosovë, një udhëtim odisean.

Në këtë kohë, rrugët disi na u ndanë, se unë gjithashtu i kisha rrugët e mia dhe ato të gjitha lidheshin me letërsinë...ndërsa ai e patë braktisur letërsinë...

Mimoza: *Kur e nisët dhe si e braktisët politikën?*

Zena: Nuk them që kam bërë ndoj rrugë të madhe në politikë. Unë isha në politikë përmes portës së letërsisë, përmes artit. Edhe për faktin që isha profesor në Universitet. Ne të gjithë u ballafaquam me dhunën dhe një program shfarosës që Serbia kish hartuar pas vdekjes së Titos. Ajo shfrytëzoi si pretekst demonstratat e vitit 1981 dhe rrëmbeu e dhunoi Kosovën, lirinë e saj. Nuk kishim rrugë tjetër pos të organizohemi e të qëndrojmë. Të them të drejtën unë as nuk isha futur në detyra politike për disa vite, mirëpo në një moment duhej mbrojtur Universiteti, Fakulteti i Filologjisë ku punoja. Prandaj u vune në krye të Fakultetit dhe si dekan, punova në Këshillin e dekanëve të UP. Mandej më 1996 më kontaktoi Rugova dhe mora përgjegjësinë për gjithë sistemin paralel të arsimit në Kosovë. E vërtetë është se gjithë atë kohë ka pasur një ministër në qeverin Bukoshi që rrinte në Gjermani dhe shpesh në Tiranë. Por aq ishte puna e tij. Organizimi, shkolla e të gjitha niveleve, Universiteti, të gjitha ishin në Prishtinë dhe aty ishte përgjegjësia ime për mbarëvajtjen e tyre. Kjo punë u vështirësua tejmasë në vitin 1998, kur antagonizmat midis grupeve të UÇK dhe LDK-së. Përkundër të gjithave, thash edhe që në pasditën e bombardimeve, kur kishin mbetur vetëm pak orë para se të fillonte, unë përcolla mesazhin e fundit në atë detyrë për gjithë arsimin paralel në shkollën shqipe. Pak më vonë me një bashkëpunitorin tim patëm vizituar Rugovën në shtëpi dhe në largim ai na përcolli ndoshta nja pesëdhjetë metra nga shtëpia. Nuk i kishte rojat e zakonshme te dera, as në shtëpi, qe braktisur prej të gjithëve.

Mimoza: *Përvoja juaj e parë në Universitetin e Prishtinës, si ishte?*

Zena: Universitetin e Prishtinës unë e njihja në detaje atëherë, se ai ish konstitue para syve të mijë, në kohën që isha student. Në brezin tim disa profesor kanë shkruar për herë të parë notën në gjuhën shqipe në indeksin e studentit. Ndonjëri, që kish studiue në Beograd, filloi të ligjëronte në shqip, mirëpo më leht fliste serbisht dhe pas disa fjalive në shqip, kalaonte në gjuhën serbokroate. Ama klima politike dhe kulturore në tërësi ishte e jashtëzakonshme! Kuadri i ri universitar kishte plane të mëdha dhe elan të jashtëzakonshëm pune! Béhej gar e hapur për të afruar kuadrin e ri dhe me perspektivë. Ishte universiet i ri dhe pa trohë kozervatizmi...

Mimoza: *Si ishte avansimi juaj i parë, sfidues, korrekt, i përkrahur apo pengues, meqë Universiteti i Prishtinës është i njohur si njëri nga Universitet më të mbyllura dhe barikaduese?*

Zena: Nuk ka qenë gjithmonë i tillë. Kuadri universitar ka qenë me shumë privilegje dhe profesionalizmi e specializimi kanë qenë atutë e forta të UP. Deri vonë normat e punës (të orëve) ishin të ulta dhe favorizohej në forma të ndryshme specializimi në një disiplinë të dijes. Principi ishte një lëndë për një profesor. Po të mbroje magistraturën në romantizëm nuk mund të bëheshe profesor i realizmit.

Mimoza: Keni shënuar mbi 40 vjet përvojë në arsim, a mund të flasim se për çfarë jeni krenar gjatë përvojës në mësimdhënie dhe përvojës menaxheriale në Universitetin e Prishtinës?

Zena: Përkundër faktit qëpothuajse tërë shekulli e punës e kam kaluar në Universit, në fakt thellë në vete unë gjithmonë e kamndie veten një shkrimtar, madje edhe kur kam hyrë në klasë për të ligjëruar një subjekt teorik. Nga ai këndshikim kam folur gjithmonë për letërsinë: me dashurinë e një shkrimtari për letërsinë dhe përvojën që letërsia qëndron më lart se rregullat dhe se teoria në kuptimin që një princip teorik mund të ndërtohet pa e pasë vërtetua praktika letrare. Prandej teoria është e paqëndrueshme dhe vazhdimisht duhet të modifikohet varësisht nga zhvillimet letrare.

Sa i përket aspektit menaxherial, mud të them që si udhëheqës i Fakulteti filologjik të Prishtinës kam ndërmarrë hapin e çlirimit të studimeve nga lëndët ideologjike që për shumë

kohë i kishte imponuar si të domosdoshme sistemi jugosllav. Ka qenë i pari reformim real i studimeve albanologjike dhe jo vetëm, nga koha e themelimit të tij të fakultetit. Të njëjten gjë e ka bërë edhe me studimet postdiplomike, magistraturë e doktoratë, duke i kthyer ato në studime moderne edhe sipas praktikave evrop-amerikane. Në kohën kur e kam drejtuar Fakultin e filologjisë, kam futë në program mësimin e gjuhës së dytë botërore, që me latinishten bëheshin tri. Fatkeqësisht ky projekt më vonë është braktisur.

Një vlerë të veçantë të asaj kohe e mbaj bashkëpunimin me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë, Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e ritë Shkodrës etj. Me të cilët kemi organizuar një numër të rëndësishëm konferencash shkencore, dhe mbi të gjitha për dy vjet radhazi Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë e të Kulturës shqiptare, të cilin e kmi organizuar në Tiranë.

Mimoza: *Nga ligjërata e parë në lëndën e Teorisë së Letërsisë, kujtoi si e krahasonit letërsinë me fushat tjera, dhe si unë u binda se letërisa ofron më shumë mundësi që studenti të krijojë mendimin e tij mbi lëndën e studimit se sa që ofrojnë shumë profile tjera në Universitetin e Prishtinës. A mund të flasim sot për metodat tuaja të bindjes, mësimdhënies që keni praktikuar gjatë asaj kohe?*

Zena: Ai ka qenë këndshikimi im.Nuk do të ndryshoja asnjë presje në atë aspekt. Natyrisht që kam folur para një auditori që në përqindje të lartë i ka pasur ato bindje të formuara, ndërsa një pakicë e vëgël mund të ketë qenë në dilemë cilin profesion ta zgjedh për të ardhmen. E kuptoj që shkolla jonë ka një mungesë të madhe në orientimin e nxënësve për të zgjedhur profesionin. Nuk i përgatitë ata dhe as nuk ua kultivon prirjet...Tash, e pranoj që mund të kem ndikuar në raste të veçanta , mirëpo dua të them që ata studentë që mund të kenë pranuar pikëpamjet e mija mbi artin e letërsisë , kanë qenë studentë të jashtëzakonshëm por që për arsye shpesh të jashtme (kërkesa e prindërve etj.), janë luatur derisa janë përballë me një ligjëratë retorike që ka mbrojtur letërsinë nga sulmet e disiplinave të tjera. Fatbardhsisht, me disa prej studentëve të tillë të dikurshëm edhe sot na lidhë interesimi për letërsinë dhepse jo, edhe miqësia.

Akademia

Mimoza: *Cila ishte rruga juaj për anëtarësim në Akademinë e Shkencave dhe Arteve në Kosovë.*

Zena: Kjo është më e lehta të përgjigjem.: Rruga e librave të mi. Kam shkruar përgjatë jetës sime shumë (për mendjen time!) libra. Disa prej romaneve janë mjaft të vlerësuara dhe tashma në programet mësimore të shkollës në të gjitha nivelet. Edhe mendimi i kritikës për veprën time , nëse mblidhen, sigurisht bëjnë disa vëllime...

Mimoza: *Jeni kryeredaktor i revistës më prestigjioze shkencore “Studime” (Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës), sa e ndjeni peshën e madhe për të menaxhuar grupin punes, të gjitha tekstet dhe për të qenë i qetë se varianti përfundimtar i revistës do të plotësojë kërkesat e përcaktuara?*

Zena: Punoj me një ekip studiuesish të mirë, të gjithë studentë të dikurshëm (të viteve '90 , të kohës së shkollës si sitem paralel dhe të gjithë tash janë profesorë e akdemik, njohës të gjuhëve të huaja etj. Por të kuptohemi, revista Studime e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është e mirë dhe prestigjioze në saje të bashkëpunëtorëve , krijuesve shkencor që zgjedhin t'i botojnë punimet e tyre në revistën që e udhëheq unë në cilësinë e kryeredaktorit. Puna ynë redaktoriale është minore në krahasim me vlerat e punimeve të bashkëpunorëve tonë.

VeptraVazhdon

RILEXIMI I FISHTËS NË LIRI

Nga Frano Kulli



Gjergj Fishta, qe i exkomunikuar për një gjysëm shekulli. Leximi i veprës së tij lirisht qe i pamundur, madje rreptësisht i ndaluar. Një rast unik ky, krejt i veçantë që i ndodh një autori. E çfarë autori! Poetit tonë Kombëtar. Leximi i mbramë i lejuar e i papenguar “Post mortum”, ka vijuar edhe jo më shumë se pesë vite, nga 1940 deri në 1945-ën. Në ndërkohë janë dy botime perkujtimore; “At Gjergj Fishta-Botim perkujtimuer”¹ i vitit 1941, përgatitur nga bashkëvllau , At Benedikt Dema dhe tjetri i së njëjti koncept e format dhe i po të njëjtit vit, botim i revistës “Shkëndija”² në Tiranë. Janë dy momente përndritjeje përreth tij e veprës së tij, por masandej mbas shumë pak kohe gjithçka zbehet e venitet. Ndoshta qe kjo mirakandja e fundme që pasoi preludein trishtues për atë pluhnajen që do të vinte më mbas, terratisja e tij deri në mospërmendje. Mospërmendja ra vetëm me rikthimin e lirisë së fjalës e të shprehjes, atëherë kur rendi ynë shoqëror, si rregjim refraktar dhune u përmbys. Ndër të parat gjëra rreth të cilave filloi të flitej ishte edhe evokimi e rikthimi i Fishtës së ndaluar. Një bërthamë intelektualësh në zë të fushës së letrave e të artit; Ndrekë Luca, Aurel Plasari, Rudolf Marku zatesin shpejt në Shkodër. Një qytetin ku poeti kish ndërtuar lavdinë e vet. Përreth këtij “nukli” u mblodh mjaft qytetarí e etur për liri. Kërkohej rivarrimi human i eshtrave të të çvarrosurit, por njëherësh qe imperativ ripërtëritja e emrit dhe e veprës, strukur nën atë pluhnajen e frikëshme gjysëm shekullore. Duhej “thyer veshi”, më së pari me ripërmendje. Ndaj evokimi, ringjallja e filluar në vitin ‘90, pati shumë kumte e fjalë. Fjalë, fjalë, fjalë. Në Shkodër, në Lezhë, në Tiranë... Dhe kjo çmohej si më e duhura asohere. Për disa vite rresht kështu, gati për një dekadë. Dhe mirë është bërë. Ka qenë nevojë jetike rikthimi. Madje, është proces, ende i papërfunduar. Ndërkohë u ribotuan në mënyrë sporadike një pjesë e veprave... Gjithçka e botuar në gjallje të tij, kishte mbetë e shpërndarë. Nuk u arrit të përmbledhej në një kolanë, ashtu siç e kishte ëndërruar vetë ai. Dhe siç kish porositur në bisedë me njërin prej bashkëvëllezërve, At Viktor Volajn (6.12.1910 - 5 nëntor 1995), gjuhëtar ekselent. Kjo gjë nuk mundi të arrihej prej tij edhe pse ai, fizikisht jetoi gjatë mbas autorit. Në vitin 1941 ai ribotoi të komentuar prej tij “Mrizi i Zanave”. Me këtë botim që ishte i katërti i veprës (i pari daton në vitin 1913 nga shtypshkronja “Nikaj”) ai vijonte bashkëpunimin e tij me Fishtën tashmë të ndjerë, prej aty ku e kishin lënë. “N’ortografi u mbështeta mbi njato kriteret-dëshmon Volaj-mbas të cillash, dy muejë para deket qortuem bashkë me poetin trembëdhet kangët e para të “Lahutës...”. Ndersa me ndrrime të vogla qi bani aty këtu i zhduku edhe disa trajta nëndialektare sidomos të Zadrimës, si **kjoshna** per **kjoshim**, **jena** për **jemi** etj., si edhe trajtat e sinkopueme, (**k’in për kishin**) kur s’e lypte nevoja, tue kenë mendimi mbi një botim definitiv me i zhduk do trajta nëndialektare, qi nuk kishin një arsye të posaçme shprehjeje” Kështu, letërsia e tij, gjalloi vetëm në

klandestinitet, shpesh me risk e rrezik për lexuesin e leximin fshehtas, **ose... si letërsi orale**, gojore. Lahuta, kryevepra kështu. Për shkak të strukturës së saj stilistiko-letrare dhe se qe bërë shumë familjare, një vepër homerike e cila komunikonte lehtësisht edhe në mënyrë orale.(Kam njohur jo një po disa ithtarë që recitonin pa u ndalur me qindra vargje nga ajo, njësoj si vargje të eposit të kreshnikëve.)

Eqrem Çabej, ky albanolog i pa qasje me të tjerë, i pakrahasueshëm, që rrezatonte kulturë evropiane, jo vetëm për shkak të gjithë ciklit të studimeve të veta; të mesme, të larta dhe ata doktorale, që kishte kryer në Austri, porse gjithë jetën e vet studimore më pas e çoi në këtë frymë e në këtë rrugë, shprehet: “*Fishta arriti të ngrejë kështu veprën (“Lahuta e Malcis”) në sferën kombëtare... vepra e tij ka marrë karakterin e një eposi kombëtar. Te ky[Fishta] e kaluara dhe e ardhmja e këtij kombi janë pjekur fatalisht në një pikë simbolike me njëra-tjetrën.* Ai madje shton se: “*nuk mund ta përflasin poetin që ka marrë për lëndë të poemit të tij një trevë njerëzore gjeografikisht kaq të ngushtë; sepse te kjo botë e përshkruar prej tij njohin vetveten jo vetëm Malësorët e Veriut, por gjithë banorët e maleve shqiptare, ata të Verilindjes (Kosovë), të Lindjes (Dibër) e të jugperëndimit (Labëri)*”⁴

4 Gjergj Fishta, botim perkujtimuer nën drejtimin e revistës Shkëndia, Tiranë, 1941. fq.36.(Eqrem Çabej, “Epika e Gjergj Fishtës”).

Po më përtej, është shfaqë edhe synimi shvleftësues, në ndonjë analizë stilistikore, po krejt të sipërfaqëshme, buruar prej ndjesive të xhelozisë, më tepër se prej arsyeve të tjera, besojmë. Arti i Fishtës është përçmuar si **folklorizant**. Duke i vënë përballë vargun e lirë e modernitetin e tij, për kohën, tek Migjeni; duke krahasuar të pakrahasueshmet. E duke mënjanuar faktin që vetë Fishta nuk qe aspak përjashtues por veçse vlersues e inkurajues për talentet e shkrimtarisë së kohës së vet. Sidomos për më të rinjtë. E jo veç i Koliqit, bie fjala, por edhe i Migjenit, të cilin ai e çmonte “*djaloshi i talentuem*”. Kur ndër biseda me të, bashkëvllazën françeskanë i shfaqnin mospranim për idetë a poezitë e tij e madje e cytnin duke i thënë: “Pader, duhet me ju pergjegjë këtij Migjenit...”. E poeti pati dhënë atëherë, në vijim të konsideratës së tij për të, këtë përgjigje për bashkëvllaznit: “*Lenie rahat djalin e Gjushit [Gjergjit] se asht ende i ri...*”; pohojnë bashkëkohës se u thoshte Fishta për të.⁵

Po me letërsinë tjetër të tij ç’u bë ? ... Ç’u bë **me dramaturgjinë e tij** ? Me dramën e melodramat, po edhe me përshtatjet nga fondi më i mirë i dramaturgjisë botërore, shumicave e të cilave qe inskenuar po prej tij. Fishta pati sjellë për së pari **komunikimin**

5 Pohim i dëgjuar prej meje nga At Shtjefen Pistulli(1922-2008), ish nxënës në Liceun Illyricum, 1930-1938



në shqip të saj. Veprimi i tij për teatrin zë fill që më 1902. Asokohe, salloni në Kuvendin e Françeskanëve në Shkodër, ku ishte edhe “rezidenca krijuese e shkrimtarisë së Fishtës” u kthye edhe ndër sallat e para në atë qytet e më përtej, sallë shfaqjesh ku filloi të kumtohej shqip. Dhe vetëm shqip. (Pak më vonë, me 1919, në Gjuhadol, në oborrin e shkollës fretnore u ndërtua një sallë tjetër⁶, një sallë me 300 ndenjësë për spektatorë). Këtë pati kurajë ta bënte Gjergj Fishta, i cili, edhe kur përdorimi i shqipes ende qe i ndaluar nga Perandoria Osmane e futi atë si gjuhë mësimi në shkollat françeskane (liceun françeskan “Illyricum” dhe në shkollën e motrave stigmatine) kur ishte drejtor i këtyre shkollave. Studiuesi Tonin Çobani⁷ na kumton se: “*Aty [në sallonin e fretënve] mendohet se u shfaqën dy skeçet origjinale të Fishtës (“Autori, Shtypshkronjësi” dhe “Përpara derës së Parrizit”), komeditë “Mjek përdhuni”(1905) dhe “I ligu për mend”(1908), të dyja sipas Molierit, si dhe dy pjesë origjinale me karakter didaktik: “Gjuha e Mësimi”(1907) dhe “Nevoja e mësimi”(1907).*

E fundit vepër e tij dramaturgjike që vihet në skenë është melodrama “Juda Makabë”, në vitin 1945, me 28 nëntor, në një vjetorin e çlirimit nga pushtuesi.(Zef Zorba ishte rregjisori, Prek Jakova muzikanti. Preka, i izoluar për arsye biografike, në një shtëpi burg aty në Shkoder, ditën e çonin nga aty, në teatrin e jezuitëve ku bëheshin provat për shfaqjen e në darkë e kthenin përsëri në shtëpinë burg). Ajo qe shfaqja e fundit e “Judës...” dhe e fundmja shfaqje me tekst nga veprat dramaturgjike të Fishtës. Këtu e këndej gjithçka venitet e struket. Ende sot, Fishtën e citojnë dhe e përmendin rrallë si **dramaturg**. Ani pse ai është autor i 40 dramave e melodramave, të shkruara a të përshtatura. Me shkrimtarinë e vet në gjininë dramaturgjike(që kryesisht është e shkruar në vargje), por dhe me vënien në skenë, thujse të shumicës së veprave të këtij zhanri, Fishta u shenjua vetëdijshtëm si **themeluesi i teatrit shqiptar**. Kurse Faik Konica, në esenë e tij të gjatë “Shqipëria, kopshti shkëmbor i Europës juglindore” shkruan: “*At Fishta është marrë me secilën gjini letrare dhe në të gjitha ka qenë i suksesshëm*”⁸

Po me satirën? Satira qe përmbledhë në “Anzat e Parnasit” që me 1907-ën...Shkruan At Pashk Bardhi një bashkëvëlla françeskan: “*Në vjetë 1907, nuk më bje në mend se në ç’muej, nëpër liqe të Shkodres kthete prej një udhëtimi qi kishte bâ në Vjenë Abâti i Mirditës, Emzot Doçi. At Fishta, At Benardin Shllaku e unë i duelem përpara ku ndaloi vaporri. Kur hime n’lunder për me ardhë në qytet[Shkoder] e thirri Fishten me ndjejë bri tij e i kallxoi se në Vjenë të gjithë, profesorë e studenta e të gjithë qi u merrshin ndopak me gjuhë shqype ishin t’entuzjasmuem per “Oso Kuken”[Kënga e dytë e Lahutës] e lavdet qi i kish ndie prej sish nuk dijte me i shprehë. Atë Fishta e pveti.”Po per “Anza t’Parnasit”,*

6 Lec Shllaku, Maskat shkodrane-Kur lindej teatri, fq.60

7 Tonin Çobani, Ndue Ballabani:”Teatri i Gjergj Fishtës”, fq.132

8 Faik Konica:”Shqipëria, kopshti shkëmbor i Europës juglindore”, Tiranë 2006, fq.83

1 At Gjergj Fishta, Botim perkujtimuer, nën kujdesin e At Benedikt Dema, Shkoder, 1941.

2 Gjergj Fishta, nën kujdesin e revistës “Shkëndija”Tiranë,1941.

3 Gj. Fishta, Mrizii Zanave, botimii katërt,parathanje e At Viktor Volaj, Shkoder 1941, fq. 2

Helena Kadare buzëqesh edhe kur flet. Madje edhe kur tregon se këtë natë e ngatërroi dhe humbi rrugën për në Fier. Iu desh të përshkonte rrugica të errëta, pa ndriçim në periferi të tij, derisa të arrinte ta gjente zemrekun e qytetit, që i dukej (sikur edhe më tha) të kishin 300 vjet që kishin humbur njëri tjetrin. Ajo dhe Fieri në mënyrë mistike e kanë rrëmbyer pazgjidhshmërisht njëri tjetrin. Helena Kadare, si në një lojë fëmijërie i ka rrëmbyer qytetit origjinën e vet, të cilën e mban varur brenda shpirtit të saj, si një emblemë të kahershme Emblemë me peshë dhe hijerëndë Qyteti u ngushëllua me rrëmbimin e imazhit të saj vajzëror, Duke e ushqyer dalëngadalë fitoi prej saj atë qeshje që di ta jap vetëm një mbesë gjyshërve dhe të afërmeve të saj nga nëna. Sonte çuditërisht secili prej dy rrëmbyesve, kanë rënë mbi krahët e njëri tjetrit. Janë ulur dhe po ngrohen në një zjarr të çuditshëm. Flakët e këtij zjarri e detyrojnë Fierin si një Robin Hud tja kthej mallin e rrëmbyer vite e vite më parë në dritë, Ndërsa Helenës zjarri ia përkthen mallin në trandje dhe qeshje.

Jemi ulur dhe po pijmë kafe në një nga lokalet në qendër të tij. Ky është takimi im i tretë me këtë grua të pamoshë, shkrimtare me sqimë, romanciere e njohur, shqipëruese ekselente, bashkëshorte e gjenit *Ismail Kadare që siç ka deklaruar: “Helena është njeriu im më i afërt, që më ka dhënë gjithë gëzimet e kësaj bote dhe ndaj së cilës ndihem i detyruar për gjithçka”.*

Na takoi fati. Ajo këtë natë rrëmbeu çmimin e radhës në memorialin e krijimtarisë së vet. Fondacioni Harpa e nderoi me çmimin e karrierës. Cmimet nga ky fondacion jepen cdo fund vit. Dhe në aradhen e artistëve, intelektualëve dhe njerëzve të shquar, patjetër që nuk do të mungonte emri i saj. Ulur në tavolinë, me një grup artistësh e botuesish, ku nuk mungonte Bujar Hudhri, ajo rrezatonte. E uruam për çmimin së bashku me prefektin e Qarkut Fier Lefter Shehaj. Ndërkohë që u ulëm të gjithë rreth tavolinës, Bujari iu drejtua zonjës Kadare:

“E ç’Helenë mund të jem unë, kur s’ka askush të më rrëmbejë?”!

“Në anët tona, nuk e kanë rrëmbyer ende Helenën”, -iu përgjigja Bujarit. Ajo është e mbyllur nga lashtësia në qelën e Apolonisë së lashtë. Çelësat e qelës i ka marrë Homeri. Ai dremit mijravjeçarë buzë Semanit. Nëse i vjen drita e syve Homerit, atëherë do të ndodh rrëmbimi i Helenës nga Apolonia- i thashë duke qeshur. Thjesht i tregova një synopsis nga një prej tregimeve të mia.

Helena qeshi. Ma shtrëngoi dorën dhe sërish vuri buzën në gaz. Një mori pyetjesh më endeshin në kokë, Gati po humbisja orientimin. Në fakt krijimtarinë e saj dhe sidomos të gjenit Kadare e kisha ndjekur besnikërisht gjatë gjithë jetës time. Pandemia e vitit të kaluar veç të tjerash, më ndihmoi ti rikthehesha kësaj krijimtarie dhe të rilexoja gjithë kolanën e botimit “Kadare”

“Jemi takuar dy herë rastësisht, Ky është takimi i tretë. Unë besoj të tria”-shtova unë

“Uaa sa bukur e the- Unë sot për pak e humba Fierin. Kam vite që nuk kam ardhur dhe ndihem në borxh-nisi bashkëbisedën ajo . Kur përshkuam disa rrugë të errëta, pa ndriçim, gati dolën në fusha afër detit, mendova se ky nuk mund të ishte kurrësesi Fieri. U rikthyem dhe pas peripecisë, e gjetëm më së fundi qytetin dhe këtë vend ku organizohet kjo ceremoni- u shpjegua Helena.”

Ndërsa fliste dukej se një mrekulli ndodhte mes shpjegimeve të saj dhe përpjekjeve të mia të pambarimta, betejës brenda meje për të bërë pyetje dhe për të rrëmbyer përgjigjet. Kisha patur fatin ta takoja në vitin e largët 1986 në një takim që u zhvillua në Berat me kolosin Kadare. Vetëm ishim përshëndetur. Edhe në takimin e dytë në Tiranë në vitin 1988, në një ngjarje

NJË KAFE ME HELENA K.

Nga Arben Velaj

letrare ishim përshëndetur. E mbaj mend pamjen e saj që shquhej nga larg. Dallohej jo vetëm nga veshja, por sqima e të sjellurit, me sytë që pasi e përpinin dritën, e pasqyronin miqësisht përreth ndër të pranishmit, duke u veshur me disa ojna pikëllimi, që i krijojnë si një rimel vezullues, vetëm ai lloj femrash, që jetojnë nën pushtetin kulturor. Edhe në këtë natë Helena ngjante si një premierë festive, e shënjtëruar së brendshmi nga malli për Fierin e saj të fëmijërisë.

E ftoj për një kafe në qendër të qytetit. Pasi përshëndoshemi me të ftuarit e aktivitetit të fondacionit Harpa, një lokal në periferi, zbresim Qafën e Koshovicës, ngadalë, gati duke medituar përpara një pamje që herë të kujton betejën për çlirim të dritave nga errësira që ka Dhjetori, herë një lloj qetësie të habitshme paqeje që krijohet mes një beteje. Në momentin kur zbriti nga makina, ajo ishte sa befasuese, interesante aq dhe e freskët,

Sa bukur- u shpreh, Fieri ka ndryshuar shumë. Por njerëzit janë po ata, të dashur dhe mikpritës.

“Myzeqarët janë njerëz të së ardhmes.” ka thënë korifeu i letrave shqipe Ismail Kadare te libri i tij “Qyteti i Jugut”. Në lokalin që ne po shkonim për kafe, atje ku sot është “Premium Blea” dikur në vitet e largëta, Kadare, pinte kafën e zakonshme. Pikërisht në të njëjtin vend, ku hija e viteve e Kadaresë, dërgonte sinjale për Helenën, përballë sheshit kryesor të qytetit, shesh i lidhur me nyjet e rrugëve që duket sikur formojnë në cdo kënd të tyre shenjën “Vinceremo”, urbanistikë e hartuar që në krijimin e qytetit nga arkitektë italianë, në atë vend pra, ne u ulëm për të shijuar kafën e Dhjetorit.”

“E meziprita këtë ardhje në Fier- rinis Helena “Jam rritur si një mbesë në këtë qytet dhe mbaj mend shumë mirë që shtëpia e gjyshërve të mi ishte një shtëpi dy katëshe. Përpara portës së saj saj ka qënë një mбетje e madhe prej celiku, Atje luaja. Gjyshi im, ka qënë një tregtar i madh dhe i njohur në zonë. Tregojnë se njëherë shkoi të shiste vaj Ulliri dhe blerësi, i tha se nuk ishte e njëjta cilësi. Gjyshi im këmbnguli që ishte e njëjta. Ai i tregoi mostrën. Gjyshi e mori dhe e rrëkëlleu të gjithën. E shikon tha që është i njëjti vaj? Ahaha tha blerësi. Tashmë u tregove i zgjuar. Nuk kam më mostër për të bërë krahasimin, Dhe qeshi”

Fieri ka histori të bukura, nuk duhet lënë kurrë që historia e tij të zvetënohet dhe mbulohet nga harresa- shtoi ajo. Mbaj mend që më tregonin për portin e Semanit, tregtinë me Italinë nepërmjet këtij porti, apo moli sic e quajnë vendasit. Këta janë njerëz të bukur. Unë jam rritur në një familje që përherë i ka dashur njerëzit. Nuk kam qëndruar kurrë e vetme në familje, por edhe gjatë gjithë jetës. Se si më duket tani atje në Durrës, në shtëpinë ku po jetojmë me Kadarenë. Duket shtëpi me lagështirë dhe me vetmi. Vijnë vetëm bluza të bardha që na vizitojnë dhe askush tjetër. Më lodh vetmia. Dua të shoh dhe takoj njerëz . E kam thënë edhe më parë. Jam mësuar nga familja ime të pres dhe përcjellë njerëz . Kjo më ka ndihmuar shumë në jetë.

-Po Fieri ka histori dhe njerëz të bukur plotësova unë. I rrëfeva për kontratën e shitblerjes së Fierit hartuar në kohën e Portës së lartë, ku blerësi ishte Kahreman Pasha , e sjellë nga historiani dhe publicisti Nuri Plaku, përkthyer nga osmanishtja prej profesor Dritan Egro. Pastaj biseda

rrodhi për këngëtarin Kiu Poro, për urën e gurtë të ndërtuar në vitin 1777 nga e bija e pashait të Beratit, Rrapushja . Ajo dhe kisha e Shën Gjergjit ishin dy nga veprat më të rëndësishme të Fierit. Njëra u hodh në erë nga nazistët gjermanë në 15 Tetor 1944 dhe kisha u rrëzua me diagaç të ushtrisë në 1967.

“Nga Fieri kam dhe plot kujtime të tjera. Po shkruaj një tregim “Stasa” mendoj ta quaj.. Kam në kujtesë atë grua se si e mbledhte bukën nën sqetull dhe na e sillte për të ngrënë në fëmijëve. Mbaj mend se ishte një karrocë me kal që unë e pëlqeja shumë ta ngisja. Një ditë e mora karrocën me kalin e mprehur dhe mbaj mend se u solla nëpër rrugica duke e ngarë aq sa i zoti i karrocës u merakos. Sepse kali nga zëri im fëmijëror nuk ndalonte po rendte me galop- qeshi ajo. Do ta botoj së shpejti te Bujari apo jo Bujar?.

Bujari vë buzën ne gaz dhe pohon me kokë. “Ex libri” i tij, u vlerësua nga Fondacioni Harpa për punën dhe vlerat që përcjell te lexuesi.

“Unë nuk e shijoj dot leximin në kompjuter -. Ndjesia më e bukur është të shfletosh një gazetë letrare apo libër dhe të duket sikur përqafojmë njerëz, - ndërhyt Helena

“Më ke lodhur,- i them me shaka Hudhrit, Ku nuk kam kërkuar për një libër, botimin tuaj. Nuk e kam gjetur. Bëhet fjalë për “Biseda në Paris” të Branka Bogavac..

-Ah, Branka- ndërhyri Helena. Kam patur fatin ta njoh dhe ta kem mike këtë grua të rrallë .

-E kam lexuar parathënien tuaj në këtë libër- shtova unë.

Me Brankën kam plot histori të çuditshme. Gati të pabesueshme. Sapo ishim shpërngulur me Ismailin në Paris në vitet 90. Adresën nuk ia tregonim kurrkujt. U njoha me atë rastësisht dhe nisëm të takoheshim shpesh. Sidomos në kafenetë e bulevardit “Saint Germain” Ajo është malazeze dhe burrin e ka francez. Ai e ndihmonte shumë në pasionin që ka. Përherë ishte befasuese në shkrimet dhe artikujt e saj. Mbaj mend se kërkonte të njihje Ismailin. Por siç thashë ne ruheshim nga shërbimet e Ambasadës tonë. Nuk tregonim adresë. Një ditë ishte takuar rastësisht me atë në metro dhe i kishte kërkuar që ta intervistonte. Kishte këmbëngulur aq shumë të dinte dhe shtëpinë ku ne banonim dhe Ismaili i ftohtë siç është, pyetjes së saj se ku banonte ishte përgjigjur “ Në Paris”!

Kur erdhi në shtëpi më tregoi për një grua malazeze që i kërkonte intervistë. Qesha dhe i tregova se e njihja Quhej Branka Bogavac dhe se në intervistat e saj ajo përpiquej të intervistonte vetëm kolosët e letrave dhe artist botëror. Branka është thesar. Ngaqë u bëmë shumë miq, e quanin mike e shqiptarëve në Mal të Zi. Por ajo nuk e vuajti kurrë këtë etiketim. Komunikimi, të shkruarit, njohja e thellë e autorëve të intervistuar, dhuntia që ka për të dëgjuar dhe mënyra se si e nxjerr intervistën nga mendja e saj dhe e hedh në letër është një art më vehte- Ajo i ka bërë nder artist botëror me punën e saj- theksoi Helena.

Stafi i bar Premium Blea kërkoi të bënte një foto. Helena u ngrit nga tavolina dhe iu plotësoi dëshirën.

Po afër ora 22 00. Më bëri përshtypje vitaliteti i kësaj gruaje. Kaq e njohur, ajo ka aftësinë të të tërheq nëpërmjet buzëqeshjes së saj në fillin e bisedave dhe historive pambarim. Aq sa nuk do të mjaftonte një natë dhjetori. Pasionante dhe e dhembshur e çmallur deri diku pas një largësie sic e tha dhe vetë 300 vjeçare nga Fieri, këtë mbrëmje dhjetori, Helena Kadare i ofroi Fierit një cast nga jeta e saj, Unë një kafe ndërsa Fieri ia pasuroi emblemën e mallit, varur në gjoksin e saj, me një lloj dashurie që nuk do të zërë ndryshk kurrë.



Shkrimtarët sugjerojnë: Cilët libra të dhurojmë për festa?

MIRA MEKSI:

Festat e fundvitit hedhin përherë një pluhur magjik në jetën tonë që na bën më imagjinarë, por edhe më të gëzuar, edhe kur pesha e pandemisë vazhdon të na rëndojë në zemër. Ëmbëlsirën shpirtërore për këto festa, njëlloj si thelbi dhe natyra e tyre, do ta sugjeroja të lehtë, onirike, fantazore, me zhbirime realitetesh paralele dhe zbulime fantastike. Me një fjale, të ndodhë që lexuesi me të shijuar copëzën e parë të saj, ta lerë veten të rrëmbehet nga fantazia, njëlloj si gjethja e rënë nga era e vjeshtës, – pothuaj të gjithë përbërësit i propozoj të jenë tregime, mundësisht të shkurtra:

Vdekja dhe Busulla – Jorge Luis Borges – Përmbledhje me tregime nga “Fiksionet” dhe “Alefi”.

Tregimet e tij të jashtëzakonshme bëjnë që lexuesi të përsiatet mbi jetën, dijen dhe gjithçka tjetër, duke u nisur nga fantazia.

Dymbëdhjetë tregime pelegrine – G.Garcia Marquez – Thjesht perla të realizmit magjik.

Si aromatizues:

Rrëfenja gotike – Robert Louis Stevenson

Magjistari i madh i letërsisë fantastike, ushqyer me legjenda dhe personazhe të errët, me sytë e imagjinares, e kthen irrealen në realitetin e njëmend dhe makthin në një tejëz të ndjeshme...

Dhe qershia mbi tortë, i vetmi roman mendoj që i shkon atmosferës së leximit gjatë festave:

Muzgu i perëndive të stepës – I.Kadare

Për mua romani më i ndjeshëm dhe më i arrirë i autorit, një lloj autobiografie e mrekullueshme ku shpalolet tërë magjia e teknikës rrëfimtare kadareiane.

BESNIK MUSTAJAJ

Petro Marko, **“Retë dhe gurët”** (Intervistë me vetveten)

Një libër krejt i veçantë në opusin e pasur të prozave të Petro Markos, ku autori shpalos me ndershmëri jetën e tij prej shkrimtari të përkushtuar si pjesë e vorbullës historike të Shqipërisë së shekullit XX.

Mitrush Kuteli, **Novelat**

Me novelat e tij, Mitrush Kuteli dëshmoi se gjuha shqipe, edhe pse pa ndonjë përvojë të madhe në prozë deri atëherë, kishte aftësi të pashterrshme për ta shprehur në thellësi dramën e shqiptarit si pasqyrim universal të njeriut.

Ismail Kadare, **“Pallati i ëndrrave”**

Ky është, në vlerësimin tim, romani që shënon triumfin përfundimtar të mjeshtrit përballë sistemit politik të represionit mbi fjalën dhe përfytyrimin njerëzor.

Fatos Arapi, **Vepra poetike** deri tani më e plota, në katër vëllime, të botuara te “Neraida”

Një vepër, e cila e vendos pa mëdyshje poezinë shqipe në tryezën e parë të poezisë së madhe europiane të shekullit XX.

BASHKIM HOXHA

Megjithëse Krishtlindje ka në thelbin e vet fjaleën lindje, unë do të sugjeroja disa libra që sjellin vlerat dhe gëzimin e jetës përmes titujve që kanë fjalën vdekje.

Do të ishte një dhuratë e mrekullueshme :

800 hapa larg Venerës e Virion Graçit

Një libër i mrekullueshëm për jetën e parë nga pasvdekja. Histori njerëzore të kësaj bote që vazhojnë në përjetësi. Dhënë me një stilt të përsosur dhe karaktere tepër të goditur.

Vdekja më vjen prej syve të tillë nga Rexhep Qosja

Një ndër librat më të bukur të letërsisë shqipe që di të tresë bukur esenë dhe letërsinë, të sjellë mendimet filozofike të konkretizuara në marrëdhëniet njerëzore.

Te vdesësh nën diell nga Ervin Nezha.

Për mua ka qenë zbulimi i këtyre viteve, një shkrimtar i formuar me një stil të cilit i qëndorn besnik, dhe që di të sjellë në mënyrë të natyrshme filozofinë e thellë të jetës njerëzore përmes historive koncize që argëtojnë edhe përmes anekdotës.

Një shaka e vogël me vdekjen.

Në romanin tim më të fundit, kam zgjedhur argëtimin me vdekjen për të ofruar harenë dhe gëzimin e të jetuarit si një nga ndjesitë për të cilat kemi nevojë jo vetëm në kohë festash, por përditë.

VIRION GRAÇI

“Extra-Time” - Durim Taçi; Roman origjinal për nga stili, kompozicioni dhe tonet rrëfimtare; nga një histori e dhimbshme vetjake ka mundur të ndërtojë një histori romanore tërheqëse, estetikisht e arrirë.

“Duartrokitësit” - Bashkim Hoxha; Me sigurinë dhe seriozitetin prej shkrimtari të sprovuar rrëfen objektivisht akte të jetës sonë publike ku grotesku dhe komikja nuk kanë nevojë të shpiken - mjafton perceptimi artistik dhe përfshirja e tyre në veper në gjendjen kuazi-natyrle.

“Mbyllur për pushime” - Stefan Çapaliku; Retrospektivë fiskionale në histori duke përfshirë shkathtësisht njerëz, vende, episode të regjistrave nga hapësirave të ndryshme etno-kulturore rreth një ideje themelore - historia është e plotfuqishme dhe absurde në marrëdhëniet me secilën qenie njerëzore.

“Vargmale nën dhë” - Nurie Emrullai. Libër poetik individual me pasurinë e një botimi antologjik; larmia e motiveve të lëvruara dhe ligjërimi i kultivuar e bëjnë të andshëm leximin e poezive të saj.

(Vijon nga faqja 7)

*monsinjore, shka thojshin...*⁹ “... Është i vetëmjaftueshëm edhe pohimi i kësaj bisede për të ndaluar te vendi që zinte satira në aspiratën krijuese të Fishtës, që heret. Madje, njihet deri më tani se publikimi i parë i Fishtës është një vjershë satirike “Zoti Anselmo Lorecchio në Vienë”, e botuar në nëntorin e vitit 1899, në “Albania” të Konicës, që asokohe dilte në Bruksel.

“Gomari i Babatasit” qe shkruar, inskenuar edhe botuar në 1923. Në kohën kur doli ajo tronditi skenën shkrimore e intelektuale, por atë politike mbi të gjitha, me thellësinë e mendimit e forcën e satirës që fshikullonte dallaveret e shumta të politikës e mbartësve të tyre, kryesisht. Edhe “Visku...” që për “arsye prudence”, siç autori na pohon, mbeti e pabotuar...

Mbas ndalimit të tij edhe satira mbeti e transmetuar heshtazi e frikshëm vetëm si...lexim anekdotik. Në vend të **satirës së tij**, që në bashkëkohësi kishte pasë arrit majat , “lexohej”, transmetohej Fishta **hokatar**. Pra qarkullonin gojë më gojë anekdotat e tij dhe përreth tij sidomos, herë të thëna bukur e herë jo bukur. Ishte pra, aspak më shumë se vulgaritet me zëvendësue satirën e kulmeve të arritura deri atëhere me hoka. *Siç është vërejtur, “Gomari i Babatasit dhe “Visku i Babatasit”, janë shenja të larta emancipimi mendor e shoqëror të shqiptarëve, të cilët nuk na kanë lënë, për fat të mirë pa dëshmi dinjiteti për të përballuar të vërtetën. Në këtë pikpamje, kjo vepër mund të krahasohet, siç është krahasuar me “Udhëtimet e Guilverit” tek anglezët, me “Shpirtrat e vdekur” tek rusët, me “Gjermania-një përrallë dimri” te gjermanët etj.*-shkruan studiuesi Stefan Çapaliku.¹⁰ Edhe tani, para tri vjetësh, kur u vu në skenë “Gomari i Babatasit”, në Shkodër salla e teatrit qe plot për disa netë, po nga zyrat u patën shigjetuar me turivarje...

Po me prozën: publicistikën, eseistikën ç’u bë ? Ndoshta përkufizimi i Lasgushit “meditans e militans”[ëndërrimtar dhe luftarak] do t’i shkonte më shumë se çdo perifraksim tjetër produktit të shkrimtarisë së tij në këtë fushë. Si stil shkrimtarie e si problematikë sociale. Që intonohet e shërben edhe në të sotmen. Në të vërtetë, asnjë personalitet shqiptar i kulturës, rezident i përhershëm në truallin ku lindi, nuk ka marrë nderime e vlerësime të pafundme superiore sa At Gjergj Fishta, në gjallje të vet, i rrethuar me lavdi si askush deri atëherë në Shqipëri. Njëri syresh, Luigi Federzoni, shkrimtar, publicist dhe politikan i rëndësishëm i kohës,[Ministër i fashizmit], një ditë pas vdekjes së Fishtës shkruan: *Në të [Fishten] kemi pá se gjallonte e rrahte zemra e shpirti i kombit fisnik shqiptar me të gjitha bukuritë e miteve origjinale, të traditave mistike e kalorëse, të dokeve besnike të vjetërsisë, të ndjenjave heroike. Secili nesh ka kuptue se Gjergj Fishta kishte me të vërtetë lartësinë e Poetit Kombëtar. Tashti e dijmë se vepra ka për të mbetë në mende e në nderim të shqiptarëve*¹¹. Ndoshta më shumë se çdo vlerësim tjetër është ky, sa për notat e larta, po aq edhe sepse rrëzon qëndrimet e herëshme, që rishfaqen ende sot, herë pas here si akuza të tërthorta të shërbesës a bashkëpunimit me fashizmin. Po ka edhe një pohim të vetë autorit akademik që na vjen nga At Danjel Gjeçaj,¹² si dëshmi në mbështetje të arsytimit tonë e si drojë largpamëse e keqkuptimit e vetë Fishtës: *...Ndoshta ndokush, tash apo ma vonë, kur unë s’kam për me mujtë me u mprojtë ka për të më fajisë [bërë me faj] për këtë “kokardë”[stemë] që báj...se unë i jam shitë italianëve apo, çka do të ishte edhe ma zi, se unë jam bá fashist: dije se Akademitë, edhe pse cilësohen me emen të atij kombi e të asaj qeverie prej së cilës mbahen, janë gjithnji e përherë katedra të përbotëshme për dije e art. Svedia [Suedia]- shtonte- u ep çmimin “Nobel” të gjithë dijetarëve e letrarëve në shenjë të botës dhe kurrkush s’thotë se i shpalluni “Nobel” asht ba svedez [suedes].* Kështu e argumentonte Fishta para studentëve të vet kurreshtarë, momentin e shënuar të jetës së vet.

Kurse sa i takon polemikës, një shkollë në vete, ende e munguar tek ne, Fishta qe zotëruesi *“par excellence”* i saj në bashkëkohësinë e vet; një model për t’u ndjekur edhe sot, për kthjellësinë e ideve, për principialitetin e pa lëkundshëm asnjë fije, por edhe për kulturën e bashkëbisedës e dialogut. Janë shembëlltyra të paarritëshme ende sot shkrime polemike si “Gabove Hilë” apo “Për një fjalë të pavend të zotni Mehdi Frashërit” Por edhe në fushë të estetikës me esetë: “Poetët e m’dhaj t’ Italisë” apo “Shenime estetike”, të cilave ke pse t’u kthehesh edhe sot.

Rileximi në kohën e lirisë

Sot vepra e Fishtës, rezulton të jetë e plotë në duart e lexuesit të dëshiruar. Në dy variante; një botim i transiletruar i ardhur sivjet dhe një tjetër që në 2012-ën, i plotë, integral gjithashtu, i paisur me aparat filologjik e gjuhësor. I arsyetuar kështu si një mënyrë më e lehtë komunikimi me lexuesin. Edhe një “Fjalor i veprës së Fishtës”, sapo ka dalë nga shtypi, një muaj më parë. Mendojmë se është një çelës i nevojshëm leximi. Për të kuptuar e shijuar më mirë e më plotë veprën. Se, më së pari, risjell atë pjesë të leksikut, prezent në veprën e autorit, por të stopuar atje prej suspancës së mospërdorimit e mungesës së kontaktit me lexuesin. Dhe për së dyti edhe për të mënjauar sa të jetë e mundur pretextin e moskuptimit të veprës e të autorit, për shkak të këtij leksiku “të vjetërsuar”, që ka shërbyer gjithherë këto kohë si vjeggzë për të varur në të vjetërsinë, anakronizmin, për ata që e duan Fishtën atje në cepat e harresës prap tani e përjetësisht.

Por janë gjithashtu edhe katër prej veprave përfaqësuese të gjinive letrare (“Mrizi i Zanave”, “Lahuta...”, “Juda Makabë e Jerina ase mbretnesha e luleve” dhe “Gomari i Babatasit”) si botime të veçanta, paisur edhe këto me shpjegimet filologjike të sipërpërmendura, prezenca e të cilave e ka dhënë një efekt, sado të pakët në mardhënien e nevojshme të autorit klasik me brezin më të fundit. Tani, imperativ mbetet hyrja meritueshëm e klasikut në shkolla, gjë të cilën, autoritetet përgjegjëse të këtij vendi nuk po duan e nuk po duan ta bëjnë... E jo vetëm burokracia shtetërore e kalbur, por për më shumë edhe raporti i faktorit letrar me Fishtën, që ende ruan sot domenin e dikurshëm të “parësisë”, me qëndrimin e vet e prekin thelbin e leximit të autorit klasik, poetit kombëtar të shqiptarëve.

Ende vijon të jetë i pakthjelluar, i pazgjidhur ngërthimi ndërmjet “mitit” dhe “antimitit” që e bashkëshoqërojnë tash një shekull Fishtën. Dikush e don me patjetër edhe “arkitekt” të madh, (MITI) sikur të mos mjaftojë madhështia e gjithdimensionaliteti letrar e publik i tij e kualiteti i epërm i konfirmuar i shkrimtarisë së tij. Që, në mënyrë të tërthortë e dëmton atë, mendojmë. Ndonëse edhe në këtë fushë ende sot ruhen skica origjinale e përmenden prej bashkëkohësve bashkëpunime me arkitektë të zot të kohës si ing. Ludovik Zojsi. Por më e rëndë, shumë më e rëndë është tjetra; dikush e don ende të sfmumuar, të mënjauar, të anatemuar si dikur; fashist e tjetër gjë këso dore. Janë kryesisht “rrota e burma” nga mekanizmi i ndryshkur i aulave propagandistike të partisë ku për dyzet e kusur vjet flitej me mllef asgjësues për letërsinë e autorëve reaksionarë. E dikush tjetër me heshtim, e pohon ende si “folklorizant” molepsur prej sindromit të të bërit hije. (ANTIMITI). Pengesa jo të vogla këto në hullinë e leximit e të shijimit të veprës së klasikut të shkrimtarisë, Poetit tonë kombëtar.

9 At Gjergj Fishta, botim perkujtimuer, Shkoder 1941, fq.169

10 Stefan Çapaliku: nga “Fishta satirik”, Psthënia e “Gjergj Fishta-vepra 8, Satira”, fq.211

11 “Gjergj Fishta” numër perkujtimuer, botuar nën kujdesin e revistës “Shkëndija”, Tiranë 1941, fq.6.

12 Pal Duka Gjini[At Danjel Gjeçaj], Gjergj Fishta-jeta dhe veprat, Romë 1992, fq.159

Këto ditë botimeve për arbëreshët e Italisë iu shtua edhe libri “Arbëreshët midis mitit dhe realitetit” i autorit Fatmir Toçi. Kjo vepër për historinë dhe të sotmen e arbëreshëve të Italisë përmban një informacion të pasur, gjë që e bën një vepër me shumë vlerë për të njohur “mrekullinë” arbëreshe. Ka jo pak libra për arbëreshët, të shkruar nga historianë e studiues të fushave të ndryshme, por ky botim i ri dallon shumë prej tyre. Ai është shkruar nga një autor i cili vërtet nuk është historian i Shqipërisë apo i arbëreshëve të Italisë, por është ndër njohësit më të mirë të botës arbëreshe. Si kryetar i grupit të deputetëve për marrëdhënie me arbëreshët e Italisë, të krijuar vite më parë, atij iu dha mundësia të shkelte e të shihte nga afër vendbanimet arbëreshe. Siç e thotë edhe vetë në parathënien e librit, ai është “nga shqiptarët e paktë, në mos i vetmi, që ka mundur të shkelë e të shohë nga afër pothuaj të gjitha vendbanimet arbëreshe në Itali”, mbi 510 ngulime, nga të cilat sot kanë mbijetuar rreth 50 komuna e fraksione të tyre. Këto vizita të tij jo vetëm në ngulimet ekzistuese, po edhe të dikurshmet që janë shuar, i krijuan mundësinë të njohë mirë botën arbëreshe dhe historinë e saj, duke i dhënë edhe shtysën për të shkruar për arbëreshët. Për këtë qëllim, krahas shënimeve nga takimet e bisedat me vendësit dhe fotografive të vendeve e të objekteve të vizituara prej tij, ai nisi edhe grumbullimin e literaturës e të dokumentacionit historik përkatës.

Është afër mendsh që vizitat në ngulimet arbëreshe kanë qenë premisa e parë për të shkruar këtë libër. Por jo kushdo të cilit do t'i jepej mundësia për t'i vizituar këto vende, do të shkruante për to. Duhet edhe pasioni për historinë, që autorit nuk i ka munguar. Interesat për historinë Fatmir Toçi e ka dëshmuar me mbështetjen si botues të shumë librave historikë, herë-herë duke nxitur e madje financuar vetë hartimin e disa veprave të tilla. Ky pasion e nxiti që t'i binte kryq e tërthor Italisë, duke vizituar komunat arbëreshe e duke kërkuar gjurmët e vendbanimeve të zhdukura dhe, më në fund, të ulej për të shkruar një libër për ta. Veçoria kryesore e këtij libri, që e bën të ndryshëm nga librat e tjerë për arbëreshët, është se zë fill nga terreni për t'u përfunduar në studio dhe jo nga studioja e duke u mbështetur vetëm në dokumente të shkruara, siç janë librat e mirëfilltë historikë. Kjo e bën më

“Arbëreshët midis realitetit dhe mitit” i autorit Fatmir Toçi


LIBËR I SHKRUAR NGA NJË NJOHËS I MIRË I BOTËS ARBËRESHE

Nga Rami Memushaj

aktual, pasi në të, veç dokumentimit shumë të pasur historik, ka fakte e dëshmi të gjalla si dhe përshtypje e gjykime të autorit për botën e sotme arbëreshe të Italisë.

Duke shfletuar librin “Arbëreshët”, lexuesit do t'i bjerë në sy se me sa dashuri flet autori për këtë degë të shkëputur të trungut shqiptar, e cila edhe pas kaq shumë shekujsh ka mundur të ruajë, si asnjë pakicë tjetër etnike në Europë, identitetin e vet kulturor dhe lidhjen e ngushtë shpirtërore me dheun mëmë.

Libri ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë të tij përshkruhet historia e eksodit arbëresh drejt Italisë, që ka vazhduar, sipas autorit, në tri faza: faza e mërgimeve spontane, që nis nga fundi i shekullit të dymbëdhjetë e deri para vdekjes së Skënderbeut; faza e eksodit, që filloi nga vera e vitit 1467 e deri më 1537, kur qe pushtuar Moreja dhe u shtyp kryengritja e madhe e Himarës; dhe faza tretë e mërgimit në grupe, që vijoi deri në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë. Me një gjuhë prekëse, përshkruhen peripecitë e kalimit nga arbrit të Adriatikut e Jonit dhe të vendosjes në krahina të ndryshme të Italisë, përpjekjet e tyre të mundimshme për t'u përshtatur me jetën në dheun e huaj, përplasjet e tyre me banorët vendës, me klerikët katolikë dhe me feudalët, duke arritur shpejt të bëhen edhe një faktor me peshë në luftën çlirimtare dhe në lëvizjet politike të Italisë. Në këtë pjesë të librit flitet për lidhjet e ngushta të Gjergj Kastriotit me mbretin Alfons të Napolit dhe me djalin e tij Ferdinandin, për ekspeditat e Skënderbeut në Itali në ndihmë të këtij të fundit; bëhen përpjekje edhe për të hedhur dritë mbi fatin e familjeve fisnike shqiptare që mërguan në



Itali pas vdekjes së Skënderbeut, duke filluar me Donika Kastriotin e djalin e saj Gjonin e pasardhësit e tij dhe duke vijuar me familjen e Vrana Kontit, me familjen Dushmani, me Dukagjinët etj.

Autori vlerëson lart kontributin e arbëreshëve në jetën politike të Italisë dhe në kulturën e historinë e Shqipërisë. Ai e njeh lexuesin me intelektualë të shquar arbëreshë: klerikë e laikë, mbledhës të folklorit e të traditave, shkrimtarë, studiues, veprimtarë të arsimit shqip, artistë, politikanë etj.; me individë e familje të mërguarish arbër që u ngjitën deri në majat e pushtetit laik e fetar në Itali. Ai tregon për lidhjet shpirtërore të arbëreshëve me dheun mëmë, për kontributin e tyre në jetën religjioze të Shqipërisë së shek. XVI-XVIII, sidomos në trevën e Himarës historike; për punën e klerikëve të shquar arbëreshë të kësaj periudhe për zgjimin


e ndjenjave atdhetare te shqiptarët, duke u bërë pararendës të Rilindjes sonë kombëtare; për lidhjen e intelektualëve arbëreshë në shek. XIX me Shqipërinë dhe për ndihmesat e tyre të vjera në Rilindjen kombëtare shqiptare; për përpjekjet e tyre për të tërhequr në kolegjet arbëreshe shumë të rinj nga Shqipëria; për traditat arsimore e kulturore të arbëreshëve.

Në mbyllje të pjesës së parë të librit, autori ndalet edhe në të ardhmen e ngulimeve të sotme arbëreshe, shumë prej të cilave e kanë humbur gjuhën shqipe, ndërsa pjesa tjetër janë duke e bjerrë. Tek arbëreshët për këtë temë ka diskutime (në të cilat janë edhe përfshirë edhe studiues shqiptarë) se si mund të ruhet gjuha. Zgjidhjen e pranuar që fëmijët të mësojnë gjuhën e ngulimit të vet, autori e sheh me dyshim, pasi është vështirë për t'u jetësuar (se duhen abetare e gramatika për çdo ngulim). Si rrugë shpëtimi të diasporës arbëreshe dhe të gjuhës së saj nga asimilimi ai sheh ndihmën e atdheut mëmë, forcimin e marrëdhënieve arsimore, kulturore e ekonomike me bashkësitë arbëreshe, shtimin e kontakteve të ndërsjella etj.

Në pjesën e dytë të librit jepet një informacion i shkurtër për ngulimet arbëreshe të 17 krahinave të Italisë, nga Kalabria në Piemont e nga Sicilia në Sardenjë, si dhe për kishën ortodokse arbëreshe. Libri shoqërohet edhe me një numër pasqyrash të vendbanimeve arbëreshe, të mërgimit të tyre të brendshëm në Itali, të kishave e famullive arbëreshe etj. dhe mbyllet me një bibliografi shumë të pasur.

Kjo pjesë është ekstrakt nga një vepër më e madhe e autorit, me të dhëna të hollësishme për ngulimet arbëreshe, e cila pritet të dalë së afërmi.

“Arbëreshët midis realitetit dhe mitit” është një libër i shkruar me një gjuhë të thjeshtë e të zhdërvjellët, pa alambikime të frazës, siç ndodh në veprat shkencore për historinë. Kjo e bën atë një vepër popullarizuese që mund të lexohet nga kushdo, pa qenë nevoja për njohuri të mëparshme historike. Ajo do t'i japë lexuesit dije për historinë e arbëreshëve të Italisë dhe për gjendjen e tyre të sotme, duke nxitur në ta dëshirën për udhëtime turistike në ngulimet e tyre, për të ndërmarrë studime gjuhësore, historike e etnologjike, për të bërë biznes etj. Dhe, ndoshta, do të nxitë drejtues të bashkive në Shqipëri ose të komunave shqiptare në Kosovë, në Maqedoni të Veriut e në Mal të Zi që do ta lexojnë këtë libër, të vendosin lidhje binjakëzimi me komunat arbëreshe, të bëjnë vizita të ndërsjella e veprimtari kulturore të përbashkëta. Nga përvoja e pasur e drejtuesve arbëreshë të komunave në organizimin e jetës së këtyre bashkësive, drejtuesit shqiptarë të pushtetit vendor kanë për të mësuar e përfutur shumë.



1.
M'u desh të bëja një shëtitje nëpër Tiranë, bashkë me piktorin Helidon Don Haliti. Një shëtitje për të parë realizimet e tanishme, që po ndodhin para syve tanë: Pikturat gjigante në fasadat e mureve. Një projekt në dukje i çuditshëm, i bukur, i vështirë, real, që mund të shijohet me krenari. Grupi i realizimit të këtij projekti nuk ka të bëjë vetëm me Tiranën, po edhe me qytete të tjerë, të vegjël e të mëdhenj, të rëndësishëm e të parëndësishëm. «E kisha projektuar këtë vajzë që të mbante të paktën një libër, thotë Helidoni, por edhe kjo nuk u pranua nga piktori realizues, për të na dhënë një vajzë të bukur teksa prehet e qetë, si të thuash është në qejf të vet.» Krejt rastësisht si rrethanë, por e parandjerë prej kohësh. Diçka nuk shkon dhe vazhdon te mos shkojë, të paktën për librin, madje po bëhet gjithnjë më e pranishme, si një gozhdë kryqi e ngulur në trupin e kulturës, e cila sigurisht i kushton shtrenjtë vendit, sepse mungesa e librit në mjediset publike ka për të dhembur më fort në ndërgjegjen e njerëzve. Kurse qeveritarët e çdo kallëpi fërkojnë duart... E di që gjithkush mund të thotë: po pse i mëshon fort idesë se libri do kujdes qeveritar... Edhe ai që pret përgjigje e ka të qartë se të paktën poshtë këtyre pikturave monumentale e murale, me një art klasi dhe të bëra me uri të madhe, me personalitet dhe energji që s'ka për t'u harruar kurrë, pasi krijon një mjedis të jashtëzakonshëm, duhej të ishte një bibliotekë pse jo fëmijësh, të rinjsh, komuniteti, po edhe profesionale, për gratë, për autikët, për të gjithë, pa u lodhur të gjejmë terma se janë pa fund. Detyra e qeverisë për mjediset kulturore e publike është jo vetëm të sigurojë mjediset, po edhe t'i pajisë me fonde për të pasur brenda libra. Por deri sot asgjë e tillë nuk bëhet, përveç parullave mashtruese, për të hedhur hi syve. **Biblioteka pa fund!** Dhe jo për të hedhur hi syve, por **të vërteta!** Nëse duam që ky yni të mos kthehet në popull gabel, që shumë shpejt ka për të harruar gjuhën shqipe...

2.
Helidoni më shpjegon sesi u arrit ky projekt në Tiranë e qytete të tjera. I përulem punës së madhe që bëjnë. Është vërtet e jashtëzakonshme. Por do të doja që të ecnin në një front me to edhe gjithë zhvillimet e tjera kulturore. Vinim nga një promovim libri në librarinë *Onufri* në Tiranë «Dorëshkrimet e fshehta të burgut» dhe diskutonim me z. Astrit Hykaj, kur befasohe mi me një koncert fëmijësh në lulishten «1 Maji». Ja kjo që po shihnim të ngashënjën, të fal emocion, të gëzon. Pak më tej është mbi Kafe *Libri* një nga muralet e reja që së largu hedh dritë, personalitet e më tepër shpirt edhe mbi ty. Poshtë duhet të ishte siç ka qenë dikur një librari, ndoshta edhe kafe-librari, ose kafe bibliotekë. Por me sa duket kafe *Libri* ekziston veç në kujtim të librit. Ia arritëm edhe kësaj dite! Mrekulli! O zot, si më erdhi kjo figurë shtegtare prej shkrimit të librave në ditët tona të rrënuara. Pikturat monumentale, muralet e reja dhe me vështrim modern i japin qytetit frymë dhe energji të bukur, por ato nuk ndërtohen ditën për t'u prishur natën, sepse pamja natën do drita që ta rrahin, nga buron edhe drita e pikturës, se pemët duhen krasitur, ndryshe pamja prishet. Kjo nuk është thjesht «përshtypje udhëtimi», por ndjesi që duhet ta shkaktojë përfitimi i plotë kulturor që njeriu, qytetari të fitojë energjinë shpirtërore aq të munguar. Pastaj sa mirë do të qe sikur të mbetej vetëm përshtypje dhe jo realitet.

3.
Isha te libraria 'Adrion' dhe po diskutoja me një mik, jo thjesht rreth halleve të përbindshme të kulturës në Shqipëri, po edhe për kontrastet e forta. U dha një

LIBRAT DHE TIRANA MONUMENTALE

Librat e falun janë të gjithë njësoj dhe nuk lexohen... Ma mirë po shof një pikturë monumentale...
[Daniel (David) Gjeçaj -Vatikan]

Nga Xhevair Lleshi



koncert ngjitur me ne në skenën e re dhe në krejt teatrin e ri të Operas dhe Baletit (ku fle edhe Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore (i dikurshmi, natyrisht) dhe ngaqë televizionet nuk arritën ta jepnin të plotë reportazhin e përgatitur enkas, mbetëm pa mend sepse nuk u fol për të ftuarit Plácido Domingo dhe Ermonela Jaho, për të mësuar diçka të bukur dhe kuriozitet artistik rreth tyre, sidomos për divën tonë, sepse mjaftoi krisma e armës së një burri mbi gruan e vet në Divjakë që i zyntoi lajmet dhe televizionet harruan gjithçka dhe u morën me vrasjen. Dhe kështu ndodh përditë. Por ama askush nuk e vë gishtin në plagë: Zotërinj, para se të ndërtoni ndonjë copëz rruge njëzet milionëshe, ju lutem më parë mendoni që me gjysmat e pareve të një kilometri rruge të artë, të ndërtoni një **bibliotekë** dhe një *librari - bibliotekë*, të një biblioteke kopshti a shkolle, të diçkaje që sjell kulturë, që fëmijët të mos këndojnë në sheshe të improvizuara në mes të rrugës, por në vendet që kanë përkujdesjen shtetërore. Kjo ditë i munguar në kulturë ikën dhe nuk vjen më...

Ne këqyrnim librat në përgjithësi, të vjetrit, klasikët, të rinjtë gjithfarësh dhe diskutojmë për njëmijë e një mungesa, por gozhdë në tru është **libri**. E kemi *Adrionin* një mrekulli, por do të donim që ky të qe kudo dhe të plotësonte çdo nevojë. Pastaj një *autobus-bibliotekë lëvizëse*, që menjëherë fiton emër, sepse lëvizja e tij është kudo në hapësirat shqiptare, ndoshta edhe si një grackë që u ngre njerëzve vetvetiu libri. Ai autobus-bibliotekë lëvizëse është një mjedis i ndrequr me hir e përkujdesje, s'ka pse të duket si një sallon mode, por një katalog i madh librash që shëtit kudo dhe lë pas libra që marrin njerëzit kudo në vend, të tjerë që hipin dhe lexojnë atë në këtë risi kulturore...

Para se të ecim më tej, duhet tërhequr vëmendja: Para dy-tre muajsh, me faturë tatimore të rregullt i dërgohen ADRION-it POEZITË E ROLAND GJOZËS në 14 vëllime edhe si tituj më vete, por LIBRAT

nuk pranohen prej LIBRARISË ! Pse? A ke dalë për këtë punë? Po! Atëherë mos luaj me librin! Nuk je ti që përzgjedh librin që do jetë pjesë e ekspozimit në librarinë tënde. Dhe kështu? **Librin poetik!**...

4.
More, ti s'je në të, ke lajthitur më duket! A e di ku jeton? Jo? Ne na udhëheq një artist që nuk i do librat dhe as një popull që të dijë. Ah, xhaketat treçerekëshe, kollaret e bukura, pikturat moderne dhe sidomos librat që shkruan ai vetë, vetëm ato pinë ujë! Të tjerat, gjithçka do hedhur në koshin e plehrave! Ai do të ishte gati të ndërtonte nga një bibliotekë të vogël edhe në çdo pallat mjaft që aty të ishin një *Kuran*, një *Bibël* dhe një *Kurban*. Kaq. Të tjerat janë kot. Na zuri goja lesh, or mik i dashtun, u bëmë zhele duke ulëritur që mbi Lanë, kudo ku ka ura anash tyre të ndërtohen vetëm biblioteka të mëdha me holle e stil që t'u shërbehet kulturuar qytetarëve, me struktura xhami dhe mjedise çlodhëse, me studio piktorësh, ku reklammat të bubërrojnë me kopertina të mëdha librash që natyrisht të ngashënejnë dhe bëhen magjepsës, ku harmonizohet financimi shtetëror dhe ai kulturor, ku e nesërmja e shkollës dhe e librit shqip do të jenë krenari dhe veçanti tërheqëse e këtij vendi. «Të paktën, do të thonë me siguri, pamë një vend të vogël plot me libra, pamë Tiranën, që mot (2022) do të jetë kryeqytet i rinisë, me piktura monumentale dhe me libra... More plot me murale dhe me libra pa fund! Të bëhet zemra mal! Shqipëria në kohën e qoftëlargut kishte 4-5 mijë biblioteka!»

Edhe në librarinë ALBANIA tregohet i njëjti «kujdes» si tek libraria ADRION me 14 librat (vëllimet) me poezi të **Roland Gjozës**, botuar në pranverë 2021 nga UEGEN. Pse gjithë ky «kujdes i madh» mospranimi!... Nuk arrijmë ta kuptojmë!

5.
Librat! Piktura monumentale! Dy gjëra që i dua dhe i nderoj shumë. Mund të rri

me orë të tëra pranë tyre. Duke shëtitur me Helidonin fantazia shpërthen: herë bëhet si udhërrëfyese e librit të përshtatshëm, herë mbeteshim pa frymë para «Vajzës me një tuftë lule» aty ku është kryqëzimi i rrugës *Kosova* (dhe jo i Kosovarëve, siç quhet aktualisht!) me rrugën e re të *Olimpikut* dhe pallatit të sportit *Era*. Edhe njerëzit më me temperament që nxitojnë kot së koti, i mbajnë këmbët dhe pëshpëritin: Bravo! Veç ta shohësh në sy Helidonin, i kishin marrë një shkëlqim të bukur, hijerëndë dhe me tjetër vizion. Ti, or mik, i thosha Roland Gjozës, një nga ditët e tij tiranase, se këto pallate të bukur në dy blloqe harkore, buzë liqenit artificial, do të shpëtojnë nga pesha e tyre dhe eleganca e përsosur dhe kaq? Jo, ato do t'i shpëtojnë vetëm kur në të të hijeshojë **libri** dhe **kultura**. Në njërin *qendra kombëtare e librit për të rinj*, në një tjetër *qendra kombëtare e pikurës*, në tjetrin *salla e koncerteve*, pastaj edhe *biblioteka mbretërore* etj., etj... Mrekulli! Ti di vetëm gjërat e tua dhe vetëm ato thua! Por mendo, miku im, se kjo botë ka edhe plot gjëra të tjera përplot madhësi dhe elegancë...

Libra që mbushin tejprtej raftet. Histori të zakonshme jete. (Jo thjesht llaç e tulla, që endin pëlhura merimange plot me të papritura, ndonëse me tharm e të hatashme dhe me stimël!). Pastaj libra morali, feje, botime që të çorodisin... Romane me dashuri. *Tre shokë*, të Remarkut. Jo? Grataciela prej letre. Çmime te kripura. Male me tulla, myku e byku? Plot. Hyjnë e dalin emigrantë. Dhurata. Peng trishtues me librin e dikurshëm po edhe me vjersha idiote qe duhen mësuar përmendësh. Pranë tyre piktura monumentale. Një ndjenjë e re prej snobi, a prej njeriu te kulturuar? Jo, janë mënyra krejt sfiduese! Një përmendore e beftë dhe një ndjenjë pendimi e hidhur për librin. Ku janë poezitë? Goxha librari të mos ketë një raft për poezitë? Jo, duhen kënde të sajdisur e të zgjedhur për libra personalitetesh! Personalitete leshi! Grimasa të lehta, Dhimbje. Të qeshura të krisura. Monotoni. Dhe mbi faqe të godinës shumëkateshe një pikturë e re monumentale. Ja në këtë sfond ngrihet edhe Tirana e re monumentale që ngroh emocionalisht veten dhe përqesh librat.

Kopertinat e librave! Zot më shpëto! Ç'përshtypje! Letërsi zbavitëse! Dhe libri i autorëve shqiptarë, të njohur e të panjohur. Ja një parullë: NDALOHEN LIBRAT E AUTORËVE SHQIPTARË ! Tallje. Shkrimtarët më të mirë! Kërcënime të lehta në zë, po të mbështjella me mirësjellje. Po ku e dini ju se këta janë shkrimtarët më të mirë? Përralla. Dështim, me një keqardhje për veten...

Ngushëllim për veten; Balzaku, Drajzeri, Çehovi, Dostojevski, Tolstoi, Mopasani, Floberi, Hygoi, Turgenievi janë aty. Pranë tyre mjeshtrit e mëdhenj, të vdekur, Noli, Pasko, Shvarci, Zheji, Kokona, Caci, Evangjeli, Doko, Selfo, Shllaku, Lacaj, Gjeci, Bllaci, kanë lënë pas një bibliotekë të tërë! Përballë nesh një pikturë e re monumentale...

Tiranë, më 29 shtator 2021

E kisha bërë zakon që gjatë qëndrimeve të mia të gjata e të shpeshta në Budapest, ta kaloja një pjesë të mirë paradites në kafene Művész, që në hungarisht do të thotë “Kafene artistësh”. Ishte kafeneja tipike letrare e shekullit të 19, me tërë hijeshinë që i karakterizonte ato: tablotë e varura nëpër mure, fotografitë e artistëve të shquar, pasqyrat gjigante me kornizat e gdhendura, llambadarët e kristaltë, orenditë e rënda prej druri të errët e të ngjeshur. Me laptopin përpara zija vend rreth orës dhjetë të mëngjesit në një nga tryezat e rehatshme të sallës së dytë, e cila më dukej më e qetë, ndonëse kafeneja ishte përherë tumbllaz nga turistët. Punoja përmbi dy orë. Kafën e parë kamarierët ma sillnin menjëherë, ndërsa të dytën pas një ore, të shoqëruar përherë me ëmbëlsirat e mia të parapëlqyera: quheshin **vaníliás kifli** dhe ishin gurabije të vogla me një aromë ëmbëlake vaniljeje, në formën e hënës të ngrënë, që simbolizonte fitoren e ushtrisë hungareze përmbi atë otomane, përmbi flamurin e hënës së ngrënë. Me të mbyllur laptopin, përpara se të kthehesha në apartamentin e tim biri aty pranë, ulesha në karriget përpara kafenesë dhe qëndroja minuta të tëra për t’u çlodhur në atë vend piktoresk përballë operës, duke soditur gjithçka ndodhte në bulevardin Champs Elysées të Budapestit: *Andrássy út*.

Ishin ditët e para të majit. Pas dëborës së papritur të prillit, koha ishte ngrohur dhe lulet kishin shpërthyer. Sodisja që nga përpara kafenesë sime bulevardin, dhe një fllad i ngrohtë që vinte nga “Kodra e trëndafilave” e cila ndodhej në bregun tjetër të Danubit, në Buda, e mbushi tërë atmosferën me aromën delikate e të mrekullueshme të trandafilave të bardhë të Budapestit. Një lloj frymëzimi i beftë aventuror më cyti të mendoja se ndoshta kish ardhur koha të vizitoja labirintin e famshëm të katakombeve të kështjellës mbretërore të Budas, perlës së Danubit, që shpëlante hijen në ujërat e tij. Im bir më ish lutur kushedi sa herë të më shoqëronte në labirintin e katakombeve, dhe unë kisha refuzuar gjithashtu. Nuk i dua labirintet. Ose më mirë, i dua në letërsi por kurrsezi nuk dua t’i ndiej dhe as t’i përjetoj në lëkurën time. Më ngriheshin flokët drizë përpjetë sa herë që e përfytyroja veten në hapësirën e tyre të pabesë, të koklavitur, qorrollitëse, të lagësht, të mbyllur, të gurtë dhe të ftohtë si barku i pafund i një gjarpri mitologjik, pa vënë në llogari misteret, kobet dhe mënxyrat që fshehin, se fundja për këtë janë krijuar; më akullohej trupi sa herë e vendosja veten në qendër të një labirinti, unë vetëm përballë jetës dhe vdekjes sime... “Nuk jam gati” i thosha tim biri kur e nxirte atë temë në bisedë. “Po çfarë shkrimtareje je ti?” më vinte ai në sedër, “që nuk dëshëron të futesh në misterin e Vlad Hungulësit dhe në atë të Kontit të Zi?”. Sepse emri tjetër i labirintit të kështjellës së Budas është “Labirinti i Drakulës”. U kujtova, megjithatë, se përpara një ore, kur për një çast ngrita kokën nga kompjuteri dhe e përqëndrova vështrimin përmbi pasqyrën e madhe të kafenesë së artistëve, ujërave dhe refleksëve të saj pashë një tjetër labirint të ekzistencës sonë. “Mos ndodhemi në të vërtetë brenda një labirinti dhe kërkojmë tërë jetën qendrën e tij?” Pa e lënë të më ftohej frymëzimi aventuror, atë mesditë maji të mbushur me aromë trëndafilash të bardhë, i telefonova tim biri. “Jam gati Marin” i thashë fare shkurt. Atij iu deshën pak sekonda për t’i rënë në të vendimit tim, dhe sikur të ishte përgatitur prej kohësh për përgjigjen, ma ktheu: “Shumë mirë. Sonte në orën gjashtë, me fener a kandil në dorë për në Labirintus Budavari”.

Kohën e kisha përpara, mora një gotë unicum dhe me sytë në bulevardin plot gjallëri, por pa e patur mendjen aty, u vura të përsiatesha për labirintet. Iu qasa atyre miqësisht, sepse m’u kujtua Labirinti Borges. Jo ai letrar që shkrimtari i botës e ndërtoi vetë me shtigje që bigëzohen, me lojëra shahu, me simbole dhe metafora; labirinti tjetër që bota e ndërtoi me emrin e tij dhe në nderim të tij:

DRAKULA NË LABIRINTIN E TIJ

Tregim nga Mira Mexi

Filli që dora e Arianës la në dorën e Tezeut (në tjetrën ndodhej shpata) që ky të futej thellë në labirint dhe të zbulonte qendrën, njeriun me kokë demi, apo siç e dëshëron Dantia, demin me kokë njeriu, dhe ta vriste dhe të mundte, pasi ta kryente trimërinë, të shthurte rrjetat prej guri dhe të kthehej tek ajo, dashuria e tij. Ndodhi kështu. Tezeu nuk mund ta dinte se në anën tjetër të labirintit ndodhej labirinti tjetër, ai i kohës, dhe që në një vend të paracaktuar ndodhej Medea.

Filli ka humbur; edhe labirinti ka humbur. Tani nuk dimë nëse na rrethon një labirint, një kozmos i fshehtë, apo një kaos rastësor. Detyra jonë e fisme është të imagjinojmë që ekziston një labirint dhe një fill. Nuk kemi për ta hasur kurrë fillin; ndoshta e gjejmë dhe e humbasim në një akt besimi, në një kadencë, në një ëndërr, në fjalët që quhen filozofi ose në vetë lumturinë e thjeshtë.

J.L.Borges (Filli i Fabulës) Knosos, 1984

ngrihet në jug të Mendoza-s në Argjentinë, pranë qytetit San Rafael dhe zë një sipërfaqe prej dy hektarësh. 8 mijë shkurre Boj krijojnë labirintin e gjelbër, i cili ka formën e një libri gjigant të hapur me shtigje që vizatojnë dy herë emrin e plotë të Borges-it si edhe simbole të tij, orë prej rëre, etj. Me sytë e shpirtit në Labirintin Borges, m’u ndërmend se nëpër guvat e njeriut të lashtë janë zbuluar vizatime labirintesh. Njeriu është rritur dhe zhvilluar njësh me nocionin e labirintit. Mitologjitë dhe misteret e të lashtëve, grekëve dhe egjiptianëve, nëpërmjet labirintit flasin për metafora të thekshme të jetës së njeriut, të së mirës dhe të keqes. Simbolika dhe filozofia e shpjegojnë mitin e labirintit si anën e dyfishtë të shpirtit njerëzor, si kompleksitetin e tij. Njëlloj si minotauri përbindëshi, i vendosur në qendër të labirintit të Kretës, shpirti njerëzor mban të erttën brenda thelbit të thelbit të tij të fshehtë. Labirinti është njeriu përballë universit. Ai është edhe kuptimi i jetës njerëzore: flatrimi i Dedalit, labirintbërësit të famshëm të Kretës dhe birit të tij simbolizon ngritjen e mendjes së njeriut drejt njohjes, çka e nxjerr nga mbyllja dhe absurdi i jetës së tij...

Frymëzimin aventuror për t’u futur në labirintin e kështjellës së Buda-s ma kish sjellë flladi i ngarkuar me parfumin delikat të trëndafilave të bardhë të Rozasdomb-it, “kodrës së trëndafilave”. Nuk mund të ishte i rastësishëm një përkim i tillë, rropullive të Rozasdomb-it, në malin Gellert ndodhej labirinti i gurtë. Iu ngjitëm kodrës së kështjellës së Buda-s pasi kaluam urën Elisabeth, një nga urat e varura përmbi Danub, ku dashnorët kyçnin drynat e dashurisë së tyre. Që nga lartësitë e kështjellës, në bregun e majtë të Danubit, pamja që shfaqej para syve ishte përrallore. Ujërat danubiane kishin marrë ngjyrën blu të qiellit të mbrëmjes dhe kuqëlimi i fundmë i diellit në ikje u jepte shkëlqimin farfuritës të ciflave të diamantit, ngrehina e Parlamentit, përbindëshi i gjembëzuar nga një pafundësi kullash neogotike, statujash dhe kupolash neorilindase, ndriçuar nga një galaktikë dritash, dukej e tëra e veshur në ar, ndërsa urat e varura në atë univers bukurie, gjer ku të hante syri, ngjanin si gjarpërushe yjore që stërpiknin qiellin me Danubin të bashkuar ... “E kush mund të futet paskëtaj në barkun e gurit?” thosha vetmevete. “Tani që

pothuaj kam prekur qiellin me dorë.” Por nuk mund të kthehesha mbrapsh.

Jashtë kështjellës, në rrethinat e saj, në adresën Uri utca 9, në fasadën e një ngrehine të zakonitë ndodhet porta me kanata hekuri dyfletëshe, me një hark po prej hekuri sipër dhe një tabelë të varur si një flamurkë ere: Labirintus. Sidoqoftë, porta e labirintit mund të ishte kudo; shënimet e vizitorëve, në të tjera kohë, e vendosnin gjatë, rrëzëmal, në një rruginë të harruar...

Miliona vjet më parë, në kohërat parake të planetit tonë, ujërat nëntokësorë termalë kishin gërryer shkëmbin dhe kishin formuar një rrjet gjigant guvash të nëndheshme me llagëme, kalime, tunele, gjarpërore, puse, vrima të humnershme që shkojnë në zemër të tokës, burime, kube, harkore, kamare... Pesëqind mijë vjet më parë njeriu parahistorik i shpellave ishte strehuar në to. Në mesjetë, ky rrjet labirintik ishte përdorur për burgje, kamare torturash, varreza të fshehta, por edhe si vendstrehim. Më pas u përdor si spital ushtarak, strehim si edhe vend instalimesh të fshehta nga pushtetet e kohës.

Do të përshkonim atë pjesë labirinti që lejohej për vizitorët, përmbi 1200 metra. Dhe përmbi 16 metra ose 53 këmbë thellë nën tokë.

Me të kapërcyer portën me kanata dyfletëshe, me fenerin fitilvaji që ma kish vënë në dorë një punonjës i labirintit, pashë një shkallë të thikët guri që hapej poshtë këmbëve të mia; nga të dy anët, mure guri të ngushta, dhe një atmosferë e ftohtë, erëmbyllur, e lagësht dhe e mistershme më përfshiu sakaq. “Mbese vërtetë nevojitet një fill Ariane” mendova ndërsa zbrisja me shumë kujdes shkallët. Përtej shkallëve, duke shkelur përmbi një truall të fortë, i cili kish raste bëhej i rrëshqitshëm, ose i mbuluar nga uji, hapej errësira që s’kishte fund. Misteri bëhej më i thekshëm. Andaj e kishim zgjedhur atë orë të mbrëmjes për të hyrë në labirint, dritat e rralla brenda tij ishin fikur krejt dhe na duhej të lëviznim vetëm nëpërmjet dritës së pakët të fenerit. Kisha mësuar se, për të lëvizur sigurshëm brenda një labirinti, mjaftonte të ndiqje anën e djathtë të tij, dhe ta shoqëroje lëvizjen me dorën në mur. Porse aty nuk bënte punë. Na duhej të zhbironim guvat e pafundme dhe të lëviznim brenda hapësirave të tyre. Bënim udhë im bir përpara dhe unë e kapur pas tij. Humbëm drejtimin. U kthyem disa herë në pikën e nisjes, në korridorin që hapej poshtë shkallëve të thikta të hyrjes.

Muret e guvave kishin vizatime parahistorike kafshësh. Ajri ishte i mbushur me erëtimi; tavani ulej aq shumë në disa vende sa duhet të përkuleshim për të kaluar. Ecnim fare ngadalë dhe shpesh këmbët i tërhiqim zvarrë për të kontrolluar truallin. Feksnin aty-këtu pllanga drite që shuheshin sakaq. Duhet të ishin të tjerë vizitorë me të tjerë fenerë. Pas një bërnyli të gurtë shumë të dalë, pamë një pellg drite të zbehtë, i cili u fik menjëherë porsa i shkuam pranë. Nuk kishte frymë njeriu. “Nëse ekzistojnë vërtet fantazmat”, foli më pëshpërimë, “ky është vendi ideal për to”. Disa metra më tej, në një sallë të gjerë me kube, e mbyllur me shufra hekuri, zbuluam figurat e mrekullueshme prej dylli. Një botë e tërë kurtizanësh. Zonja dhe zotërinj me veshje të fisme vallëzimi, të përjetësuar në një ballo me maska të ngrirë. I bashkuam të dy fenerat dhe zumë të sodisnim ballon e ngrirë. “Duke si veshje të 1800-tës” i pëshpërita tim biri. “Është legjenda e Kontit të Zi”, ma ktheu ai që e njihte mirë labirintin. Nisi të ma rrëfente: “Konti i rënë nga vakti, por hedonist i thekur, dashuror i marrë i kënaqësive të stërholluara, jetës mondane dhe ballove me maska, pallati i të cilit ndodhej përmbi një pjesë të labirintit ku strehoheshin cubat dhe kusarët e kohës, bëri pazare të fëlliqta me ta. U merrte pjesë nga pasuria e përgjakur që krijojnë me vrasje dhe zhvatje, dhe i lejonte të fshiheshin në guvat e labirintit. Me atë pasuri të mallkuar ushqente orgjitë e ballove me maska dhe shthurjes. Një vajzë e pafajshme humbi jetën prej paudhësive të kontit që kishin nisur ta quanin Konti i Zi. Fantazma e vajzës e përndoqi kontin kudo, gjersa ky humbi jetën në rrethana krejt të mistershme gjatë një balloje me maska në pallatin e tij. Ndodhen këtu” e përfundoi rrëfimin im bir. “Kush ndodhet këtu?” pyeta jo pa një lloj ankthi, sepse pikasa përgjigjen e tij. “Fantazma e vajzës dhe ajo e Kontit” m’u përgjigj ai. “Ka mbi dyqind vjet që fantazma e Kontit të Zi organizon ballo me maska këtu poshtë. Kështu thotë legjenda”. Atëherë e pashë. Por përpara se ta shquaja me sy, veshi më kapi një tingull të dobët, si pulsi i një njeriu në agoni, ndërsa një korrent ajri i ftohtë më mbështolli nga të gjitha anët. Tingulli erdhi dhe u forcua ngadalë duke krijuar një muzikë të vjetër vallëzimi. Përtej dritës që hidhnin fenerët tanë, në sfondin e errësirës përpara nesh, ishte shfaqur një skenë balloje e gjallë si prej tisi dritëhëne. E gjallë është fjala, sepse në të vërtetë ngjante si një lloj mirazhi, por jo nga ata që krijojnë thyerja e dritës në atmosferë, shtresat e ajrit, temperatura apo lagështia e tij. Jo, dukej si një mirazh ku përthyhej kujtesa shtresave të kohës; diçka që kish qëndruar e fiksuar në një kujtesë njerëzore apo në një kohë të ngurtësuar... si një teatër hijesh a dritash që përsëritej pas qindra vjetësh me besnikërinë e një kopjeje të ruajtur me fanatizëm. Apo si kujtesa e shpirtave që kishin ngacur në këtë kohën tonë dhe nuk e kishin kapërcyer dot kufrin e dritës. “Është ballo fantazmë”, i vuri vulën im bir me një fije zëri. I fikëm fenerët. Më rrihte zemra fort nga emocionet: përpara syve tanë, me zbehtësinë e një dritësimi që dukej sikur do të shuhej nga çasti në çast, parakaluan një sallë madhështore balloje, llampadarë të pasur me qindra lotë kristali, valltarë të hijshëm që rrotulloheshin pambarim, vallëzime menuet-i, passepied dhe sarabanda me çifte që kërcenin galopthi... Për një grimë kohe e tërë balloja u derdh përmbi ne, sikur një projeksion kinemaje nga askund ta kish drejtuar nga ne konin e dritës. U gjendëm befas brenda saj dhe emocione të panjohura më gëluan në shpirt. E kërkova me ankth dhe pas çastesh të pafund, e gjeta fantazmën e Kontit të Zi: ishte i gjatë dhe i stërgjatë, si hija e një njeriu përpara burimit të dritës, i veshur me një pelerinë të madhe të zezë dhe me fytyrën të mbuluar nga një maskë me dantella, të cilën e njoha përnjëherë si maskën e famshme të aventurierit venecian: Giacomo Casanova-s. Iu afrova aq sa ndjeva aromën e tij të guximshme, një përzierje e lehtë erëagrumesh me aromë kedri; përnjëherë errësia e plotë na mbuloi.



Balloja fantazmë ishte tretur. “ Kjo s’mund të jetë vepër e njeriut”, i pëshpërita tim biri me një keqardhje të madhe që gjithçka kish mbaruar aq shpejt. “E ke parë ti herë tjetër këtë?”, “jo” ma priti ai dhe më shtrëngoi dorën. “Asnjëherë”. “Pra qenka e vërtetë legjenda”. Ndenjëm edhe pak çaste në errësirë si për të mbledhur veten. Pastaj ndezëm fenerët dhe bëmë përpara.

Kohët, të gjitha kohët, ngjarjet në historinë e hungarezëve dhe në atë të njerëzimit përziheshin dhe linin gjurmët e tyre të dukshme dhe të prekshme në labirintin e jashtëzakonshëm të Buda-s. Statuja humanoide, statuja kafshësh, simbole guri, hapësira mistike dhe kolona shamanike, puse alkimike, aksi i krijimit të universit, objekte të ngarkuara me energji të lashtë krijuese kozmike, por edhe nga ato që shpërhapnin energji negative dhe rrëqethëse që buronte nga dhembja, gjaku, tortura, barbaria dhe mizoria, popullonin hapësirat e paimagjinueshme të labirintit. Te guri i lashtë ndjenim njëkohshëm pulsimin e kohës që kish rrjedhur për mijëra vjetë, por edhe rregëtimin e kohës që do të vinte, në një bashkim halucinant dhe të magjishëm. Drita e mugët e fenerëve tanë ndriçoi harkoret arpadiane me enën e pagëzimit, kalimin e Shamanit ku ndodhej statuja e tij me dy fytyra, para dhe mbrapa, udhën e drerit magjik, kalorësin e humbur, qerthullin e brendshëm, aksin e botës me kolonadat përreth, korridorin e Tartarit, kokën e kurorëzuar që buthtonte përgjysmë nga trualli i pëmbytyr, qelat dhe kafazin me hekura të torturave, pusin e tmerrshëm ku thuhej se ende dëgjoheshin mbyturazi klithmat e grave të reja të një haremi otoman, të cilat pas thyerjes së ushtrisë otomane, i hodhën të gjitha në pusin e labirintit...

Një aromë e pagabueshme vere filloi të ndihej përreth. Në fillim e ndjeva të përzier me aromën e vajit të djegur të fenerëve, por ndërkohë që shtyreshim përpara duke i shkuar pas, e ndjemë të fuqishme dhe të pastër tek çurkonte zëshëm... Në një hapësirë të labirintit të rilindjes, brenda thellësisë së tij, në një si qilar të hapur zbuluam shatërvanin prej guri të mbretit Matthias Corvin I, një nga mbretërit më të rëndësishëm të Hungarisë së Mesjetës. Bllokun e madh të shatërvanit të gurtë, i cili lidhte tavanin me truallin, e mbështillte një bimësi urthi e blertë nga të katër anët ku ndodheshin katër lëfyte prej metali të gdhëndura në formën e kokës së Bakut. Lëfytet derdhnin parreshtur verën e kuqe shkurmbëzuese përmbi basenin e ngushtë të shatërvanit. Iu afruam. Mbodha në dorë pak verë me ngjyrë rubini dhe e afrova ta nuhasja. “Mos”, bërtiti im bir dhe më mbajti dorën. “ Thuhet se mbretëresha Beatrice, e

shoqja e Matthias-it e vrau të shoqin me verë të helmatisur”, shpejtoi të më tregonte.

Vizita nëpër labirintin e katakombeve të kështjellës së Buda-s, ndonëse në errësirë dhe e ndriçuar vetëm prej fenerëve tanë, ishte kthyer për mua në një aventurë të këndshme brenda kohës dhe hapësirës. Imagjinata më ishte përndezur. Nuk më shqetësonte më as erëmbyllja, as vështirësia në frymëmarrje që shkaktonte myku i gurit të lashtë, as akullima e frikshme që ndieja hera-herë në lëkurë. Ndihesha mirë dhe me puls të fortë. “ Duhet të gjejmë qendrën e labirintit” i thashë tim biri me një mendim të ngulët në kokë. “Në labirintin e Drakulës”, m’u përgjigj ai. Pas disa minutash udhë, hymë në një univers vampirësh. Një tym i bardhë mbushte tërë hapësirën dhe drita e pakët e fenerëve tanë mezi ia dilte të ndriçonte objektet e fshehura nëpër shtresa mjergullinash që merrnin lloj-lloj formash halucinante. Duke lëvizur me shumë kujdes që të mos pengoheshim, nisëm të kërkonim qelinë ku Dracula kish qëndruar rob i mbretit Matthias për dhjetë vjetë me radhë, si edhe kafazin prej hekuri ku e torturonin. Që kur lexova romanin gotik Dracula të Bram Stoker-it, u interesova të mësoja të vërtetën historike mbi këtë personazh, që me barbaritë dhe erotizmin e tij prej gjakthithësi vampir, kish ndjellë dhe tronditur lexuesin e shekullit të 19, dhe më pas shikuesin mbarëplanetar të filmit me të njëjtin titull. Dokumentet historike tregojnë se Voivodi Vlad Basarab-i III, ose siç e mbiquajtën më pas, Vlad Tepes, që në rumanisht do të thotë « Hungulësi », ai që i ngulte kokat e prera në hu, ose Vlad Draculea, që në rumanisht do të thotë « dragua i vogël » sepse ati i tij, Vlad II Dracula (Dragoi), ishte pjestar i Urdhërit të Dracula-s (Dragoit), -- ishte princi i Valakisë në Transilvani, Rumani. Luftëtar i madh dhe strateg i dëgjuar në betejat kundër pushtuesit otoman, tradhtohet nga aleati i tij, mbreti i Hungarisë Matthias Corvin-i, i cili e kap rob dhe e mban të burgosur në labirintin e kështjellës së Buda-s për 10 vjet. Ndërkohë që dergjej llagëmeve të labirintit, e shoqja, e bukura Jusztiina Szilagyi, pinjolle e oborrit mbretëror të Hungarisë, gruaja që ai e mbulonte me petalet e trëndafilave të bardhë, vret veten. Vëllai i Vlad-it III, Radu i III, renegat, komandant i forcave otomane, merr fronin e Valakisë, i ndihmuar edhe nga mbreti i Hungarisë. Pas robërisë së tij kalbëse në labirintin e kështjellës së Buda-s, ku iu nënshtrua torturave çnjerëzore, Vlad-i i III merr sërish fronin e Valakisë dhe udhëheq beteja të rëndësishme kundër ushtrive otomane, ku edhe vritet në vitin 1476, në moshën 45

vjeçare. Armiqtë e tij dhe mbi të gjithë, mbreti i Hungarisë, e paraqesin në kronikat e kohës si një torturonjës gjaksor, prerëskokash, hungulës dhe mizor, që pinte gjakun e armiqve të tij. Sërish letërsia ngatërrohet keqas me historinë, fiksioni triumfon përmbi të vërtetën dhe faktet historike duke i shtrëmbëruar ato.. “ Njëlloj si Salieri te romani *Moxarti dhe Salieri* i Pushkinit” më tha im bir. Nuk pata kohë t’ia pohoja, sepse, ndërsa mjergulla e bardhë nisi të dendësohej përherë e më shumë, zunë të dëgjoheshin tinguj të frikshëm, pëshpërima, frymëmarrje të rënda, një e qeshur çjerrëse rrëqethëse – gjithçka që krijonte atmosferën e frikës dhe të ankthit. “ Artifica dhe truke për turistët” folta me zë të lartë edhe për t’i dhënë zemër vetes, sepse në të vërtet, pa kuptuar, zemra kish filluar të më rrihte fort. “ Po i afrohem varrit të Drakulës” më pëshpëriti Marini. “ Po çfarë varri?” sërish bërtita, “ princ Vlad-i nuk ka vdekur këtu. Dhe varri i tij i vërtetë është tanimë e fshehtë e universit”. Në mes të mjergullës së dendur të tymit të bardhë dhe tingujve të frikshëm, skur të kish mbirë nga hiçi, përmbi truall, rrethuar nga zinxhirë të trashë, para syve tanë u shfaq një pllakëvarri njësh me tokën, prej mermeri të kuqërremtë, përmbi të cilën me gërma të feksura ish shkruar DRACULA. Si gurëvarri përmbi të qëndronte një gargull, përbindëshi vampir prej guri të bardhë. Pak më tej, brenda një kamare muri të mbyllur me shufra hekuri, ndodhej një arkivol i zi i hapur; nuk mund të shquhej brendësia e tij. U përkula përmbi varrin e Drakulës. Ishte qendra e labirintit. Por edhe qendra e labirintit tim, brenda labirintit të Drakulës; e kisha gjetur edhe pa fillin e Arianës, ky ishte rasti im. Isha përballur me humbjeudhën, me kohën e gurit, me udhët e ngatërruar të hapësirës së kozmosit, me keqkuptimet e letërsisë dhe të historisë, dhe me humbjeshtëtimin e shpirtit njerëzor... Tani më mbetej të përballesha me të fshehtat e errëta të shpirtit tim, me vdekjen time, a ndoshta me pasvdekjen time. Dhe me hirin e të Madhit, do të mund të merrja udhën e daljes prej labirintit të kohës, udhën e kthimit. Me shpirt të lartësuar.

Ajri ish rralluar papritur dhe mezi mbushesha me frymë. Tingujt e ankthit nuk dëgjoheshin më. As prania e huaj që kishim ndjerë kur e kur. Një marrjemendje e lehtë më detyroi të mbështesja kokën diku. Trupin e ndjeva pupël, të lëshuar në askund. Shtrengova dorën e Marinit dhe mbylla një çast sytë. Një aromë delikate, e mrekullueshme dhe e lehtë, por shumë këmbëngulëse trëndafilash të bardhë, më mbështolli krejt. Mushkëritë m’u hapën dhe nisa të marr frymë lirisht. U zhyta në një paqe të gjatë. Kur hapa sytë, isha fare vetëm, mjergulla e tymtë ishte davaritur dhe pamja përpara syve të mi ishte qartësuar, aq sa

nuk isha në gjendje të kuptoja se në ç’realitet gjendesha. Pranë fytyrës sime pash atëherë princ Vlad Dracula-n. Njoha menjëherë sytë e tij të zinj si nata që më vështronin trishtueshëm, pash krelat pendëkorbi të flokëve të tij të gjatë dhe mustaqet e plota në fytyrën gjatoshë e faqengrënë, kryqin e artë përmbi gjoks, dhe mbi ballë, gurin e madh prej rubini të kurorës që shkëlqente me vezullimin e gjakut të freskët...Luftëtar i madh, mbrojtësi i Krishtëritimit. Më pëshpëriti diçka që veshët e mi nuk arritën ta kapnin, dhe më zgjati një trëndafil të bardhë të porsaçelur..

Duhet ta kisha gjetur udhën e kthimit që niste në qendrën e labirintit, sepse e gjeta veten jashtë tij, në barin e një rrugine pranë Uri utca 9. Me siguri kisha humbur ndjenjat. Pranë meje ishte im bir që më freskonte ballin me një shami të lagur. Më dha të pija një gllënjë *palinka* “ Të jep forcë” më tha. “ Po çfarë ndodhi?” e pyeta. “ U bë kohë e gjatë aty brenda”, ma priti, “ M’u mor fryma mua, jo ty që je alergjike. Ishe si e përhumbur kur të gjeta, dhe të nxora me të shpejtë jashtë”. “ Po ti ku ishe? Mbete vetëm unë?” e pyeta. “ Fare pak minuta. Në një guvë aty pranë isha, po bëja ca foto për ty”, ma ktheu. “ Pe të tjerë vizitorë?” e pyeta sërish me një lloj ankthi. “ Këmbë njeriu aty ku ndodheshim ne ” m’u përgjigj. U çova nga karrigia, ndihesha mendjekthjellët. Ndihesha shpirtplotë. Në dorë mbaja trëndafilin e bardhë të porsaçelur që kundërmonte aromë delikate dhe të mrekullueshme. Im bir e vështroi me bisht të syrit trëndafilin e bardhë, por nuk më pyeti për asgjë. “ Të ketë parë diçka?” mendova, por as unë nuk e pyeta. U nisëm për te makina jonë, kur pamë forca policie që rrethuan hyrjen e Labirintit. Të tjerë policë zbritën nga furgoni i policisë dhe u dyndën brenda labirintit. Veprimet e tyre qenë të rrufeshme. Në pak minuta peshkuan dhe nxorën jashtë tërë vizitorët e labirintit, së bashku me personelin e tij. Asnjë shpjegim. Asgjë. Diçka kish ndodhur rropullive të gurma, por askush nuk dinte të thoshte se çfarë. Në fillim u mendua për ndonjë vepër terroriste, por doli që nuk kishte lidhje. Të nesërmen, të gjitha masmediat kombëtare dhe ndërkombëtare flisnin për misterin e *Labirintus Budavari, 1040 Budapest*, por nuk jepej dot asnjë hollësi mbi të. Lihej të kuptohej që diçka e madhe, e pazakontë dhe e mistershme kish ndodhur brenda tij. U mor vesh që i tërë personeli i labirintit u zëvendësua me një tjetër, pa dhënë asnjë shpjegim, dhe hyrja e tij u vulos për vizitorët për shumë kohë. Për arsye shtetërore.

GOURMET

Unë shtrihem si rrobë përdhe
ti më qepesh përmbi.
Bërë njësh
fërkohemi me hov një copë herë
ndjejmë shend
si tesha të ndera në erë
e mbushemi me reze e zjarrmi
pastaj me bula e me djersë.
Pastaj ti s’pret,
zbret,
më futesh, më zbukuron, më qëndis,
më futesh në mish,
me gjilpërën tënde hyj-e-dil...
më gudulis
me perin më të hollë të kënaqësisë
që kalon nga mishi në shpirt,
ti më shtrëngon, më uthit
sa fryma më buçet, më pëlçet
zërin e gjuhën ma rrëqeth
...dhe gjaku përpëlitet në kockë
derisa dergjemi përdhe
si mish i gatuar me lëngun e vet,
i shijshëm - *gourmet*.

PORTA ME DANTELLË

*Unë të flas dhe ty fjalët të hyjnë nëpër vijën
e kurrizit...*

Kushedi sa e ke bekuar shiun që bie
babëzitur
mbi lëkurën time kryengreh gjithë
mornicat,
këmishën e hollë ma mpleks pas lëkure
si letër cigareje ngjyer me majë gjuhe...
Ti erës i lutesh të mos hyjë midis
të mos e fikë këtë çast si qiri ditëlindjeje,
shpreson që veç me frymën tënde në zverk
të më shpërbësh përdhe si kështjellë rëre.

Sytë e tu shilarës mbi kopsat e mia
varur në një fije peri si në vegjët e vathëve
po vdes të më jesh aq afër
sa të më ndjesh nën qafë aromën e lagur,
...është si t’i vish rrotull kokrrës së kafesë
vetëm me majë gishti, ngadalë, rreth e
qark
të gjesh atë vijën e çarë e të hollë
si brigjet e buzëve që dridhen pa shkak
për të fshehur ndënë të fjalën tënde-
dëshirë
kavërdisur me shi e nxehtësi.

PIKA G

1.
*Ne - dy akrepa ore që i ikin njëri-tjetrit,
por këmbët i mbajnë lidhur në një thumb.*

Ti nisur nga Jugu, unë nisem nga Qendra,
takohemi bashkë në pikën G,
sepse gabim është kjo që bëjmë,
i gabimtë është shendi që ndiej për një të
huaj si ty,
gabimshëm mendimi për mishin
që modelohet në ngërthim si plastelinë
ndërfutur, si vallëzim majëgishtash i
kaçavidës në vrimë
latohemi nëpër lëkurë duke u çukitur,
përpirshëm, butë ndër lakmi
gabim gojët që gurgullojnë e nëpërftyten në
përpëli...
Gabimmu,
gardhohu rreth meje, përmblihdmu si
llapa cullake e veshit
e pështillmë!
Ti hovu, këmbëvjerru, ngutu
dhe gjaku të më dredhet me vërshi...

...Në fund të shohësh si çatisem nën krahët
e tu,
gjumashem si kotele, ngrohtë nën sqetull
bashkë në një përqafim, mbërthyer të dy...

PORTA ME DANTELLË

Poezi nga Rudina Çupi

2.
E keqja vjen pas.
Pas kësaj boboloçke
përfundojmë në një sistem tretës të
mëkateve,
luhatur tërë frikë siç ka zogu një dordolec,
e na hipën në kokë të jemi sërish të
moralshëm...
...Vrima e djegur me cigare në xhup është
e zezë,
të ngulit idenë se dikush të ka treguar me
gisht
dhe, ta fshehësh, është si të kërkosh te
djathi me vrima një strehë.

Rrimë larg...
ndarë si kopsë e vrimë të pambërthyera të
bluzës.
Heshtimë...
Mes nesh një vizë e zezë, si ajo e gurit të
dominosë.
Në vend të çamçakëzit në gojë mbajmë një
grep
se dëshirën s’e mund mbajmë dot te sytë,
kur shkujdesur ngec flokët pas veshi si
perde,
kuptoj se kruspull, thellë, si yjet dimrit nën
jorganin e reve
fle luleradhijja e dëshirës... tek bëhet faqe
burri e parruar.

Dëshira na vjen pas hireve si myshk pas
druri
na rri ngjitur në mendje, ngushtë, si bimë
kacavjerrëse.
Dëshira nuk ka edukatë,
është si qeni që ngre këmbën pas një
peme...
Dëshira nuk është ndodhi... ndodhia është
kaq moderne...

...Pooor (më shumë për keq, sesa për mirë)
i tëri ky qe thjesht një terren prej letre,
ti - prej letre të shkruar, veshur prej fjalësh
si me kostum të zi

unë - letërçarçaf, që më bën lakuriq të
bardhë nate...

VALS

Bubullin. Ti ia beh pas shpine në derë, i
bërë qull,
avitesh ngadalë, përballë,
nuk më përshëndet, vetëm më ngul sytë...
Ti nuhat se çka dua është një vallëzim
ngjitur e lundruet në muzikë
si dy copa akulli që shkrihen ngushtë në
gotën e uiskit
duke bërë kokla-avitje:
afrohemi egër si rrudhje vetullash,
largohemi ëmbël për të puqur sytë,
ka nerv mes nesh si rrufetë...

Ne ngajmë si dy shkopinj restoranti kinez
me instinktin sa një kokërr orizi në mes.

Fjalët e këngës i përflas me frymë,
më shumë se me veshë ti më dëgjon me sy;
ndjek gjuhën: midhjen time rozë tutje-
tëhu
e mes buzëve ngulmon ta kesh...
ta fërkosh me gjuhën tënde përqark
pashqitshëm si lëmyshk i mjalhtë
mendon të derdhesh mbi mua sherbet,
të më përvëlosh si bakllavanë e pjekur
mirë.

Pëshpërit fjalë drithërime pranë veshit
tim,
frymëmarrja e nxehtë më futet nën lëkurë,
gjakun ma gurgullon si qumësht në vlim...
ti më puq pas vetes sa nuk futet fije dritë,
por e gjitha ngjyhem në purpur
në një gjithësi kënaqësie që na përpin
sa me klithmë e me dritë
shpërthejmë lëkurën e bëhemi yj.



PO, DUA!

“Po, dua!”
Dua ta them tani këtë i dashur,
jo duke përsëritur premtimin e rrentë pas
priftit:
“Do të të dua e do të të mbaj.... derisa
vdekja të na ndajë”

Do të ishte më e ndershme t’i thoshim
njëri-tjetrit:
“syrin e djathtë ma lër jashtë...
veshin e djathtë ma lër jashtë...
gjoksin e djathtë ma lër jashtë...
këmbën e djathtë ma lër jashtë...”
Të gjithë e dimë: duhet një i tretë për të
njohur tjetrin.

Por, le t’i lëmë premtimet...
këto vija finishi lidhur me fjongo...

Dua ta dish sa dua, dua mu tani, balsami
im i ëmbël,
të jem vazhdimisht me ty, rreziku im i
dëshirueshëm,
të bëj të gjitha kaçakëritë që kam në
mendje
e të tjera që do sajoj me ty.

Po, dua, i dua të gjitha fjalët tona
që na mbajnë lidhur në trajtë, numër, rasë,
t’i themi me gugurima e qeshje që bulojnë
fishekzjarrë,
e le ta çnderojnë kostumin tënd të zi
që serioz rri si murg i mpirë...

Ulmu ja, mu këtu, përballë,
e me frymë të ngremë një pyll të brishtë,
një pyll të ngrohtë për pëshpërimë
me rrënjë që ngërthehen përposh,
mugulluar me humus e myshk erëmirë
për të fshehur aty emocione të vogla,
që mbijnë, mbijnë, mbijnë.
Eh, poshtë... një fërkim gjunjesh...
që pupthi qimet m’i ngre
dëshira më rend e tërbuar në errësirë:
bishtketrush stomaku hidhet ku të mundë
e zemërdhelpra e ndjek në çdo skutë...

Dua pafundësisht
të më përqumshtësh me shikimin tënd të
qielltë.
Është çasti kur dua me duart-penela
të më ngjyesh lëkurën me ngjethe,
duke kërkuar për veten dhe mua mjaltë a
dyllë peme.

Ngjitu te unë si ujku majë oxhakut,
që bie e përvëlohet në kazanin e nxehtë...
kërko në mua rrugën e daljes
me kokëverbrin tënd duke nuhatur
luleshegën...

Dua ta bëjmë bashkë, hapur, atë fajin që të
gjithë e mbyllin...
kur ty të të bëhet ngrehinë,
të përsëdytemi mbi njëri-tjetrin,
të mëkohemi nëpër epsh e djersë,
lëbyer si dy kërmij në lëngje ngjitëse si
vinovil,
ngërthyer në palzmim.

Avite drejt shumëfletëshit tim
organin tënd me sipërtheks mbi kokë
drejt organit tim si kllapë...
t’i pëshpëritësh si gjuhë në vesh
fjalë të skuqura me pipëtimë e afsh.

Sulmomë me ngulm,
të vallëzojmë të dy si mbi thëngjij të
ndezur,
derisa të biem vyshkur mbi shtrat,
ti - dru i njomë me dy copa prushi në anë,
unë - vatër e lëmyshkur e nxehtë, e qullur,
pa flakë.

Të enjten në mëngjes, në pushimin e vogël midis orës së parë dhe të dytë, Xheromit i kërkuan të paraqitej në drejtorinë e shkollës. Ai nuk u shqetësua aspak ngaqë kishte marrë titullin e kujdestarit – të cilin, pronari dhe drejtori i një shkolle mjaft të shtrenjtë jo-publike kishte zgjedhuar dhe miratuar që t’iu jepej djemve të besueshëm të klasave të ulëta (nga kujdestar kaloje në mbrojtës dhe përpara se të largoheshe nga shkolla për të studjuar, ashtu siç shpresohet, në Marlborough ose në Rugby, përfundoje si kryqtar. Drejtori, zoti Wordsworth, qëndronte ulur në tavolinën e punës i shtangur dhe disi i frikësuar. Xheromit i bëri përshtypje që prania e tij në zyrë kishte shkaktuar frikë.

‘Uluni, Xherom,’ tha zoti Wordsworth. ‘Gjithçka në rregull me trigonometrinë?’

‘Po, zotëri.’

‘Xherom, sapo më morën në telefon. Ishte halla juaj. Më vjen keq, por kam një lajm të keq për ty.’

‘Si urdhëroni, zotëri.’

‘Babai yt ka pësuar aksident.’

‘Oh.’

Zoti Wordsworth e shikoi me njëfarë çudie. ‘Një aksident të rëndë.’

‘Domethënë, zotëri?’

Xheromi e adhuronte babanë: folja e përdorur këtu është më se e saktë. Ashtu si njeriu rikrijon figurën e Zotit, Xheromi rikrijonte figurën e babait – nga një autor të ve, në një aventurier të mistershëm që udhëtonte në vende të largëta – Nice, Beirut, Majorca, e deri në ishujt Kanarje. Përafërsisht në moshën tetë vjeçare, Xheromi besonte se i ati ‘merrej me tregti armësh’ ose punonte për Shërbimet Sekrete Britanike. Në atë çast ai ishte i mendimit se babai do të ishte plagosur nga ‘breshëria e plumbave të një mitralozi’.

Zoti Wordsworth nisi të luajë me vizoren që ndodhej mbi tavolinë. Dukej sikur e kishte humbur dhe nuk dinte nga t’ia fillonte.

‘Ti e di se babai ishte në Napoli, apo jo?’ tha ai.

‘Si urdhëroni, zotëri.’

‘Sot, spitali njoftoi hallën tuaj.’

‘Oh.’

‘Aksidenti ndodhi në rrugë,’ tha Zoti Wordsworth me dëshpërim.

‘Më tej, zotëri?’ Sipas mendjes së Xheromit dhe sipas gjasës ata do ta paraqisnin aksidentin si një aksident rruge. Sigurisht që në fillim do të kishte qëlluar policia; ai ishte i bindur se babai i tij kurrsesi nuk do të merrte jetë njeriu, me përjashtim të rastit nëse nuk do të kishte rrugë tjetër.

‘Kam frikë se babai yt është plagosur vërtet rëndë.’

‘Mos.’

‘Në të vërtetë, Xherom, ai ndërroi jetë dje. Pa kurrfarë dhimbje.’

‘Në zemër e morën plumbat?’

Xherom, babanë tënd nuk e qëllloi askush. Atij i ra një derr mbi kokë. Një spazmë e pashpjegueshme kapi nervat e fytyrës së zotit Wordsworth; në të vërtetë, u duk sikur ai ishte gati për të shpërthyer në të qeshura. Ai mbylli sytë, u qetësua dhe sikur ta kishte të nevojshme që ta hiqte qafe historinë e aksidentit sa më parë që të ishte e mundur, tha me shpejtësi, ‘Babait tënd i ra një derr mbi kokë teksa po ecte përgjatë një rruge në Napoli. Një aksident shokues ky. Mesa duket në lagjet e varfra të Napolit njerëzit mbajnë derra nëpër ballkone. Derri që ta vrau babanë ishte në katin e pestë. Ishte majmur jashtë mase. Ballkoni u shemb. Derri e goditi në kokë.’

Zoti Wordsworth u ngrit nga tavolina, dhe iu afrua me shpejtësi dritares duke i kthyer shpinën Xheromit. Trupi iu drodh pak nga emocioni.

‘Po me derrin ç’u bë?’ pyeti Xheromi.

Kjo nuk ishte mungesë ndjeshmërie nga ana e tij, siç zoti Wordsworth ia interpretoi kolegëve (ai madje diskutoi me ta se, ndoshta, Xheromi nuk e meritonte titullin e kujdestarit të klasës). Xheromi po përpiqej ta përfytyronte skenën e çuditshme me detajet e saj të sakta. Ai nuk ishte djalë që derdhte lot, por dikush që zhytej në mendime; ja përse, atij as që i ra ndërmend për sa kohë që ishte në shkollë, se rrethanat e vdekjes të së atit, ishin komike – ato ishin ende pjesë e misterit të vetë jetës. Vetëm më vonë, gjatë semestrit të parë në shkollën publike, teksa i tregonte historinë e babit shokut të tij të ngushtë, ai vuri re se si reagonin të tjerët. Natyrisht, pas zbulimit të këtij fakti, në një mënyrë krejt të paarsyeshme atë filluan ta thërrisnin, Derri.

Për fat të keq, halla e tij nuk kishte fare humor. Mbi piano kishte një foto të zmadhuar të babait; një burrë trupmadh e i trishtuar, me një kostum të errët që nuk i shkonte aspak, kishte pozuar në Capri me një çadër në dorë (për t’u ruajtur nga pika e diellit), ndërkohë që në sfond dukeshin shkëmbinjtë

Graham Greene

NJË AKSIDENT SHOKUES

Përktheu nga origjinali Aristidh Shqevi

Faraglioni. Në moshën 16-të vjeçare, Xheromi ishte i vetëdijshëm se portreti i të atit dukej më tepër si ai i autorit të Sunshine and Shade dhe Rambles in the Balearics se sa një portret i një agjenti të Shërbimeve Sekrete. Gjithsesi, kujtimin e të atit ai e mbante në zemër: akoma ruante një album me kartolina (pullat e postës së të cilave kishte kohë që i kishte hequr për koleksionin e tij), por gjithmonë i dhimbe në shpirt kur halla niste avazin dhe i tregonte të huajve historinë e vdekjes së babait.

‘Një aksident shokues,’ fillonte ajo, ndërsa i huaji mblidhte veten e tiparet dhe merrte një pamje të pranueshme për të treguar interes dhe përdëllim. Të dyja reagimet, sigurisht, ishin të shtira, por për Xheromin ishte e tmerrshme kur shikonte se si aty nga mesi i një bisede të hardallosur, interesi kthehej në një interes të sinqertë. ‘Nuk e imagjinoj dot se si mund të lejohen gjëra të tilla në një vend të civilizuar,’ e kishte bërë zakon të thoshte halla. ‘Ma do mendja se Italinë duhet ta konsiderosh një vend të civilizuar. Kuptohet se, kur ndodhesh jashtë shtetit, natyrisht që duhet të jesh i përgatitur për çdo gjë, im vëlla, ama, ishte një udhëtar i madh. Ai gjithmonë mbante një filtër-ujë me vete. E kupton, i bie më lirë kështu, sesa të blesh shishe me ujë mineral. Im vëlla thoshte se verën e drekës ia paguante filtri i ujit. Vetëm nga ky fakt e kupton se sa njeri i kujdesshëm ishte ai, por kush mund ta merrte me mend se teksa ecte përgjatë rrugës Dottore Manuele Panucci për të shkuar te Muzeu Hidrografik, një derr do t’i binte mbi kokë?’ Ishte pikërisht ky momenti kur interesi kthehej me të vërtetë në një interes të sinqertë.

Babai i Xheromit nuk kishte qenë ndonjë shkrimtar i shquar, por pas vdekjes së një autori, koha me sa duket vjen gjithmonë për dikë që ta shprehë mendimin e vet se ia vlen t’i drejtohesh me një letër gazetës The Times Literary Supplement me qëllim që ta njoftojë atë për përgatitjen e një shkrimi biografik, si dhe për të kërkuar që t’i lihen në dispozicion letra e dokumente të mundshme, pa lënë mënjane ndodhi në lidhje me të ndjerin që mund të mblidhen nga miqtë e tij. Shumica e biografive, natyrisht, nuk e shikojnë dritën e botimit – gjë që të bën të të brejë mëdyshja se e gjitha kjo nuk është gjë tjetër veçse një formë e errët shantazhi, dhe se shumë shkrimtarë që aspirojnë të shkruajnë një biografi apo një tezë të caktuar, në këtë mënyrë gjejnë mjetin për ta arritur qëllimin e tyre, domethënë, t’i mbarojnë studimet në Kansas ose në Nottingham. Xheromi, sidoqoftë, si një ekonomist i licencuar, nuk kishte lidhje me botën letrare. Ai nuk arrinte

ta kuptonte se kanosja, në të vërtetë, ishte shumë e vogël dhe se periodha e rrezikut për dikë të panjohur si i ati, kishte kaluar me kohë. Hera-herës ai përsëriste mënyrën e të rrëfyerit të rrethanave të vdekjes së babait me qëllim që ta minimizonte në maksimum elementin komik deri në përmasat e tij më të vogla – ta refuzonte dhënien e informacionit nuk do të kishte kuptim, sepse në atë rast, autori i biografisë do t’i drejtohej hallës së tij, e cila tashmë ishte në një moshë shumë të madhe, edhe pse ajo akoma nuk kishte dhënë shenja rënie.

Sipas Xheromit, metodat e mundshme ishin dy – e para të çonte gradualisht te aksidenti, për pasojë, në momentin që bëhej përshkrimi, lexuesi ishte përgatitur aq mirë, saqë vdekja vinte vërtet në formën e një antiklimaksi. Rreziku kryesor që mund ta shkaktonte të qeshurën në një histori të tillë ishte gjithmonë befasia. Pasi përsëriste metodën, Xheromi niste rrëfimin në një mënyrë mjaft të mërzitshme.

‘Besoj se keni njohuri për Napoli-n dhe godinat e tij të larta, apo jo? Dikush më tha njëherë se napolitani e ndjen veten si në shtëpinë e tij në New York, ashtu si banori i Torinos e ndjen veten si në shtëpinë e tij në Londër, për arsye se lumi i përshkon të dy qytetet në të njëjtën mënyrë. Ku e lashë? A, po. Sigurisht, Napoli. Do të habiteshit me gjërat që njerëzit mbajnë në ballkonet e pallateve që lartësohen si caklarta në lagjet e varfra – nuk janë teshat e lara, e kuptoni, as çarçafët, por gjëja e gjallë, zogjtë e pulës, madje dhe derrat. Sigurisht, derrat i mbajnë aty gjithë kohës dhe, për pasojë, ato majmen shumë shpejt.’ Ai e imagjinonte se si në këto çaste dëgjuesit i visheshin sytë. ‘Unë nuk e kam idenë se sa mund të peshojë një derr, po ti? Sidoqoftë, godinat janë në një gjendje shumë të keqe dhe kanë nevojë për riparim. Një ballkon në katin e pestë u shemb nga pesha e një derri. Gjatë rënies, ai goditi ballkonin e katit të tretë dhe në një farë mënyre, bëri pizgërr dhe përfundoi në rrugë. Në çastin kur u godit nga derri, im atë ishte në rrugë e sipër drejt Muzeut Hidrografik. Duke rënë nga një lartësi dhe një kënd i tillë, derri ia theu zverkun.’ Kjo ishte me të vërtetë një përpjekje mjeshtërore për ta bërë të mërzitshme një temë që ishte qenësisht interesante.

Metoda tjetër të cilën Xheromi përsëriti mishërohej nga virtyti i shkurtësisë.

‘Shkaku i humbjes së jetës së babait ishte një derr.’

‘Vërtet? Në Indi?’

‘Jo, në Itali.’

‘Shumë interesante, nuk e dija se në Itali zhvillohej gjuetia e derrave me heshta. A

merrej yt atë me polo?’

Me kalimin e kohës, as herët dhe as vonë, më tepër në funksionin e tij se ekonomist i licencuar, pasi studioi të dhënat dhe bëri llogaritë, Xheromi u fejua dhe hodhi kështu hapin e parë drejt martesës: me një vajzë 24 vjeçare, të këndshme e me fytyrë të njomë, babai i së cilës punonte si mjek në Pinner. Ajo quhej Sally; shkrimtari i saj i preferuar vazhdonte të ishte Hugh Walpole, ndërsa bebat kishte filluar t’i adhuronte që nga momenti kur, në moshën pesë vjeçare, i kishin dhuruar një kukull e cila hapte e mbyllte sytë dhe urinonte. Ata ishin të kënaqur me marrëdhënien e tyre, por nuk është se ishin të entuziazmuar, ashtu siç ndodhte zakonisht me marrëdhëniet e dashurisë së një ekonomisti të licencuar; Marrëdhënie midis tyre nuk do të kishte pasur kurrë, nëse vetë marrëdhënia do të ndërhynte te shifrat.

Sidoqoftë, një mendim i vetëm e shqetësonte Xheromin. Tani që brenda një viti ai vetë mund të bëhej baba, dashuria për të atin e ndërë vazhdimisht i rritej; ai e kuptonte shumë mirë se, në kartolinat që babai i kishte dërguar ndër vite, ishte investuar një dashuri e madhe. Ai provonte një dashuri dhe dhembje shpirtërore për të dalë në mbrojtje të kujtimit të tij, por ishte i pasigurt nëse dashuria e tij e heshtur për Sally-n do të mbijetonte sikur të ndodhte që ajo të tregonte një mungesë ndjeshmërie e të qeshte në momentin që do të mësonte rrethanat e vdekjes së babait. Në mënyrë të pashmangshme Sally do t’i mësonte ato rrethana ditën që Xheromi do ta çonte për drekë te halla. Meqenëse ajo mezi priste të mësonte gjithçka në lidhje me të, Xheromi u bë disa herë gati t’ia tregonte vetë historinë e babait.

‘Ishit vocërrak kur babi ndërroi jetë?’

‘Vetëm nëntë vjeç.’

‘Sa keq më vjen,’ tha ajo.

‘Isha në shkollë. Aty ma dhanë lajmin e zi’.

‘Të ra si bombë?’

‘Nuk e mbaj mend.’

‘Nuk ma ke thënë asnjëherë se si ndodhi.’

‘Ishte diçka e papritur. Një aksident në rrugë.’

‘Xhemi, kurrë nuk do ta ngasësh makinën me shpejtësi, apo jo?’ (Ajo kishte nisur ta thërriste Xhemi.) Tashmë ishte tepër vonë për t’iu drejtuar metodës së dytë – atë që ai e konsideronte gjuetinë e derrave me heshta.

‘Ata do të martoheshin së shpejti pa zhurmë në gjendjen civile, ndërsa muajin e mjalitit do ta kalonin në Torquay. Vizitën te halla ai e shmangu deri një javë para dasmës, por ja, mbrëmja e vizitës erdhi; Xheromi nuk ishte në gjendje ta përcaktonte nëse i druhej më shumë kujtimit të babait apo sigurisë për dashurinë që ai ushqente ndaj Sally-t.

Dhe ja, momenti i pritur erdhi shumë shpejt. ‘Mos është ai babai i Xheromit?’ pyeti Sally, teksa kapi me dorë portretin e një burri që mbante një çadër në dorë.

‘Po, e dashur. Si e more me mend?’

‘Ka sytë dhe vetullat e Xheromit, apo mos gaboj?’

‘A keni lexuar ndonjë nga librat e tij?’

‘Jo.’

‘Do t’ju jap disa libra të tij me rastin e martesës. Ai shkruante me shumë ndjenjë për udhëtimet që bënte. Libri që unë preferoj më shumë është Skuta e rrëza. Ai kishte një të ardhme të madhe. Ky fakt e bën aksidentin akoma dhe më shokues.’

‘Vërtet?’

Xheromi dëshironte që doemos të largohej nga dhoma për të mos ta parë atë fytyrë të dashur të shformohej nga një zbavitje e parezistueshme.

‘Kam marrë shumë letra nga lexuesit e tij që nga dita kur derri i ra mbi kokë.’ Ajo asnjëherë nuk kishte qenë kaq e vrazhdë.

Po ja, më pas, ndodhi mrekullia. Sally nuk qeshi. Teksa halla tregonte historinë, ajo hapi sytë nga tmerri, dhe më në fund tha, ‘Sa e frikshme! Sigurisht që një ngjarje e tillë të vë në mendime. Të ndodhë kështu. Në një ditë me qiell të pastër.’

Xheromit iu mbush zemra me hare. Ishte njësoj sikur ajo ta kishte fashitur njëherë e përgjithmonë frikën që ai kishte. Brenda taksisë që po i çonte në shtëpi, ai e puthi Sally-n me më shumë pasion se çdo herë tjetër, dhe ajo iu përgjigj me të njëjtën masë pasioni. Në ninëzat blu të errëta të syve të saj kishte bebe që hapnin e mbyllnin sytë dhe urininonin.

‘Sot një javë,’ tha Xheromi, ndërkohë që ajo ia shtrëngoi dorën. ‘Ç’mendim ke e dashur?’

‘Jam kureshtare ta di, ç’u bë me derrin e gjorë?’

‘Sigurisht që e hëngrën për drekë,’ tha Xheromi i lumturuar teksa e puthi të dashurën sërish.



Të shkruarit ka qenë gjithmonë një kënaqësi. Madje edhe kur isha djalosh në shkollë, prisja me padurim më shumë se çdo orë tjetër në orar, orën e mësimit të caktuar për të shkruar një histori, ose çfarëdo që mësuesit tanë mendonin se do të na ngjallte kërshërinë. Pastaj të gjithë binin në heshtje, ndërsa të përkulur në banga ringjallnin në kujtesë dhe imagjinatë diçka që ia vlente të rrëfehej. Gjatë këtyre përpjekjeve rinore, nuk kishte asnjë dëshirë për të thënë diçka të veçantë, për të kujtuar një përvojë të paharrueshme, për të shprehur një mendim tek i cili besoje në mënyrë të palëkundur ose për të përcjellur një mospajtim. Po kështu këto përpjekje nuk kërkonin ndonjë lexues tjetër përveç mësuesit që e përdorte orën e të shkruarit si ushtrim për të përmirësuar aftësitë tona të të shprehurit. Shkruaja sepse më ishte thënë të shkruaja dhe sepse për mua një përvojë e tillë ishte një kënaqësi kaq e madhe.

Vite më vonë, kur unë vetë isha mësues shkolle, pata po këtë përvojë, por në një rol të kundërt, isha unë që ulesha në një klasë të heshtur, ndërsa nxënësit përkuleshin për të bërë detyrën e tyre. Kjo më kujtoi një poezi të D.H. Lawrence-it, disa vargje të të cilit do t'i citoj tani:

Vargjet nga “Koha më e mirë e shkollës”

Ndërsa ulem në brigjet e klasës, vetëm,
Këqyr çunat me bluza verore
Teksa shkruajnë, kokat e rrumbullakëta
të përkulura gjithë zell:
Njëra pas tjetrës, dhe ngrihet njëra
Fytyra e tij hedh vështrimin nga unë,
Për t'u përhumbur mendimesh në
heshtje,
Ndërsa sheh, por nuk pikas dot asgjë.

Dhe pastaj ai shmang sërish shkimin, me një rrëqethje
Të vogël kënaqësie për atë që ka shkruar,
Pasi ka gjetur çfarë donte, çfarë kishte
kërkuar.

Ora e të shkruarit për të cilën po flisja dhe të cilën kjo poezi e kujton, nuk ishte për të shkruarit në kuptim që do të kishte për mua më vonë. Ajo që shkruaja, nuk i drejtohej kujt, nuk përpunohej, nuk riorganizohej pafundësisht. Gjatë këtyre përpjekjeve rinore shkrova aty për aty, si të thuash, pa shumë mëdyshje dhe korrigjime, me një pafajësi të tillë. Po kështu lexoja me një lloj ndjesie braktisjeje, pa asnjë drejtim dhe atëherë nuk e dija sa të lidhura ishin këto veprimtari. Ndonjëherë, kur nuk ishte e nevojshme të zgjohesha herët për në shkollë, lexoja aq vonë natën, sa që im at, i cili deri diku vuante nga pagjumësia, detyrohej të vinte në dhomën time dhe të më urdhëronte të fikja dritën. Nuk mund t'i thoje, edhe sikur të guxojë, se ai ishte ende zgjuar dhe pse të mos ishte ti, sepse nuk i flitej ashtu babait. Sido që të jetë, ai i kalonte orët e pagjumësisë në errësirë, me dritën e fikur që të mos shqetësonte nënën time, kështu që urdhëri për të fikur dritën gjithsesi qëndronte.

Të shkruarit dhe leximet e mëvonshme ishin më sistematike në krahasim me përvojën e shkrimeve dhe leximeve të rastësishme të rinisë, por ato gjithmonë vazhduan të jenë një kënaqësi dhe vështirë se ishin ndonjëherë përpjekje të mundimshme. Megjithatë, dalëngadalë, u shndërruan në një lloj tjetër kënaqësie. Nuk u bëra plotësisht i vetëdijshëm për këtë derisa shkova të jetoja në Angli. Pikërisht aty, me mallin për shtëpinë dhe mes ankthit të jetës së një të huaji, fillova të mendoja për këto të dyja më shumë kurrë me parë në jetën time. Pikërisht gjatë kësaj periudhe të zgjatur varfërie dhe tjetërsimi, fillova të ushtroj një lloj tjetër të shkruarit. Për mua u bë mëse e qartë se kishte diçka që duhej të thosha, se kishte një detyrë për t'u bërë, duhej që keqardhjet dhe mospajtimet t'i

Ligjërata e Nobelit, 7 dhjetor 2021

TË SHKRUARIT

Abdulrazak Gurnah

Përktheu Granit Zela

nxirrja nga vetja dhe të shkruaja për to.

Në radhë të parë, reflektova për atë që kisha lënë pas fluturimit të ngutshëm për t'u larguar nga vendlindja. Jetët tona u zhytën në një kaos të thellë në mesin e viteve 1960-të, veprimet e drejtat dhe të gabuara që bëmë u errësuan nga mizoritë që shoqëruan ndryshimet që solli revolucionin në vitin 1964: ndalime, ekzekutime, dëbime dhe keqtrajtime dhe akte të pafundme të vogla e të mëdha shtypjeje. Në mes të këtyre ngjarjeve dhe me mendjen e një adoleshenti, ishte e pamundur të mendoje qartë për domethënien historike dhe të ardhshme të asaj që po ndodhte.

Vetëm gjatë viteve të para të jetës në Angli munda të reflektoj për çështje të tilla, të ndalem për një çast te shëmtia e asaj që ishim në gjendje t'i shkaktonim njëri-tjetrit, t'u rikthehesha gënjeshtreve dhe iluzioneve me të cilat ishim ngushëlluar. Historitë tona ishin të pjesshme, dhe nuk përmendnin shumë mizori. Politika jonë u bë raciste dhe çoi drejtpërdrejt në persekutimet që pasuan revolucionin, kur baballarët u masakruan para fëmijëve të tyre dhe vajzat u dhunuan para nënave.

Duke jetuar në Angli, shumë larg këtyre ngjarjeve, por shumë i shqetësuar prej tyre në mendjen time, ka gjasë të mos kem mundur t'i rezistoj fuqisë së kujtimeve të tilla krejt ndryshe nëse do të kisha qenë mes atyre njerëzve që ende po i jetonin pasojat e tyre. Por më shqetësonin edhe kujtime të tjera që nuk kishin lidhje me këto ngjarje: mizoritë që prindërit u bënë fëmijëve të tyre, mënyra se si njerëzve u mohohesh shprehja e plotë për shkak të dogmave sociale ose gjinore, pabarazitë që lejonin varfërinë dhe varësinë. Këto janë çështje të pranishme në të gjithë jetën njerëzore dhe nuk janë të veçanta për ne, por ato nuk janë gjithmonë në mendjen

tënde derisa rrethanat të ta kërkojnë që të jesh i vetëdijshëm për to. Dyshoj se kjo është një nga barrat e njerëzve që kanë ikur nga një traumë dhe e gjejnë veten duke jetuar të sigurt, larg atyre që kanë mbetur pas. Më në fund fillova të shkruaj për disa nga këto refleksime, jo në mënyrë të rregullt apo të organizuar, ende jo, por vetëm për të ndier lehtësimin që të jep të sqaruarit sadopak të këtyre pështjellimeve dhe pasigurive në mendjen time.

Megjithatë, me kalimin e kohës, u bë e qartë se diçka thellësisht shqetësuese po ndodhte. Një histori e re, më e thjeshtë po krijohej, e cila e shndërronte dhe madje e fshinte atë që kishte ndodhur, duke e ristrukturuar për t'iu përshtatur të vërtetave të çastit. Kjo histori e re dhe më e thjeshtë nuk ishte vetëm vepra e pashmangshme e fitimtarëve, të cilët janë gjithmonë të lirë të krijojnë një rrëfim sipas zgjedhjes së tyre, por u përshtatej edhe komentuesve, studiuesve, madje edhe shkrimtarëve që nuk kishin asnjë interes të vërtetë për ne, ose na shihnin përmes një kornize që pajtohej me pikëpamjen e tyre për botën dhe që kërkonte një narrativë të njohur të emancipimit dhe përparimit racor.

Atëherë u bë e nevojshme të refuzohej një histori e tillë, një histori që shpërfillte objektet materiale që ishin dëshmi të një kohe më të hershme, ndërtesat, arritjet dhe butësitë që e kishin bërë jetën të mundur. Shumë vite më vonë, eca nëpër rrugët e qytetit ku u rrita dhe pashë degradimin e gjërave, vendeve dhe njerëzve, të cilët ishin tashmë të thinjur dhe pa dhëmbë dhe jetonin me frikën se mos humbisnin kujtesën e së kaluarës. U bë e nevojshme të bëhej një përpjekje për ta ruajtur atë kujtim, për të shkruar për atë që ishte aty, për të ringjallur çastet dhe historitë që kishin

jetuar njerëzit dhe përmes të cilave ata kishin kuptuar veten. Ishte e nevojshme të shkruhej për persekutimet dhe mizoritë të cilat pushtetarët tanë të dehur nga fitorja kërkuan t'i fshinin nga kujtesa jonë.

Kishte gjithashtu një kuptim tjetër të historisë që duhej trajtuar, një kuptim që u bë më i qartë për mua kur jetoja më afër burimit të saj në Angli, më i qartë se sa kishte qenë gjatë kohës që iu nënshtrova arsimimit tim të kolonizuar në Zanzibar. Ne ishim, ne të brezit tonë, fëmijë të kolonializmit në një mënyrë që nuk kishin qenë prindërit tanë dhe as ata që erdhën pas nesh, ose të paktën jo në të njëjtën mënyrë. Me këtë nuk dua të them se ne ishim të tjetërsuar nga gjërat që prindërit tanë i vlerësonin ose se ata që erdhën pas nesh u çliruan nga ndikimi kolonial. Dua të them se ne u rritëm dhe u edukuam në atë periudhë të besimit të lartë perandorak, të paktën në pjesën tonë të botës, kur sundimi e maskoi vetveten me eufemizma dhe ne u pajtuam me nënshtrimin. Po flas për periudhën para se fushatat e dekolonizimit në të gjithë rajonin të arrinin kulmin dhe të tërhiqnin vëmendjen tonë ndaj shkatërrimeve të sundimit kolonial. Ata që erdhën pas nesh kishin zhgënjimet e tyre paskoloniale dhe iluzionet e tyre për t'u ngushëlluar, dhe ndoshta nuk e panë qartë, ose aq thellë sa duhet, mënyrën me të cilën përvoja koloniale kishte shndërruar jetët tona, se korrupsioni dhe keqeverisja jonë ishin në një farë mase gjithashtu pjesë e asaj trashëgimie koloniale.

Disa nga këto çështje u bënë më të qarta për mua në Angli, jo sepse takova njerëz që m'i sqaruan gjatë bashkëbisedimit me ta apo në klasë, por sepse arrita të kuptoja më mirë se si dikush si unë ishte pjesë e disa nga historitë të tyre për veten, si në shkrime ashtu edhe në bisedat e rastësishme, në të qeshurat që mirëprisnin batutat raciste në TV e gjetkë, në armiqësinë e vetvetishme që hasja në takimet e përditshme në dyqane, në zyra, në autobus. Nuk mund të bëja asgjë për këtë lloj sjelljeje, por ashtu siç mësova të lexoja duke kuptuar më shumë, po ashtu u rrit dëshira për të shkruar që t'i refuzoja këto rrëfime të shkurtra të sigurta të njerëzve për veten të cilat na përbuznin dhe nënçmonin.

Por të shkruarit nuk mund të jetë vetëm për betejë dhe polemikë, sado frymëzuese dhe ngushëlluese që mund të jenë këto tema. Të shkruarit nuk ka të bëjë me një gjë, as me këtë apo atë çështje, për këtë shqetësim apo një tjetër, dhe meqë shqetësimi i tij është jeta e njeriut në një mënyrë apo tjetër, herët a vonë mizoria, dashuria dhe dobësia bëhen temë e tij. Besoj se të shkruarit duhet gjithashtu të tregojë edhe atë që mund të jetë ndryshe, çfarë është ajo që syri i fortë kundruar s'mund ta shohë, çfarë i bën njerëzit në dukje të vegjël në shtat, të ndihen të sigurt në vetvete, pavarësisht nga përçmimi i të tjerëve. Kështu që e pashë të nevojshme të shkruaj edhe për këtë, dhe ta bëj me vërtetësi, në mënyrë që të shihet edhe shëmtia edhe virtyti, dhe genia njerëzore të shfaqet përtej thjeshtëzimit dhe stereotipit. Kur kjo arrihet të bëhet, një lloj bukurie del prej saj.

Dhe kjo mënyrë vështrimi krijon hapësirë për brishtësi dhe dobësi, për butësinë në mes të mizorisë dhe një aftësi për mirësi mbi të cilën nuk është hedhur dritë. Janë këto arsye pse të shkruarit ka qenë për mua një pjesë më vlerë dhe gllabëruese e jetës sime. Ka edhe pjesë të tjera të jetës, sigurisht, por ato nuk janë tema për të cilën po flasim me këtë rast. Në mënyrë deri diku të mrekullueshme, ajo kënaqësi rinore e të shkruarit, për të cilën fola në fillim, është ende tek unë pas gjithë këtyre dekadave.

Më lejoni të përfundoj duke shprehur mirënjohjen time më të thellë për Akademinë Suedeze që më blatoi këtë nder të madh mua dhe veprës time. Ju jam shumë mirënjohës.



FËMIJËRIA

Si çapkëne zbathur u tret në vegime
Iku fëmijëria, s'ndalet më ajo,
Nдалu fëmijëri, o botë me ëndërrime;
Ti, mos u largo nga djalëria, jo!

Esenini, Uitman sot janë miqt' e mi
Në mur Vagner më shikon serioz
N' rrugicën e ngushtë sa herë, kur vij,
Dëshira më zgjohet si fëmi' të loz...

Iku fëmijëria, s'ndalet me ah, jo...
Çamarroke, zbathur u tret në agime
Me fëmijërinë po ikën dhe "Ajo"
Nдалu fëmijëri, o botë plot drithërime...

Mars 1965

STOLI I VETMUAR

Çdo mbrëmje, pranë stolit të vetmuar
Takohesha un' me të në t' njëjtin vend
S'i ftohte zemrat orët e trishtuar,
S'e ftohte puthjen, ardhje e zërit tënd...

Dhe gjethet nga pemët, një nga një
ranë
... E puthi vjeshta edhe stolin tonë.
Parku është i trishtë, sikur qan,
Por puthja ish e ngrohtë, si gjithmonë.

... Kaluan ditët, muajt pa kuptuar,
I vetëm n' errësirë cigare pi...
Ajo, që dashuroja qe larguar,
Të zverdhi vjeshta si gjeth' dashuri...

1966

MES KËNGËSH TË ESENINIT

Me ty flisja për fushat valëzore,
Flisja me ty e zemra me këndonte,
Me ty puthesha në mbrëmjet hënore,
Rrija me ty luginash kur agonte...

Puthja ne nga shpirti s'na u nda,
Zemra dashurish na u shkri...
... Bukuroshja iku e më la,
Ti ngrys ditët larg pa dashuri...

1968

UDHËTIM NË MESNATË

Përsëri po kthehem mes kopshtesh
plot blerim
Nga spond' i makinës, sot të
përshtëndes
Të përqafoj me mall, qyteti im
Ushtari të uron ty... Mirëmëngjes!..

Rrugëve të tua do endem në qetësi...
Dhe ajo lehtë do më varet në sup
Vellon gri mbi krahë do hedhësh ti
Nga yjet ne aspak mos të kemi turp.

Thëllimi ëmbël sytë m'i përkëdhel
Ushtari sonthe çfarë gëzimi ka?...
Rrugën me argjend hëna po e vel...
-Jepi edhe ca, shkelja shofer, vëlla...

Maj 1968

KËNGËT E
KUMRISË

poezi nga Abdulla Arapi

SA E FTOHTË KJO PRITJE

Zemra më rreh e trishtë, plot
shqetësim,
Hëna në qiell sonthe ndrit e zbehtë,
Sa akull... ftohtësi paska ky takim,
Lot të ketë mbledhur vall' në net? ...

... Yjet fiken në qiellin e pamatë.
Ajo e mbylli dritaren... përgjithmonë,
Sa e ftohtë kjo e pritje e gjatë;
Një romancë ndarjeje dikush larg
këndon...

Maj 1968

IKTIMË E NJË PUTHJEJE

Ti re viktimë e së parës dashuri
E puthja të dehu, të dogji porsi zjarr,
Por buzë të paputhura, jo nuk puthe ti,
Të tjerë i kishin puthur dhe më parë...

Jo, nuk të qortoj aspak, o miku im
Se ty të robëroi një puthje gjith' zjarr,
Ajo mbi buzë ka patur ndoshta

trishtim,
Se me mall ka kujtuar puthjen e parë...

Shkurt 1967

FLOKË DREDHURI ESENIN...

Mijëra yj' i falin qiellit vezullime,
Ndërsa unë sonthe eci në marshim.

Hapat lehtë hedh dhe ty të sjell
ndërmend,
Mirazhin e vendlindjes gjithë dritë,
Me asgjë në botë s'e shkëmbej at' vend,
Që bukuritë në zemër ia kam rritë.

Andaj un' endem sonthe i pagjumë.
Në shpirt më mbetesh ti përgjithnjë.
Mbrëmjet ngjyrë gri që, doja aq shumë,
Parqet e tua të velura me qetësi...

Të përshtëndes me mall nënoshka ime!
Buz' Jonit të kaltër – bart dashurish
Mijëra yj' i falin qiellit vezullime
Si ëndrra – flutura të djalërisë.

Shtator 1968

MALL PËR LASHTËSINË

Në ëndërrime eci Egnatias së vjetër
Si udhëtar, epokës së re,
Në supe mbart legjendat e bedenave të
fjetur,
Kjo rrugë e kalldrëmtë
Në mendime më vë...

Unë eci sonthe mes ushtash, jataganësh,
Qyteti im prazmoren paska veshur,
Më përtërin epokën me britma
ilirianësh,
Mallin e betejave
Dhe shpata përleshur.

Gusht 1969

MIQËSIA JONË

L. Sorokinës

Tungjatjeta Linda!
Miqësi e sfiduar e jona nuk ish...
Ti e deshe shumë mikun shqiptar!
Miqësia jonë rininë simbol kish
Dhe ëndërr vërgimin djaloshar.

Ti më kujton akoma çunak
Kur "mjakiznakun" në letra harroja
gjithmonë...
S'ka gjë, ashtu kujtomë
Edhe pse vitet
Kaluan si kuadrot e një filmi
Të prerë në mes...

Miqësia jonë
Mbeti miqësi e përjetshme
fëminore,
Si re e bardhë e një qielli blu;
Me të vetmin seriozitet
Fjalën tënde:
"Ja ljublu!"

Shtator 1969

VKËNGËT E KUMRISË

"Kumria po bën gu-gu
N' at' mëngjes kur zbardhon drita
Nuk ka tjetër ma për mu'
Zemrën un' ke ti e njita"

Metaforë e këngës mbush me
pikëllim...
Zëri yt vazhdon në shekuj vetmitar'
Për mikun, që mungon në amëshim,
Simbol i qytetit, o zog ëndërrimtar...

Tek selvitë e Namazgjasë zemër e
djalërisë
Plot këngë të pakënduara këtë
pranverë
Çel gjokset e dashuruara të vajzëris'
Si petale të bardha mbi tastierë...

1972

*Këngë e Isuf Myzyrit "Kumuria po ban gu – gu"



Paradigma e një *refuzimi estetik* do kujtohet përherë në literaturën bashkëkohore të të gjitha kohërave. Ka një emër. Sa ishte gjallë u përkthye dhe u botua në shqip tregimet e përzgjedhura me titullin “I pavdekshmi”. Krijimtaria e argjentinasi Jorge Luis Borges (1899-1986), sidomos në tregimtari, vlerave dhe artit që ngërthen, rriten ndoshta edhe nga fakti se atij jo vetëm që nuk ju dha Nobeli për Letërsi, por nga që nuk shkroi tri gjinitë e gjata të rrëfimitarisë (“narracionit “rrëfimitar”) dramë, roman dhe novelë. Një ditë, ndoshta, Nobeli do t’i jepet “vetëm” një tregimtari. Megjithatë për një gjë të tillë kritika moderne edhe dyshon sepse ishte Jorge Luis Borges që sfidoi, pa e ditur Akademia e Nobelit se në zhanrin e poezisë nuk kanë munguar nobelistët. Me gjithë këtë Borges ka shkruar prozë në poezi, ka shkruar tregim në ese, ka shkruar rrëfim në dialog, ka shkruar dramë në monolog, minitregim në ligjërata ...

Në vitin 1981, Redaksia e botimeve “*Rilindja*”, Biblioteka e përkthimit nga letërsi të tjera “ATLAS” botoj librin me tregime “*I pavdekshmi*”. Redaktor: Ali Podrimja. Përktheu: Muhamet Kërnia. Janë 45 tregime. Është ky libri i parë më i plotë me tregime që do prijë për nga sasia e përkthimeve të tregimeve të Borges deri në vitin 2021 (“*Tregime të zgjedhura*”, botim i vitit 2016 ka 31 tregime) kur do të përkthehet dhe botohet “*Tregimet*” me 71 tregime. Më pas në Prishtinë nuk do të përkthehet dhe botohet asnjë libër me tregime të Borges! Së fundi, në vitin 2021 është botuar, por që ende nuk ka ardhur tek lexuesi, “*Tregimet*” nga “*Pika pa sipërfaqe*”, 71 tregime përkthyer nga origjinali nga Bashkim Shehu.

Përgjatë 40 viteve tituj me autor Jorge L. Borges në shqip janë: “**I PAVDEKSHMI**” (1981), “**Dorëshkrimi i Brodit**” (2001), “**ALEPH**” (2002), “**Vdekja dhe busulla/Fiksione & Aleph**” (2002), “**PASQYRA e BOJËS**” (2007), “**Libri i rërës**” (2009), “**Tregime të zgjedhura**” (2016) dhe “**Tregimet**” (2021). Gjithashtu përfaqësohet më disa tregime edhe në këto botime: “**Labirinti Borges**” (1999), “**ANTOLOGJI E TREGIMIT HIASPANOAMERIKAN TE SHEKULLIT XX**” (2002), “**ARTISTI I URISË**” (2003), “**Tregime të zgjedhura**” (2004), “**PUTRA e MAJMUNIT**” (2008), “**TREGIME LATINOAMERIKANE**” (2012) dhe “**TREGIME TË ZGJEDHURA HISPANOAMERIKANE**” (2015). Në të 16 titujt e librave në shqip në të cilat janë botuar tregimet e Borges janë përkthyer nga Muhamet Kërnia, Feride Pappleka, Qemal Velija, Çlirim Mukli, Mira Meksi, Gjergj Vlashi, Fatmir Alimani, Edvin Shvarc, Agim Doksani, Xhevat Lloshi, Rudi Bobrati e Alban Bobrati, Azem Qazimi, Erion Karaboli e Bajram Karaboli dhe Bashkim Shehu.

Janë këto shtëpi botuese që përkthyen dhe botuan krijimtarinë tregimtare të Borges: “*Rilindja*”, “*Onufri*”, “*Botimet Enciklopedike*”, “*Shtëpia Botuese EUGEN*”, “*Botimet DUDA*”, “*Mësonjëtorja*”, “*Bargjini*”, “*Bota Shqiptare*”, “*ZENIT*”, “*ILAR*” dhe “*Pika pa sipërfaqe*”.

Tregime të përkthyer vetëm një herë: “*Brenda një nate*”, “*Dikush ëndërron*”, “*Disa fjalë për shkencën rigorozë*”, “*Djali i humbur*”, “*Jugu*”, “*Legjendë*”, “*Një ëndërr*”, “*Odini*”, “*Paradiso, XXXI, 108*”, “*Qasja kah e fshehura*” dhe “*The Unending Gift*”. Tregime të përkthyer në gjashtë variante janë “*Dy mbretër dhe dy labirinte*”, “*Shtëpia e Asterionit*” dhe “*Ulrika*”. Janë 96 tregime në shqip të botuara në 16 librat nga botimi i parë “*I pavdekshmi*” (1981) te i fundit “*Tregimet*” (2021) në harkun kohor prej dyzet vitesh.

Tregimgrafia alfabetike e Jorge Luis Borges-it në shqip

Abenhakan Bohari, i vdekur në labirintin e vet (I pavdekshmi, 1981); Abenjakan Bojari, i vrrarë në labirin e tij (Aleph, 2002); Abenhakan el Bohariu, që vdiq në labirintin e tij (Tregime të zgjedhura, 2016); Abenhakan el Bohari, vrrarë në labirintin e tij

NË 40 VJETORIN E BOTIMIT TË PARË TË TREGIMEVE TË J.L. BORGES NË SHQIP

Nga Enver S. Morina

(Tregimet, 2021)

Alefi (I pavdekshmi, 1981); Aleph (Aleph, 2002); Aleph-i (Vdekja dhe busulla, 2002); Alef (Tregimet, 2021)

Argumentum Ornithologicum (Arti i urisë, 2003); Argumentum Ornithologicum (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

“*Armiku bujar*” (Poezi, 2000); “*Një armik zemërgjerë*” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981); “*Armiku bujar*” (Poezi të zgjedhura, 2016)

Avelino Arredondo (Libri i rërës, 2009); Avelino Arredondo (Tregime të zgjedhura, 2016); Avelino Arredondo (Tregimet, 2021)

Befasia e fshehur (I pavdekshmi, 1981); Mrekullia e fshehtë (Vdekja dhe busulla, 2002); Mrekullia e fshehtë (Putra e majmunit”, 2008); Mrekullia e fshehtë (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); Mrekullia e fshehtë (Tregimet, 2021)

Biblioteka e Babilonisë (I pavdekshmi, 1981); Biblioteka e Babelit (Vdekja dhe busulla, 2002); Biblioteka e Babelit (Pasqyra e bojës, 2007); Biblioteka e Babelit (Tregimet, 2021)

Biografia e Tadeo Isidor Krusit (I pavdekshmi, 1981); Jetëshkrimi i Tadeo Isidoro Kruz (1829-1874) (Aleph, 2002); Biografi e Tadeo Isidoro Krusit (1829-1874) (Tregimet, 2021)

Bojaxhiu i maskuar: Hakimi i Mervit (I pavdekshmi, 1981); Hakimi, ngjyrosës i maskuar i Mervit (Tregimet, 2021)

Borgesi dhe unë (Arti i urisë, 2003), Borhesi dhe unë (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); Borhesi dhe unë (Tregime të zgjedhura, 2016)

Brenda një nate (Tregime latinoamerikane, 2012)

Delia Elena San Marco (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); Delia Elena San Marco (Poetë të shquar hispanikë, 2015)

Deutsches Requiem (I pavdekshmi, 1981); Requeim gjerman (Aleph, 2002); Deutsches Requiem (Tregimet, 2021)

Dëshmitari (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002); Dëshmitari (Pasqyra e bojës, 2007); Dëshmitari (Poetë të shquar hispanikë, 2015)

Dialog mbi një dialog (Arti i urisë, 2003), Dialog për një dialog (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

Dikush ëndërron (Labirinti Borges, 1999)

“*Disa fjalë për shkencën rigorozë*” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981)

Disku (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002); Disku (Libri i rërës, 2009); Disku (Tregime latinoamerikane, 2012); Disku (Tregime të zgjedhura, 2016); Disku (Tregimet, 2021)

Djali i humbur (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002)

Dorëshkrimi i Brodit (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); Raporti i Brodit (Tregime të zgjedhura, 2016); Raporti i Brodit (Tregimet, 2021)



Dueli (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); Dueli (Tregimet, 2021)

Dueli tjetër (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); *Dueli tjetër* (Tregime të zgjedhura, 2016); Dueli tjetër (Tregimet, 2021)

Dy mbretër dhe dy labirinte (I pavdekshmi, 1981); Dy mbretërit dhe dy labirintet (Aleph, 2002); Dy mbretërit dhe dy labirintet (Vdekja dhe busulla, 2002); Dy mbretërit dhe dy labirintet (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); Dy mbretërit dhe dy labirintet (Tregime të zgjedhura, 2016); Dy mbretërit dhe dy labirintet (Tregimet, 2021)

“*Dy njerëz ëndërrimtarë*” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981); “*Historia e dy ëndërruesve*” (Tregimet, E të tjera, 2021)

“*Dhoma e shtatoreve*” (Tregimet, E të tjera, 2021); “*Oda me shtatore*” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981)

Emma Zunz (Aleph, 2002); Ema Zunz (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); Ema Zunz (Tregimet, 2021)

E huaja (Dorëshkrimi i Brodit, 2001), E ndërftura (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002) *Furacakja* (Tregime të zgjedhura, 2016); E huaja (Tregimet, 2021)

E pavdekshmja (Aleph, 2002); *I pavdekshmi* (I pavdekshmi, 1981); *I pavdekshmi* (Tregimet, 2021)

Episod me armikun (Tregime të zgjedhura, 2016); *Ngjarje me armikun* (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002); *Takim me armikun* (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

“*Fallxhiu i vonuar*” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981); “*Magjistari që u la të priste*” (Tregimet, E të tjera, 2021)

Famulli (Arti i urisë, 2003); Intriga (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

Figura e shpatës (I pavdekshmi, 1981); Forma e shpatës (Vdekja dhe busulla, 2002); Trajta e shpatës (Tregimet, 2021)

Funesi dhe kujtesa (I pavdekshmi, 1981); Funesi – njeriu i kujtesës (Vdekja dhe busulla, 2002); Funes kujtesa (Tregimet, 2021)

Fundi (Vdekja dhe busulla, 2002); Fundi (Tregimet, 2021)

Furacakja (Tregime të zgjedhura, 2016); *E ndërftura* (Antologji e tregimit

hispanoamerikan te shekullit XX, 2002), *E huaja* (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); *E huaja* (Tregimet, 2021)

Gërmadhat qarkore (I pavdekshmi, 1981); Rrënojat rrotullare (Vdekja dhe busulla, 2002); Qarku i rrënojave (Putra e majmunit, 2008); Rrënojat qarkore (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); Rrënojat rrethore (Tregimet, 2021)

Guajakil (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); Guajakil (Tregimet, 2021)

Hakimi, ngjyrosës i maskuar i Mervit (Tregimet, 2021); *Bojaxhiu i maskuar: Hakimi i Mervit* (I pavdekshmi, 1981)

“*Historia e dy ëndërruesve*” (Tregimet, E të tjera, 2021); “*Dy njerëz ëndërrimtarë*” (I pavdekshmi, I pavdekshmi, Et Coetere, 1981)

Historia e luftëtarit dhe të burgosurit (Aleph, 2002); *Tregimi për luftëtarin dhe robinën* (I pavdekshmi, 1981); *Historia e luftëtarit dhe e robinjës* (Tregimet, 2021)

Historia e Rosendo Juarez (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); Historia e Rosendo Huaresit (Tregimet, 2021)

Huan Muranja (Tregimet, 2021); *Juan Murana* (Dorëshkrimi i Brodit, 2001)

I padenji (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); I poshtri (Tregimet, 2021)

I pavdekshmi (I pavdekshmi, 1981); E pavdekshmja (Aleph, 2002); I pavdekshmi (Tregimet, 2021)

Ivdekuri (I pavdekshmi, 1981); Ivdekuri (Aleph, 2002); I vëni në shënjestër (Tregime të zgjedhura, 2004); I vdekuri (Tregimet, 2021)

Inferno, 1.32 (Arti i urisë, 2003); Inferno, I, 32 (Tregime të zgjedhura, 2016)

Intriga (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); *Famulli* (Arti i urisë, 2003)

Juan Murana (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); Huan Muranja (Tregimet, 2021)

Jugu (Tregimet, 2021)

Jetëshkrimi i Tadeo Isidoro Kruz (1829-1874) (Aleph, 2002); *Biografia e Tadeo Isidor Krusit* (I pavdekshmi, 1981); *Biografi e Tadeo Isidoro Krusit* (1829-1874) (Tregimet, 2021)

Ka edhe gjëra të tjera (Libri i rërës, 2009); There are more things (Tregime të zgjedhura, 2016), There Are more Things (Tregimet, 2021)

Kërkimi i Averoesit (I pavdekshmi, 1981); Kërkimi i Averroes (Aleph, 2002); Kërkimi i Averroesit (Tregimet, 2021)

Kongresi (Libri i rërës, 2009), Kongresi (Tregime të zgjedhura, 2016); Kongresi (Tregimet, 2021)

Kopshti me shtigje që degëzohen (I pavdekshmi, 1981); Kopshti me shtigjet që bigëzohen (Vdekja dhe busulla, 2002); Kopshti me shtigje që bigëzohen (Tregime të zgjedhura, 2016); Kopshti i shtigjeve që bigëzohen (Tregimet, 2021)

Kujtesa e Shekspirit (Arti i urisë, 2003); Kujtesa e Shekspirit (Tregimet, 2021)

Legjendë (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

Letra e zotit (I pavdekshmi, 1981); Shkrimi i Zotit (Aleph, 2002); Shkrimi i Perëndisë (Vdekja dhe busulla, 2002); Shkrimi i zotit (Tregimet, 2021)

Libri i rërës (Libri i rërës, 2009); Libri i rërës (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); Libri i rërës (Tregime të zgjedhura, 2016); Libri prej rëre (Tregimet, 2021)

Lotaria e Babilonisë (I pavdekshmi, 1981); Lotaria në Babiloni (Vdekja dhe busulla, 2002); Llotaria në Babilon (Pasqyra e bojës, 2007); Lotaria në Babiloni (Tregimet, 2021)

Llotaria në Babilon (Pasqyra e bojës, 2007); *Lotaria e Babilonisë* (I pavdekshmi, 1981); *Lotaria në Babiloni* (Vdekja dhe busulla, 2002); Lotaria në Babiloni (Tregimet, 2021)

“*Magjistari që u la të priste*” (Tregimet, E të tjera, 2021); “*Fallxhiu i vonuar*” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981)

Mashtguesi i pabesueshëm Tom Kastro (I pavdekshmi, 1981); Mashtguesi i hatashëm Tom Kastro (Tregimet, 2021)

Mita (Libri i rërës, 2009); Mita (Tregime të zgjedhura, 2016); Ryshfeti (Tregimet, 2021) *Mjeshtri i pasjellshëm i ceremonive Kotsuke*

no Suke (Tregimet, 2021); ***Udhëheqësi i padenjë i ceremonialit: Kotsuke No Suke*** (I pavdekshmi, 1981)

Mon Istman, prodhues paudhësish (Tregimet, 2021); ***Një burim i anarkisë: Monk Istmani*** (I pavdekshmi, 1981)

Mrekullia e fshehtë (Vdekja dhe busulla, 2002); *Befasia e fshehur* (I pavdekshmi, 1981); *Mrekullia e fshehtë* (“Putra e majmunit”, 2008); *Mrekullia e fshehtë* (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); *Mrekullia e fshehtë* (Tregimet, 2021)

Nata e dhuratave (Libri i rërës, 2009); *Nata e dhuratave* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Nata e dhurimeve* (Tregimet, 2021)

Ngjarje me armikun (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002); *Takim me armikun* (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); *Episod me armikun* (Tregime të zgjedhura, 2016)

Ndeshja (Dorëshkrimi i Brodit, 2001), ***Takimi*** (Labirinti Borges, 1999); *Takimi* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Takimi* (Tregimet, 2021)

Njeriu nga këndi i rrugës ngjyrë trëndafili (I pavdekshmi, 1981); *Njeriu i qoshes ngjyrë trëndafili* (Tregimet, 2021)

Njeriu tek pragu (Aleph, 2002); *Njeriu në prag* (Tregimet, 2021)

“**Një armik zemërgjerë**” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981); “*Armiku bujar*” (Poezi, 2000); “*Armiku bujar*”, Poezi të zgjedhura, 2016)

Një burim i anarkisë: Monk Istmani (I pavdekshmi, 1981); *Mon Istman, prodhues paudhësish* (Tregimet, 2021)

Një ëndërr (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

“**Një kipc i Muhamedit**” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981); “Një dytëshor i Muhametit” (Tregimet, E të tjera, 2021)

“*Një teolog në vdekje*” (Tregimet, E të tjera, 2021); “***Teologu në botën tjetër***” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981)

Odini (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

“**Oda me shtatore**” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981); “Dhoma e shtatoreve” (Tregimet, E të tjera, 2021)

Paradiso, XXXI, 108 (Tregime të zgjedhura, 2016)

Pasqyra dhe maska (Libri i rërës, 2009); *Pasqyra dhe maska* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Pasqyra dhe maska* (Tregimet, 2021)

“**Pasqyra prej ngjyrës së shkrimit**” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981);

“Pasqyra e bojës” (Pasqyra e bojës, 2007); “Pasqyra prej boje” (Tregimet, E të tjera, 2021)

Pjer Menari autor i Kishotit (I pavdekshmi, 1981); *Pierre Menard i – Autor i Kishotit* (Vdekja dhe busulla, 2002); *Pjer Menar, autor i Don Kishotit* (Tregimet, 2021)

Pritja (I pavdekshmi, 1981); *Pritja* (Aleph, 2002); *Pritja* (Tregimet, 2021)

Qasja kah e fshehura (I pavdekshmi, 1981)

Qarku i rrënojave (Putra e majmunit”, 2008); ***Gërmadhat qarkore*** (I pavdekshmi, 1981); *Rrenojat rrotullare* (Vdekja dhe busulla, 2002); *Rrënojat qarkore* (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

Ragnarëku (Pasqyra e bojës, 2007); *Ragnarök* (Tregime të zgjedhura, 2016)

Raporti i Brodit (Tregime të zgjedhura, 2016); ***Dorëshkrimi i Brodit*** (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); *Raporti i Brodit* (Tregimet, 2021)


Requeim gjerman (Aleph, 2002); ***Deutsches Requiem*** (I pavdekshmi, 1981); *Deutsches Requiem* (Tregimet, 2021)

Ryshfeti (Tregimet, 2021); ***Mita*** (Libri i rërës, 2009); *Mita* (Tregime të zgjedhura, 2016)

Rrënojat rrotullare (Vdekja dhe busulla, 2002); ***Gërmadhat qarkore*** (I pavdekshmi, 1981); *Qarku i rrënojave* (Putra e majmunit, 2008); *Rrënojat qarkore* (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); *Rrënojat rrethore* (Tregimet, 2021)

Sekti i tridhjetës (Libri i rërës, 2009); *Sekti i tridhjetës* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Sekti i të tridhjetëve* (Tregimet, 2021)

Sekti i Feniksit (Tregime të zgjedhura,



2016); *Sekti i feniksit* (Tregimet, 2021)

Studimi i veprës së Herbert Kvejnit (I pavdekshmi, 1981); *Shqyrtim i veprës së Herbert Kuejnit* (Tregimet, 2021)

Shkrimi i Zotit (Aleph, 2002); ***Letra e zotit*** (I pavdekshmi, 1981); *Shkrimi i Perëndisë* (Vdekja dhe busulla, 2002); *Shkrimi i zotit* (Tregimet, 2021)

Shëlbyesi i hatashëm Lazarus Moreli (I pavdekshmi, 1981); *Shelbyesi mizor Lazarus Morell* (Tregimet, 2021)

Shqyrtim i veprës së Herbert Kuejnit (Tregimet, 2021); ***Studimi i veprës së Herbert Kvejnit*** (I pavdekshmi, 1981)

Shtëpia e Asterionit (I pavdekshmi, 1981); *Shtëpia e Asterionit* (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX”, 2002); *Shtëpia e Asterionit* (Aleph, 2002); *Shtëpia e Asterionit* (Vdekja dhe busulla, 2002); *Shtëpia e Asterionit* (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); *Shtëpia e Asterionit* (Tregimet, 2021)

Takim me armikun (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); ***Ngjarje me armikun*** (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002); *Episod me armikun* (Tregime të zgjedhura, 2016)

Takimi (Labirinti Borges, 1999); *Ndeshja* (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); *Takimi* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Takimi* (Tregimet, 2021)

Teologët (I pavdekshmi, 1981); *Teologët* (Aleph, 2002); *Teologët* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Teologët* (Tregimet, 2021)

“**Teologu në botën tjetër**” (I pavdekshmi, Et Coetere, 1981); *Një teolog në vdekje* (Tregimet, E të tjera, 2021)

Tigrat e kaltër (Pasqyra e bojës, 2007); *Tigra të kaltër* (Tregimet, 2021)

Tjetri (I pavdekshmi, 1981); *Tjetri* (Libri i rërës, 2009); *Tjetri* (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); *Tjetri* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Tjetri* (Tregimet, 2021)

Tlon Uqbar Orbis Tertius (I pavdekshmi, 1981); *Tlön, Uqbar, Orbis Tertius* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Tlön, Uqbar, Orbis Tertius* (Tregimet, 2021)

Trajta e shpatës (Tregimet, 2021); ***Figura e shpatës*** (I pavdekshmi, 1981); *Forma e shpatës* (Vdekja dhe busulla, 2002)

Tregimi për luftëtarin dhe robinën (I pavdekshmi, 1981); *Historia e luftëtarit dhe të burgosurit* (Aleph, 2002); *Historia e luftëtarit dhe e robinjës* (Tregimet, 2021)

Tregimi për tradhtarin dhe heroin (I pavdekshmi, 1981); *Tema e tradhtarit dhe heroit* (Vdekja dhe busulla, 2002); *Tema e*

tradhtarit dhe heroit (Pasqyra e bojës, 2007); *Tema e tradhtarit dhe heroit* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Tema e tradhtarit dhe heroit* (Tregimet, 2021)

Trëndafili i Paracelsit (Tregime të zgjedhura, 2016); *Trëndafili i Paracelsit* (Tregimet, 2021)

Tri interpretime të Judës (I pavdekshmi, 1981); *Tre versione të Judës* (Tregimet, 2021)

The Unending Gift (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002)

There are more things (Tregime të zgjedhura, 2016) ***Ka edhe gjëra të tjera*** (Libri i rërës, 2009), *There Are more Things* (Tregimet, 2021)

Thika (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002); *Thika* (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015)

Udhëheqësi i padenjë i ceremonialit: Kotsuke No Suke (I pavdekshmi, 1981); *Mjeshti i pasjellshëm i ceremonive Kotsuke no Suke* (Tregimet, 2021)

Ulrika (I pavdekshmi, 1981); *Ulrika* (Putra e majmunit, 2008); *Ulrika* (Libri i rërës, 2009), *Ulrika* (Tregime latinoamerikane, 2012); *Ulrika* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Ulrike* (Tregimet, 2021)

Undr (Libri i rërës, 2009); *Undr* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Undr* (Tregimet, 2021)

Ungjilli sipas Shën Markut (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); *Ungjilli sipas Markut* (Tregime latinoamerikane, 2012); *Ungjilli sipas Markut* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Ungjilli sipas Markut* (Tregimet, 2021)

Utopia e një burri të lodhur (Libri i rërës, 2009); *Utopia e një burri të lodhur* (Tregime të zgjedhura, 2016); *Utopia e njeriut të lodhur* (Tregimet, 2021)

Vdekja dhe busulla (I pavdekshmi, 1981); *Vdekja dhe busulla* (Vdekja dhe busulla, 2002); *Vdekja dhe busulla* (Tregimet, 2021)

Vdekja tjetër (Aleph, 2002); *Vdekja tjetër* (Tregimet, 2021)

Vejusha Çing (I pavdekshmi, 1981); *Vejusha Çin, pirate* (Tregimet, 2021)

Vrasësi djerrakohës, Bill Herigeni (I pavdekshmi, 1981); *Vrasësi i painteres Bill Harrigan* (Tregimet, 2021)

Zahiri (Aleph, 2002); *Zahiri* (Tregimet, 2021)

Zonja e moçme (Dorëshkrimi i Brodit, 2001); *Zonja e moshuar* (Tregimet, 2021)

25 gusht 1983 (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX, 2002); *25 gusht 1983* (Tregimet, 2021)

Tregime në libra të tjerë të zhanreve jotregimtare

Një armik zemërgjerë (I pavdekshmi, 1981); *Armiku bujar* (Poezi, 2000); *Armiku bujar* (Poezi të zgjedhura, 2016)

Delia Elena San Marco (Tregime të zgjedhura hispanoamerikane, 2015); *Delia Elena San Marco* (Poezi të shquar hispanikë, 2015)

Dëshmitari (Antologji e tregimit hispanoamerikan te shekullit XX”, 2002); *Dëshmitari* (Pasqyra e bojës, 2007); *Dëshmitari* (Poezi të shquar hispanikë, 2015)

Takimi (Labirinti Borges, 1999); *Takimi* (Tregime të zgjedhura, 2016)

Tek “Labirinti Borges” (1999) në mesin e 5 krijimeve kemi tregimin “Takimi” por edhe prozën poetike “Dikush ëndërron”.

Tregimi “**Dymbëdhjetë shenjat e botës**”, H. Bustos Domecq: “**Etërit e misterit**” (Antologji e tregimeve policore), Bota Shqiptare, Tiranë, 2005, Përktheu: Agim Doksani (H. Bustos Domecq është një nga pseudonimet e shkrimtarëve argjentinas Jorge Luis Borges dhe Adolfo Bioy Casares, të shquar për krijimtarinë e tyre tregimtare, poetike, eseistike, më të cilin këta të dy së bashku kanë shkruar tregime policorë …)

Botime në shqip të tregimeve të Borges (1981-2021)

1981 H. L. Borhes **I PAVDEKSHMI**, Rilindja (Prishtinë), 1981, Përktheu: Muhamet Kërnja

1999 Labirinti Borges (dëshmi, imazhe, ese, dialogë, krijime), Onufri, Tiranë, 1999, Përktheu: Feride Papeleka

2001 JORGE LUIS BORGES, DORËSHKRIMI I BRODIT (Tregime), Botimet Enciklopedike, Tiranë, 2001, Përktheu: Qemal Velija

2002 JORGE LUIS BORGES, ALEPH, Shtëpia Botuese EUGEN (Tiranë), 2002, Përktheu: Çlirimi Mukli

2002 Jorge Luis BORGES, **Vdekja dhe busulla Fiksione & Aleph**, ONUFRI (Tiranë), 2002, Përktheu nga origjinali: Mira Meksi

2002 ANTOLOGJI E TREGIMIT HISPANOAMERIKAN TE SHEKULLIT XX, Botimet DUDAJ (Tiranë), 2002, Zgjodhi dhe përktheu nga spanjishtja: Gjergj Vlashi

2003 ARTISTI I URISË (Tregime të zgjedhuar nga letërsia botërore), Mësonjëtorja (Tiranë), 2003, Përktheu: Fatmir Alimani

2004 Tregime të zgjedhura, Bargjini, Tiranë, 2004, Mlodhi dhe përktheu: Edvin Shvarc

2005 Jorge Luis Borges Adolfo Bioy Casares, **Etërit e misterit** (Antologji e tregimeve më të mira policore, bashkë me Adolfo Bioy Casares), Bota Shqiptare, (Tiranë), 2005, Përktheu: Agim Doksani

2007 JORGE LUIS BORGES PASQYRA e BOJËS, Bota Shqiptare (Tiranë), 2007, Përktheu: Xhevat Lloshi

2008 PUTRA e MAJMUNIT (Përzgjedhje nga mjeshtërit e mëdhenj të tregimit), Botimet DUDAJ (Tiranë), 2008, Përkthyer nga Rudi Bobrati e Alban Bobrati

2009 JORGE LUIS BORGES Libri i rërës, ZENIT (Tiranë), 2009, Përktheu: Azem Qazimi

2012 TREGIME LATINOAMERIKANE, ILAR (Tiranë), 2012, I zgjodhi dhe i përktheu nga spanjishtja: Bajram Karabolli

2015 TREGIME TË ZGJEDHURA HISPANOAMERIKAN E (Antologji), ILAR (Tiranë), 2015, Përkthyer nga spanjishtja: Erion Karabolli e Bajram Karabolli

2016 JORGE LUIS BORGES, Tregime të zgjedhura, ZENIT Editions (Tiranë), 2016, Përktheu: Azem Qazimi

2021 JORGE LUIS BORGES TREGIMET, Pika pa sipërfaqe (Tiranë), 2021, Përktheu nga origjinali: Bashkim Shehu

P. S.

Në hapësirën e botimeve në shqip në Maqedonia e Veriut nuk kam arritur të hulumtoj për botimin e tregimeve të Borges.

Tregim nga Aleksander Levkovskij

VALS ME VRASËSIN E PUSHKINIT

Përktheu nga origjinali Bujar Hudhri

Gruaja ishte shumë e vjetër, pothuaj rreth të nëntëdhjetave. Kurse unë isha fare i ri- nja shtatëmbëdhjetë vjeç. Takimi ynë rastisi në bregun e majtë ranor të Dnjeprit, pikërisht kundruall panoramës së çuditshme kodrinore të bregut të djathtë të Kievit. Ishte një ditë me diell e verës së vitit njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy. Po luaja futboll me miqtë në rrëzën e plazhit. Qeshnim dhe bërtisnim mesa fuqi kishim. E veshur me një sarafan të gjatë deri në fund të këmbëve ku binin në sy plot lule të mëdha, gruaja e vjetër ishte shtrirë, për t'iu fshehur diellit, aty afër, nën një tendë prej cohe dhe po lexonte një libër. Me shumë gjasë, topi ynë i përdorur, veç kur të futej në këtë tendë të lehtë, e cila mbahej prej ca hunjve të hollë prej druri. Por ne ishim ca rioshë moskokëçarës dhe kjo nuk na shqetësonte fare. Dhe në fund të fundit, topi vërtet depërtoi në strehën e brishtë të gruas së vjetër! Topi goditi tendën me aq forcë, sa e gjitha ngrehina e lëkundshme u rrëzua në çast, pothuaj duke e varrosur nën vete plakën e mjerë. Më zuri tmerri. Iu afrova me vrap, i hoqa shpejt hunjtë dhe e tërhoqa mënjane tendën.

-Gjyshe, - i thashë, duke e ndihmuar që të ngrihej në këmbë, - më ndjeni.

-Nuk jam gjyshja juaj, djalosh, - tha ajo me një zë të qetë por dinjitoz, duke shkundur rrëzën prej sarafanit. -Ju lutem, mos më thërrisni gjyshe. Për komunikim të ndërsjelltë, djalosh, prandaj janë emrat. Më quajnë Ana Nikollajevna Voroncova.

E mbaj mend edhe sot befasimin që pata nga stili i pompoz i saj i të folurit. Askush nga të njohurit apo të afërmit e mi, nuk do të thoshte kurrë kësaj: "Për komunikim të ndërsjelltë, djalosh, ekzistojnë emrat..." Grua fort e çuditshme qenkej kjo plakë. Dhe veç kësaj, kishte edhe një emër të famshëm- Voroncova! Si djalë i lexuar, natyrisht, e dija, që ky emër i përkiste dinastisë së njohur të aristokratëve rusë të pararevolucionit. Asnjëherë nuk më kishte zënë veshi një mbiemër të tillë të zgjedhur te njerëzit e thjeshtë.

-Më ndjeni, Ana Nikollajevna.

Ajo vuri buzën në gaz.

-Më dukeni djalë i mbarë, - tha. - si ju quajnë?

-Aleksj. Aljosh.

-Emër i bukur, - më përgëzoi. - Ana Karenina kishte një të dashur, që e quanin, ashtu si ju, Aleksj. - Dhe ngriti librin

e shtrirë në rrëzë: ishte "Ana Karenina"- Dashuria e tyre ishte tragjike - dhe rezultati ishte vdekja e saj. E keni lexuar Tolstoin?

-Patjetër, - thashë dhe shtova krenarisht: - I kam lexuar gjithë klasikët rusë- nga Pushkini deri te Çehovi.

Tundi kokën.

-Shumë kohë para revolucionit, njihesha me mjaft aristokratë rusë, të cilët Tolstoi i ka bërë heroj të romaneve të tij.

...Lexuesi i sotëm, ma merr mendja, e ka të vështirë t'i kuptojë ato ndjenja të përziera që përjetova kur dëgjova këto fjalë. Sepse isha një komsomolas* i vërtetë, që e dija fare mirë se aristokratët rusë ishin armiq të betuar të popullit punonjës; bjellogardistët e përbuzur, tradhtarë të Rosisë. Kurse kjo grua, kjo plakë e brishtë simpatike, duke buzëqeshur, pa iu trembur syri më bën me dije, mua, një djaloshi të panjohur, se i njihje këta tradhtarë! Dhe, me shumë gjasa,

kishte miqësi me ata, shtypës të popullit të thjeshtë!

Mendimi i parë që më erdhi ishte që ta ndërprisja këtë njohje të papritur, kaq të çuditshme, mbase, edhe të rrezikshme dhe të kthehesha tek miqtë e mi të futbollit, por një kureshtje e pakapërcyeshme, që s'mund t'i rezistoj, më ngriti lart dhe i pavendosur e pyeta duke e ulur zërin:

-Ana Nikollajevna, Voroncovët, më duket, kanë qenë princër, kështu?

Ajo zuri të qeshë.

-Jo, Aljosh. Babai im, Nikollaj Aleksandroviç, ka qenë kont.

...Ljoshka!- po më thësnin miqtë. -Ç'po bën atje? Do të luash apo jo?

-Jo!- iu përgjigja me tërsëllëm.

Isha i zënë me ringritjen e strehës së rrënuar të së njohurës sime të re- dhe ç'të një e njohur se, - një konteshë ruse!- dhe as që doja t'ia dija për miqtë e mi të futbollit.

-Lëreni të qetë, - ia priti një nga miqtë e mi. - E gjeti një shoqëze.

Dhe filluan të gajaseshin.

Gruaja gjithashtu vuri buzën në gaz.

-Jam ca e vjetër për të qenë shoqëze e dikujt, - tha ajo dhe vura re një theks të lehtë të huaj në shqiptimin e saj. -A keni shoqëze, Aljosh? A jeni i dashuruar me të?

Tani e humba fare.

-Jo, - i thashë. - S'jam veçse shtatëmbëdhjetë vjeç. Dhe, t'ju them të vërtetën, kurrë nuk kam qenë i dashuruar.

-Ju lumtë!, - tha. - Jeni shumë i ri, që të kuptoni se çfarë është dashuria e vërtetë. Ajo mund të jetë e rrezikshme, e çuditshme, e paparishikueshme. Kur kam qenë në moshën tënde, pothuaj rashë në dashuri me një burrë që ishte dyzet e tetë vjeç më i madh se unë. Ka qenë takimi më i tmerrshëm në gjithë jetën time. Lavdi zotit, që zgjati veçse tri orë.

Po e ndieja se kjo grua e vjetër që fliska kaq shumë, prite kur të më rrëfëjë ndonjë histori të çuditshme dhe tragjike. Tashmë ishim ulur nën tendën e ringritur dhe po hanim nga një mollë.

-E dini, Ana Nikollajevna, vura re njëfarë theksi të huaj. Ishte frëngjisht?

Ajo buzëqeshi.

-Po, natyrisht. Frëngjishtja për mua është po aq amtare, sa rusishtja... Ai njeri, me të cilin për pak rashë në dashuri, gjithashtu e dalloj theksin tim. Por theksi im ishte tjetër atëherë dhe po tjetër ishte përgjigjja ime. Dhe rrjedhojat e asaj përgjigjeje ishin të tmerrshme!- Ajo heshi disa sekonda, pastaj shtoi: - Kjo ka ndodhur në vitin njëmijë e tetëqind e shtëdhjetë e shtatë, në Paris. Isha shtatëmbëdhjetë vjeçe, ndërsa ai gjashtëdhjetë e pesë.

Ja se çfarë më tregoi Ana Nikollajevna Voroncova atë ditë të qetë vere në bregun ranor të Dnjeprit.

... Ishte shumë i bukur - mbase më i bukuri i burrave që kisha takuar para tij dhe pas tij-shtatlartë, i rregullt, shpatullgjerë, me një cullufe të paprekur nga thinjat. Nuk e dija moshën e tij, por kishte një pamje disi rinore dhe dukej si një burrë i moshës së mesme. Dhe qysh në minutën e parë të njohjes sonë kuptova se ishte një njeri shumë i mençur, i kulturuar dhe magjepsës. Ishte prag Krishtlindjesh në Paris. Im atë, konti Nikollaj Aleksandroviç Voroncov ishte në atë kohë ambasador i Rosisë në Francë; dhe s'ishte për t'u habitur që atë e ftonin së bashku me familjen për kremtimin e Krishtlindjeve në godinën e Ministrisë së Punëve të Jashtme. E mbani mend Aljosh, se si Lev Tolstoj e përshkruan në "Lufta e paqja", paraqitjen e parë të Natasha Rostovës në ballo, kur ajo ishte gjashtëmbëdhjetë vjeçe- frikërat e saj, emocionet e saj, parandjenjat e saj? Saktësisht, kështu e përfytyroja veten, sapo vura këmbën në parketin e ministrisë, e cila ndodhej në Quai d'Orsay** madhështore. Më ftoi në një vallëzim, pastaj në një të dytë, një të tretë... Vallëzonim, bisedonim, qeshnim, bënim shaka - dhe çdo minutë po e ndieja që



Ana Nikollajevna Voroncova



A. S. Pushkin



Zhorzh Dantes
(Georges d'Anthes)

për herë të parë kisha takuar një burrë, që më kishte zgjuar parandjenjën e paqartë, por të mahnitshme të dashurisë!

Kuptohet, po flisnim frëngjisht. Mësova se e quanin Zhorzh dhe që ishte senator në parlamentin francez. Po pushonim në kolltuk pas një rrotullimi të çmendur valsi, kur më bëri pikërisht këtë pyetje, që më bëtë ju, Aljosa.

-Ana,- tha ai,-keni një theks të çuditshëm. Jeni gjermane?

Unë qesha.

-Hollandeze? Suedeze?- vijoi me pyetje.

-Nuk e gjetët.

-Greke, polake, spanjolle?

-Jo, - i thashë.- Jam ruse.

U kthye prerazi dhe me sytë e shqyer më vështroi me një shprehje të çuditshme- si të përhumbur dhe në të njëjtën kohë të tronditur.- Ruse... mezi u dëgjua mërmërima e tij.

-Me që ra fjala,- thashë, - unë nuk e di mbiemrin tuaj, Zhorzh. Cili jeni ju, i panjohuri misterioz?

Heshti paksa, dukej se po bluante mendimet, pastaj, si uli zërin, foli:

-Nuk mund t'jua them mbiemrin tim, Ana.

-Përse?

-Nuk mundem.

-Po përse?- këmbëngula.

Heshti përsëri.

-Mos u përpiq, Ana, -foli qetë.

U grindëm disa minuta. Unë këmbëngulja. Ai refuzonte.

-Ana,-tha, - mos e kërkoni. Nëse unë do t'jua them mbiemrin tim, atëherë ju do të ngriheni sakaq, do ta lini këtë sallë dhe nuk do t'ju shoh më kurrë.

-Jo! Jo!- pothuaj bërtita.

-Po,- tha ai me një buzëqeshje të trishtë dhe më kapi dorën.

-Më besoni.

-Betohem!- klitha. -Çfarëdo që të ndodhë, do të mbetem mikja juaj përherë.

-Mos u betoni, Ana. Merreni mbrapsht betimin tuaj, ju përgjërohem.

Me këto fjalë, bëri gjysmërrrotullimi nga unë dhe mezi dëgjova:

-Unë jam Zhorzh Dantes. Dyzet vjet më parë kam vlarë në duel Pushkinin...

Pastaj u kthye nga unë. I kishte ikur fytyra. Sikur ishte plakur befas; i dallova dy rrathë të zinj poshtë syve; balli i prerë nga rrudhat e vuajtjes; sytë e mbushur me lot...E vështrova gjithë pabesim dhe tmerr. Vallë ky njeri, i ulur pranë meje, të ishte vrasësi i gjeniut te letërsisë ruse? Ndjeva në çast një sëmbim ne zemër. E pamendueshme! E pamundur! Ky njeri, në përqaftimet e të cilit po rrotullohesha në valsin e shkujdesur veçse njëzet minuta më parë, ky burrë magjepsës i kishte ndërprerë pamëshirshëm jetën e legjendarit Aleksandër Pushkin, emrin e të cilit e nje çdo rus- i ri apo i vjetër, i varfër apo i pasur, fashatar i thjeshtë apo aristokrat i lartë...

E tërhoqa pëllëmbën nga dora e tij dhe u ngrita vrik. Pa thënë gjysmë fjale dola nga salla, u sula teposhë shkallëve, kapërceva shëtitoren e breglumit dhe u mbështeta tek një pemë. Lotët më rridhnin çurk. Gjithë helm e ndieja dorën e tij të djathtë, përreth belit tim kur rrotulloheshim në valsin e shpejtë... Atë dorë që kishte mbajtur pistoletën drejtuar Pushkinin! Pikërisht atë dorë, me të cilin shtiu plumbin që vrau Pushkinin! Përmes velit të lotëve, shihja Pushkinin e plagosur për vdekje, që me vështirësi po ngrihej në brryl dhe përpiqej të qëllonte kundërshtarin...Dhe i shembur dëshpërimisht mbi dëborë pas qitjes së pafat... Dhe i varrosur pas disa ditësh, pa mundur të shkruajë dhe gjysmën e asaj që do të ishte i aftë... Qaja gjithë ngashërim...

Pas disa ditësh mora një letër nga Dantes. A dëshiron ta shohësh, Aljosa? Ejani të hënën tek unë për çaj dhe do t'jua tregoj letrën. Dhe qindra libra të rrallë dhe dhjetra tablo të mrekulueshme...

Pas tri ditësh trokita në derën e apartamentit të saj. E hapi një burrë rreth të gjashtëdhjetave.

-Jeni Aljosa?- pyeti.

-Po.

-Ana Nikollajevna ndodhet në spital në gjendje të rëndë prej pneumonisë. Jam i biri. Ajo m'u lut t'jua jap këtë letër. Dhe më zgjati një zarf.

Shkova në parkun aty pranë, prej nga dukej panorama e mahnitshme e Dnjeprit. Përballë meje, në anën e kundërt shtrihej bregu ranor, ku tri ditë më parë kisha dëgjuar këtë histori të pabesueshme, që i kishte ndodhur një shtatëmbëdhjetëvjeçareje në Parisin e largët shtatëdhjetë e pesë vjet më parë.

E hapa zarfin dhe nxora dy letra. Njëra e verdhëme, pothuaj një fletë e kalbur nga vjetërimi, e mbushur me rreshta të pakuptueshme në frëngjisht. Tjetra, në rusisht, ishte kopjuar me një shkrim të vjetër gjithë dredha. Ishte përkthimi i tekstit frëngjisht.

Lexova:

Paris, 30 dhjetor i vitit 1877

E dashur Ana!

Unë nuk po kërkoj falje, sepse asnjë falje, madje edhe më e sinqerta, nuk mund të fshijë atë krim të tmerrshëm, që unë kam kryer dyzet vjet më parë, kur viktimë ime, i shquari Aleksandër Pushkin, ishte tridhjetë e shtatë, kurse unë njëzet e pesë. Dyzet vjet-14.600 ditë dhe net!- unë jetoj me këtë barrë të padu-

rueshme. S'mund t'i numëroj netët, kur më shfaqej-i gjallë apo i vdekur- në ëndrrat e mia. Përgjatë tridhjetë e shtatë vjetëve të jetës së tij ai krijoi një botë të jashtëzakonshme me vjersha, poema, përralla dhe drama. Kompozitorë të shquar kanë shkruar opera sipas veprave të tij. Të kishte jetuar edhe tridhjetë e shtatë vjet, do ta kishte dyfishuar këtë botë madhështore,- por nuk e bëri këtë sepse unë e vrava atë dhe së bashku me të zhduka krijimtarinë e ardhshme. Tani jam gjashtëdhjetë e pesë vjeç dhe plot shëndet. Jam i bindur Ana, që vetë Zoti ma dhuroi këtë jetë të gjatë, që vazhdimisht, nga dita në ditë, të torturohesha me vetëdijen e tmerrshme që unë jam vrasësi gjakftohtë i gjeniut.

Lamtumirë, Ana!

ZHORZH DANTES

P.S. Unë e di se për të mirën e njerëzimit do të kishte qenë e udhës, nëse do të kisha vdekur unë dhe jo ai. Por, vallë, është e mundur që të qendrosh përballë tytës së pistoletës së duelit dhe të presësh vdekjen edhe të mendosh për të mirën e njerëzimit?

Zh. D.

Poshtë nënshkrimit të tij, ishte shtuar po me atë shkrimin e vjetëruar gjithë dredha:

Senatori dhe kalorësi i Legjionit të Urdhërit të Nderit, Zhorzh Dantes, vdiq në vitin 1895, qetësisht, në shtëpinë e tij, i rrethuar nga fëmijët dhe nipërit. Ishte tetëdhjetë e tre vjeç.

Kontesha Ana Nikollajevna Voroncova vdiq në korrik të vitit 1952, dhjetë ditë pas takimit tonë. Ishte nëntëdhjetë e dy vjeç.

Unë pikuroj realitetin tim.

E vetmja gjë që unë di është se unë duhet të pikuroj, dhe unë pikuroj çdo gjë që kalon nëpër kokën time.

Frida Kahlo

Nëse jeta e Frida Kahlo (1907-1954) do përmbilidhej vetëm në tre fjalë, ato do ishin: pasion, dhimbje, politikë. Një zjarr i brendshëm kaq i madh i një artisteje, i shpalosur në ngjyra të flakta dhe kompozime të dhimbshme, përzier me elementë kombëtarë dhe feministë, nuk ishte shpalosur kurrë në art përpara pikturave të Fridës. Në përgjithësi çdo artist ka një vepër të spikatur si prej kritikëve ashtu edhe prej artdashësve, por veprat e Fridës nuk mund të veçohen dot, ato duhen parë të gjitha, si pjesë e një mozaiku të plotë, të cilat të bashkuara një e nga një, i paraqesin botës natyrën e vërtetë të saj dhe shpalosin një fytyrë të re të artit.

Tabloja Dy Fridat (1939) është një copëz e mozaikut të artit të saj, që ilustron, ashtu si të gjithë veprat e tjera, dybotshmërinë e saj, gruan pasionante dhe artisten e mbushur plot dhimbje.

Për të kuptuar veprat e Fridës së pari duhet njohur vetë Frida.

E lindur nga një baba gjerman me origjinë hebreo-hungareze, dhe nga nëna meksikane me origjinë të fiseve vendase, ashtu si përzierja e gjakut, edhe jeta e saj do ishte e shumanshme, madje deri në ekstremitete, si në aspektin personal ashtu edhe atë artistik. Jeta e Fridës ishte një jetë plot sëmundje, operacionesh kirurgjikale, vështirësish dhe pengesash derisa trupi dhe shpirti i saj të shuhej në moshën 47 vjeçare.

Që në fëmijëri ajo u sëmur nga poliomieliti duke e lënë atë me këmbën e djathtë të deformuar. Në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare ajo pësoi një aksident me tramvaj teksa kthehej nga shkolla për në shtëpi. Shpina e saj u thye në tre vende, klavikula dhe legeni i saj u shkërmoqën, kofsha e djathtë dhe të dyja këmbët pësuan frakturë të shumta dhe u tejshpua nga një shufër metali në stomak dhe mitër. Fatmirësisht në vendngjarje arriti një burrë i veshur me rroba pune, i cili porsi një samaritan i mirë, e ndihmoi Fridën duke ia hequr shufrën që i kishte depërtuar trupin, teksa ajo ulërinte fort gjatë të gjithë kohën. Ai vuri këmbën e tij mbi të dhe e tërhoqi shufrën derisa doli nga trupi i saj. Me brinjë të shumta të thyera, dëmtime të rënda të shtyllës kurrizore, dhe me këmbë të thyera në 11 vende, kthesa e Fridës nga spitali në art, erdhi si rezultat i asaj traume.

Për pjesën tjetër të jetës së saj, Frida do përjetonte me dhjetëra operacione dhe në fund do amputonte njërën këmbë. Gjithashtu do të pësonte disa dështime dhe aborte si edhe do shpenzonte shumë muaj në shtrat me trupin në allçi, e muaj të tjerë në karrocë me rrota dhe me shumë dhimbje. Por, pavarësisht të gjitha këtyre vështirësive, Frida u shqua për vullnetin e pashoqë për t'i kapërcyer ato dhe ndihmuan për të nxitur personalitetin e saj të fortë.

Por, pas atij aksidenti fizik erdhi edhe aksidenti i dashurisë. Siç u shpreh edhe vetë ajo, “Kam pësuar dy aksidente të rënda në jetën time. Njëri ishte tramvaji. Dhe aksidenti tjetër është Diego.”

Frida ishte ende e re kur u takua me muralistin e njohur, artistin më të shquar të kohës dhe të gjithë artit meksikan, Diego Rivera, i cili në atë kohë po punonte në një vepër arti pranë shkollës së saj. Ndoshta ishte një shenjë e rebelimit të saj, ndoshta një flirt adoleshenteje, por Frida ia shpalli dashurinë atij burri që ishte dy dekada më i vjetër sesa ajo. Disa prej miteve që rrethojnë jetën e Fridës kanë të bëjnë me marrëdhënien e saj me Diegon, si edhe me burrat e gratë e tjera që hynë në jetën e tyre. Diego ishte katalizatori i Fridës, duke i dhënë asaj mësimin se rritja dhe pjekuria do të thoshte sakrificë dhe dhimbje, ndonëse sillte shoqëri apo ndoshta edhe dashuri.

Diego Rivera ishte admiruesi më i madh i Fridës dhe mësuesi më aktiv në artin e saj. Ai promovoi karrierën e saj në pikturë, inkurajoi stilin që ajo përdorte dhe ndikoi shumë në ndërtimin e identitetit të saj si



"DY FRIDAT" DHE HEROINA E DHIMBJES

Dr. Bledar Kurti

artiste dhe si një grua meksikane e pavarur. Ishte Diego ai që i dhuroi Fridës veshjen e saj të parë tehuana. Këto veshje të paqepura, me ngjyra të ndezura, me këmishët e qëndisura dhe fundet e gjata të veshura në mënyrë tradicionale nga tehuanaët, një fis vendas në juglindje të Meksikës, u bënë simbol si në jetën e saj ashtu edhe në autoportretet në pikturë. Ato veshje iu përshtatën nevojave të saj fizike, agjendës së saj politike dhe personalitetit të saj të fortë. Ato mundësonin që ajo të fshihte kofshën e saj të shtrembëruar nga poliomieliti, këmbët e saj të thyera dhe shpinën e dëmtuar. Ato veshje e lidhën atë me gratë tehuane të cilat njiheshin dhe vazhdojnë të njihen në Meksikë si matriarkat e shoqërisë së tyre.

Sado i vështirë, i komplikuar dhe i talentuar të ishte personaliteti i Fridës, Diego e mahniti por edhe e tmerroi atë. Ajo ishte një femër me trup të vogël ndërsa ai ishte një njeri trupmadh e në moshë mesatare. Ata kishin njëzetë vite diferencë dhe njiheshin prej të tjerëve si “pëllumbesha dhe elefanti.” Ai fliste me zë të lartë dhe mbante armë në brez; mburrej për gratë e shumta me të cilat shkonte; pinte me tepri dhe ishte anëtar i Partisë Komuniste. E te kush tjetër, përveç Diegos mund të shkonte Frida për këshilla mbi artin? Ajo mund të kishte takuar artistë të tjerë në Coyoacán, qytetin e saj, por ajo zgjodhi pikërisht atë. Ai simbolizonte gjithçka që ajo respektonte: ai ishte ndryshe, dallohej nga të tjerët, dhe sfidonte shoqërinë. Diego u bë sfida e saj emocionale. Në moshë të afërt me babanë e saj, Diego Rivera me siguri ishte një lojtar i përsosur për rebelimin e një adoleshenteje. Ai

ishte i martuar, ndërsa ajo jetonte në shtëpi me prindërit e saj; ai ishte trupmadh dhe mendjemadh për veten, ajo ishte e vogël dhe e zjarrtë. Që prej ditës së parë kur u takuan, Frida u dha njoftimin të gjithëve se ajo do të martohej me Diegon.

Por marrëdhënia me Diegon rezultoi në një ferr emocional, ndaj shumë e vetëdijshme për ndërlikimet e jetesës me të, ajo e quajti Diegon "aksidenti i dytë."

Ata u martuan, u ndanë, e u martuan sërish. Tradhtitë e Diegos nuk kishin fund. Diego i konsideronte femrat si profesion të dytë. Frida mori tronditjen më të rëndë të jetës së saj kur zbuloi se jo vetëm që Diego shkonte me gra të tjera, por ndër to ishte motra e saj Cristina. Ajo u shkatërrua tërësisht dhe u ndie e tradhtuar nga të dy ata. Sikur ky pikëllim të mos mjaftonte, shëndeti i Fridës përkeqësohej gjithnjë e më shumë. Ajo pësoi shumë dështime dhe aborte, e më vonë, këmbët iu infektuan sërish. Në një përpjekje për t'i dhënë fund dhimbjes tek këmbët asaj iu desh të priste gishtërinjtë e këmbës e më pas të gjithë këmbën e djathtë.

E gjithë dhimbja fizike dhe emocionale e Fridës u manifestua në mënyrën më unike dhe madhështore në tablotë e saj. Në to ajo pikturon veten, me bukurinë dhe veçantinë e vetullave të saj të trasha e të bashkuara, me lëkurën e saj zeshkane e flokët e errëta si nata, me veshjet shumëngjyrëshe që rrezatojnë ndriçimin, traditën, harenë dhe kulturën meksikane, por figurat e saj janë të kompozuar si skena torture e dhimbje, me artisten e shtruar në shtratin e spitalit

teksa aborton, e gjakosur, e gjymtuar, si një drenushë e shigjetuar për vdekje, si një pemë që zgjeron degët në tokë të thatë, e shumë simbolika të tjera të cilat trazojnë emocionet e çdo shikuesi të sotëm por që e bëjnë atë edhe të ndiejë dhimbjen që ndiente vetë Frida. Nga një moment dhimbje e tillë buroi edhe vepra Dy Fridat.

Menjëherë pas divorcit me Diegon, Frida pikuroi një nga veprat e saj më të njohura, Dy Fridat. Kjo tablo ka përmasa më të mëdha në krahasim me standardet e saj të zakonshme të cilat ishin kryesisht të vogla. Kjo vepër, 173.5 × 173 cm, paraqet një portret të dyfishtë të Fridës, e cila është një radiografi e vërtetë e momentit kur dhimbja e saj emocionale dhe dhimbja e saj fizike garonin në mënyrë të barabartë se cila do e vriste më thellë atë.

Të dy Fridat, njëra në të majtë me fustan të bardhë serioz dhe tjetra me veshje tehuane i mbajnë duart e kapura sikur kombinojnë karakteristikat e tyre në një trup të vetëm, ose në shenjë mëshirimi me vuajtjet e njëra-tjetrës. Frida në të majtë është e butë dhe serioze, e mbuluar deri në grykë me një fustan të kollarisur dhe me flokë të rregulluara me kujdes. Ajo nuk ka bizhuteri por mban një palë gërshërë të vogla ose pinceta operacioni, një instrument që përdoret për të ndaluar pikimet e gjakut në bardhësinë e fustanit. Zemra e saj është e prerë dhe e hapur, dhe barkushet e zemrës duket sikur punojnë për të pompuar gjakun, siç duhet të funksionojë në të vërtetë, madje edhe pse zemra është e hapur. Kurba e lehtë e gjoksit të Fridës është e dukshme nën zemrën dhe arteriet që përçojnë lëngun në pjesën tjetër të trupit të mbështjellë rreth qafës së saj, duke lidhur hapësirën ndërmjet dy Fridave dhe duke i bashkuar ato.

Frida në të djathtë e ka zemrën e saj të ekspozuar, por ajo nuk është e hapur. Edhe ajo duket se vazhdon së punuari. Të dyja Fridat kanë faqet e kuqe, që tregojnë për një furnizim të mirë dhe të qëndrueshëm me gjak, dhe tendrilat e saj, më të ngushta se arteriet e figurës tjetër, i spërdridhen rreth krahut. As këtu nuk ka gjakderdhje, vetëm një riciklim të vazhdueshëm të gjakut përmes trupave të dy grave.

Frida në të djathtë mban në dorë një portret të vogël. Pikturuar si një gur i gdhendur, aty tregohet një figurë e vogël e një djaloshi të skicuar me linja të errëta. Ajo figurë është e Diegos kur ishte fëmijë. Frida e riprodhoi portretin e tij nga një fotografi e hershme e Diegos, por dallohet me vështirësi për shkak të përmasave të vogla. Syri i shikuesit tërhiqet nga fytyrat dhe vuajtjet e dyfishta të dy figurave femërore, përmes detajeve të atij që gjendet në mes të skenës, e që është shkaktari i mundimit të tyre, por që arrin të duket vetëm pas një shqyrtimi të kujdesshëm.

Frida në të djathtë mban veshur një fund të gjatë që është pothuajse në ngjyrën e mustardës, ashtu si edhe toka poshtë dy Fridave; ajo ka një bluzë ngjyrë blu dhe të verdhë, të përafërt me një bluzë që Frida zotëronte në të vërtetë. Veshja formale në të majtë dhe veshja vendase në të djathtë bashkohen, për të na dhënë një Frida Kahlo me një identitet të dyfishtë, identitete të cilat banojnë brenda një jete të vetme. Dy trupa, dy origjina, dy pjesë të një misteri që vijnë së bashku për t'u bashkuar me forcat e natyrës duke vajtuar për një dashuri të humbur. Portreti në miniaturë i Diegos është një kujtesë e pabesive dhe tradhtive që arrijnë të shpojnë gjirin e një gruaje dhe të shkaktojnë dëshpërimin e saj të pafund dhe të thyejnë zemrën e saj. Retë e errëta blu prapa dy figurave shërbejnë për të nënvizuar turbullirat e figurave të ulura para tyre. Figurat kryesore dhe sfondi bashkohen së bashku për ta trazuar tërësisht shikuesin.

Dy Fridat janë të ulura në të njëjtën ndenjëse. Kanë një qëndrim tejet miqësor, e madje motor me njëra-tjetrën. Ato duken si të pandashme e të përvetshme në dhimbjen e tyre. Të dy figurat shohin drejtpërdrejt nga shikuesi, sikur të dyja përnjëherësh po flasin me telepati: Na shikon? Ne jemi Frida Kahlo. Ne – unë - kemi dhimbje! A e ndien dhimbjen time?

Edhe pse tabloja është dramatike, ngjyrat



e ndezura mund të trazojnë vështrimin e një shikuesi evropian. Por Meksika është një vend plot ngjyrë e hare, me shumë dramë por edhe bukuri ndjenjash, dhe përmes ngjyrave të forta meksikanët, apo edhe kultura të tjera indigjene apo spanjolle të Amerikës Latine, shprehin si trishtimin ashtu edhe gëzimin përmes kontrastit të ngjyrave të forta. Në thelb të jetës së tyre është pasioni. Në cilindo skaj të tij, pasioni shprehet fuqishëm.

Veprat e Fridës nuk janë të përsosura estetikisht. Shpeshherë kanë defekte në linjat e figurave, në proporcionet e trupit, përshkrimin e perspektivës, etj., por ato kanë një pasion të paprecedentë për kohën e saj por edhe për kohët e sotme. Shikuesi përballet me këtë pasion tek veprat e Fridës dhe sytë e mendja nuk merren aspak me detajet e figurave por zemra pushtohet e tëra nga ndjenjat e forta që ato tablo përçojnë. Mua m'u desh të vizitoja Meksikën në mënyrë që të përjetoja emocionet e pashpjegueshme që përçojnë ngjyrat, muzika, kultura, tradita dhe arti meksikan, në fakt e gjithë atmosfera meksikane në tërësi. Arti manifestohet ndryshe në kultura të ndryshme, dhe ndjesitë që marrim nga njëri

vend në tjetrin dallojnë për nga identiteti, botëkuptimi, dhe emocioni unik tradicional prej nga ku artisti vjen. Arti është universal por ai shfaq fytyrat e tij edhe në varësi të origjinës së artistit.

Në të gjithë veprat e Fridës dallohen elementët tradicionalë. Frida ishte "meksikane e vërtetë" pasi ajo kombinonte kaq shumë tradita në një. Ajo tërhiqte vëmendjen në çdo turmë. Në Fifth Avenue në New York, në rrugët e Parisit, ose pasi hynte në sallat në Mexico City për ndonjë koncert klasik, njerëzit ndalonin për ta parë. Veshjet shumëngjyrëshe të Fridës, bizhuteritë e saj meksikane, kordelet e flokëve, fundet e gjata, dhe fragranca franceze me të cilin parfumosej, krijonin një imazh që ishte vështirë të shpërfillej e madje edhe i vështirë për t'u harruar. Ndërsa me veprat e saj ajo na shpalos një fytyrë të paharrueshme, të një gruaje të bukur, të brishtë por edhe të fortë, e mbuluar me aureolën e pasionit, dhe e spikatur me vetullat e saj të trasha e të bashkuara, të cilat ditët e sotme janë shndërruar në një ikonë në nder të saj.

Ajo i ndërthuri më së miri elementët simbolik njerëzor me ato tradicionalë. Tek

tabloja Autoportret Me Varëse me Gjemba dhe një Zog, e pikturuar një vit pas veprës Dy Fridat, ajo e portretizon veten si një mestiza e vërtetë dhe krenare, një meksikane me prejardhje të përzier evropiane dhe indiane amerikane. Në të ajo bashkon imazhet para-kolumbiane dhe ato të krishtera për ta paraqitur veten si një ndërthurje e figurës së Krishtit me një perëndeshë azteke. Ajo na shpaloset si një krijesë hyjnore sakrifikuese sipas traditës folklorike meksikane. Në këtë tablo ajo ka pikturuar gjethe të mëdha, flutura dhe pilivesa të cilat në krishterim simbolizojnë ringjallje ndërsa në traditën indigjene, shpresë dhe ripërtëritje. Në qafë ajo ka një varëse me gjemba, me të cilën simbolizon vuajtjen, dhe një zog, i cili në kulturën meksikane kishte kuptimin e të qenit "e pafatë në dashuri".

E joshur nga origjina e kulturave ajo zbuloi nocionin lindor të syrit të tretë në mes të ballit, si një simbol i një realiteti më të lartë dhe e shndërroi atë në një motiv pikturë për të përfaqësuar mendimet e saj të cilat vërtiteshin rreth njerëzve që kishte humbur, kujtimet e pjesëtarëve të familjes dhe nocionin e vdekjes si pjesë e vetë jetës. Dhe siç mund

të imagjinohet, syri i tretë i autoportreteve të saj ishte Diego. Ndaj te vepra Diego Dhe Unë (1949), ajo ka pikturuar veten, me dy sytë e saj të përlotur dhe me syrin e tretë në qendër të ballit, ku dallohet fytyra e Diegos. Ai ishte gjithmonë në mendjen e saj, si një persekutor i përjetshëm.

Dhe pas divorcit ata u martuan sërish. Pavarësisht marrëdhënies së tyre gjithmonë të ndërlikuar, bisedat midis tyre dhe letërkëmbimet ishin shumë të bukura e lozonjare. "Mi niña Frida" e quante ai, "Fisita" ose "Friducha." Ndërsa ajo shkruante kështu në ditarin e saj: "Diego = bashkëshorti im / Diego = miku im / Diego = nëna ime / Diego = babai im / Diego = djali im / Diego = unë / Diego = Universi."

Pasioni i Fridës nuk ishte vetëm për Diegon dhe jetën. Një pasion tjetër i saj ishte politika. Ajo ishte anëtare e Partisë Komuniste dhe bashkë me Diegon shquheshin për bindjet e tyre të thella majtiste. Por Frida, duke qenë Frida, hera-herës e bashkonte pasionin politik me atë dashuror. Gjatë azilit të tij politik në Meksikë, Leon Trotsky, një ndër figurat më të rëndësishme të Revolucionit të Tetorit, kundërshtar i thekur i Stalinit, u strehua bashkë me të shoqen për dy vjet në shtëpinë blu të Diegos dhe Fridës. Gjatë kësaj kohe Frida dhe Trotsky, i cili shquhej për tërheqjen që kishte ndaj femrave të bukura, pati një lidhje me Fridën, e cila pas një lidhje të gjatë midis tyre i dhuroi atij një autoportret tejet sensual e të bukur me rastin e ditëlindjes së tij. Në atë pikturë ajo shfaqet tërheqëse dhe joshëse, dhe mban në dorë një letër në të cilën shkruhet qartë: Për Leon Trotsky, me gjithë dashurinë time, ia kushtoj këtë pikturë më 7 nëntor 1937. Frida Kahlo në Saint Angel, Meksikë.

Lidhjet dashurore të Diegos dhe Fridës ishin të shumta, por një lidhje, në fakt artistike e jo dashurore, duket se ka një mospërputhje analitike. Andre Breton, babai i Surrealizmit e vlerësoi stilin e Fridës si surrealist, ndërkohë që Surrealizmi bazohej mbi piktura-ëndrra, në imazhet e të pandërgjegjshmes, dhe jo autoportrete reale e me një dhimbje të ndierë fizike e plot ndërgjegje që përmbante arti i saj.

Frida krijoi rreth 200 piktura e vizatime gjatë karrierës së saj të shkurtër, dhe 55 prej tyre ishin autoportrete. Pikturat e Fridës janë përpjekje të përsëritura për të dokumentuar dhe materializuar përvojën e saj, për ta bërë atë të dukshme dhe të besueshme. Jo nëpërmjet ëndrrave si surrealistët por përmes vuajtjes reale. "Subjektet e mia kanë qenë gjithmonë ndjesitë e mia, gjendjet e mia mendore dhe reagimet e thella që jeta ka krijuar tek unë. Shpeshherë e kam konkretizuar të gjithë këtë te portretet e mia, të cilat ishin krijimet më të singërta dhe të vërteta për të shpalosur atë çfarë ndieja brenda dhe jashtë vetes." Breton u mahnit vërtetë nga stili dhe tematikat e artit të Fridës dhe në një frazë të shkurtër, e cila u bë tejet e famshme ndër vite, ai deklaroi se "Arti i Frida Kahlo është një kordele e lidhur rreth një bombe."

Përpara se të ndahej nga jeta Frida shkroi në ditarin e saj: "Espero alegre la salida—y espero no volver jamás" (Unë pres largimin tim të lumtur dhe shpresoj që kurrë të mos kthehem më). Kjo fjali shoqërohej me nënshkrimin me germa të mëdha, "FRIDA." Artistja e përvuajtur fizikisht, i shndërroi fatkeqësitë e jetës së saj në një ngazëllim dhe frymëzim për brezat e ardhshëm. Sot Frida shihet jo vetëm si një figurë artistike por edhe si një ikonë bukurie, vullneti, vendosmërie, dhe frymëzim për të gjithë artistët të cilët duke marrë shembull prej kurajës dhe talentit të saj, të krijojnë jetë përmes artit edhe teksa gjenden në vështirësi të mëdha; të përçojnë ngjyrat dhe gëzimin e jetës, edhe kur dhimbja shkrihet në terrinat e thella të shpirtit.

Me të mësuar për lajmin e vdekjes së Fridës, miku i saj Iduarte, teksa fliste në mikrofon përpara shumë njerëzve tha me trishtim, "Frida ka vdekur. Frida Kahlo ka vdekur. Mikja, motra e popullit, vajza e madhe e Meksikës, vazhdon të jetojë." Në Meksikë, Frida Kahlo njihet si la heroína del dolor, ose "heroína e dhimbjes", ndërsa ne e njohim atë si meksikanen e mrekullueshme që vetëm arti arriti t'ia zbuste dhimbjen.



Onufri

ExLibris

Minerva



Gëzuar
festat!

